

**INTELIGJENCA EMOCIONALE DHE KORRELAZIONI ME
STILET E PRINDËRIMIT**

-STUDIM KRAHASUES FIER –PRISHTINE

Evis Fili

Udhëheqës shkencor: prof. dr. Gëzim Dibra

Dorëzuar

Shkollës Doktorale pranë Universitetit Evropian të Tiranës,

në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në

Shkencat Sociale

me profil *Psikologji*, për marrjen e gradës shkencore doktor.

Tiranë, 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se punimi për të marrë titullin doktor, i shkruar në mënyrë të pavarur, është tërësisht punim origjinal i autores.

Punimi, në tërësinë e tij, nuk është publikuar në asnjë revistë.

Pjesë të veçanta të të dhënave të përgjithshme të këtij punimi janë shfrytëzuar për botime në revista dhe për prezantime në konferenca shkencore, si pjesë e obligimit të studimeve për doktoraturën.

PËRMBAJTJE

Abstrakti	Faqe 9
Përcaktimi i termave	13
KAPITULLI I	16
1. Hyrje.....	16
1.1. Qëllimi	24
1.2. Hipotezat e hulumtimit	25
1.3. Struktura e punimit.....	26
KAPITULLI II	28
2.1 Inteligjenca emocionale – Vështrim i përgjithshëm.....	28
2.2 Inteligjenca emocionale	28
2.3 Emocionet.....	32
2.4 Si lindi dhe u zhvillua inteligjenca emocionale.....	35
2.5 Modelet e inteligjencës emocionale.....	43
2.5.1 Modeli i bazuar në aftësitë e inteligjencës emocionale.....	44
2.5.2 Modeli i inteligjencës emocionale sipas Bar-On.....	48
2.5.3 Modeli i inteligjencës emocionale sipas Golemanit.....	53
2.5.4 Modeli i tipareve të inteligjencës emocionale.....	56
2.6. Inteligjenca emocionale tipar apo aftësi	58
2.7 Matjet e inteligjencës emocionale dhe kritikant ndaj tyre.....	59
2.8 Stilet e prindërimit.....	68

2.8.1 Stili autoritativ i prindërimit.....	75
2.8.2 Stili autoritarian i prindërimit.....	80
2.8.3 Stili tolerant i prindërimit.....	83
2.8.4 Stili neglizhues i prindërimit.....	85
2.9. Stilet e prindërimit dhe përfundimet e tyre.....	86
2.10. Ndërlidhja mes stileve të prindërimit dhe tipareve të inteligjencës emocionale...92	
KAPITULLI III – Metodologjia.....	98
3.1 Qëllimi i punimit.....	98
3.2 Objektivat	98
3.3 Hipotezat.....	99
3.4. Procedurat dhe qëllimi.....	100
3.5. Pjesëmarrësit (kampioni).....	100
3.6. Instrumentet.....	102
3.7. Analiza e të dhënave.....	105
3.8. Çështje etike.....	107
KAPITULLI IV – Rezultate	108
4.1 Përshkrimi i shkallëve të këtij studimi.....	108
4.2. Lidhja e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit.....	118
4.3. Rezultatet krahasimore.....	130

KAPITULLI V – Diskutime.....	139
5.1. Lidhja e inteligjenca emocionale me stilet e prindërimit	140
5.1.1 Stili tolerant i prindit dhe inteligjenca emocionale.....	142
5.1.2 Stili fleksibël, autoritativ dhe inteligjenca emocionale.....	143
5.1.3 Stilit autoritar i prindit dhe inteligjenca emocionale.....	145
5.2. Inteligjenca emocionale , stili i prindërimit dhe kultura.....	148
5.3. Gjinia dhe inteligjenca emocionale.....	152
5.4 Lidhja e inteligjencën emocionale me variabla të tjera.....	154
5.5. Lidhja e religjionit me inteligjencën emocionale.....	156
5.6. Përdorimi pyetsorëve vetëraportues në studimet cross seksionale.....	158
5.7. Konkluzione dhe rekomandime.....	161
REFERENCA	168
SHTOJCA.....	
Shtojca A- Tabela me rezultate	
Shtojca B – Punimet e botuara.....	
Shtojca C – Pyetësorët e zhvilluar.....	

LISTA E TABELAVE DHE E FIGURAVE

Tabela 1. Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve për kampionin e Fierit dhe Prishtines.

Tabela 2. Koeficientet e besueshmërisë alfa për 15 nënshkallët dhe 4 faktorët kryesore të TEIQ, përfshirë edhe totalin.

Tabela 3. Përshkrimi i shkallëve të tipareve të inteligjencës emocionale.

Tabela xx Mesataret dhe devijimi standard për nënshkallët dhe 4 faktorët kryesorë të TEIQ, përfshirë edhe totalin.

Tabela 4. Koeficienti i korrelacionit, mesataret dhe devijimi standard për katër faktorët e TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e përgjithshëm.

Tabela 5. Koeficienti i korrelacionit për katër faktorët e TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e Fier Shqipëri.

Tabela 6. Koeficienti i korrelacionit për katër faktorët e TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e Prishtines Kosovë.

Tabela 7. Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të nënës me faktorët dhe totalin e TEIQ.

Tabela 8. Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të babait me faktorët dhe totalin e TEIQ.

Tabela 9. Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të nënës me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç.

Tabela 10. Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të babait me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç.

Tabela 11. Regresion i shumëfishtë për moshën, gjininë dhe me cilën dorë shkruanin pjesëmarrësit me totalin e TEIQ për kampionin e përgjithshëm.

Tabela 12. Regresion i shumëfishtë për moshën, gjininë dhe me cilën dorë shkruanin pjesëmarrësit me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç

Tabela 13. Mesataret dhe devijimi standard për tiparet e inteligjencës emocionale të ndara sipas gjinisë dhe totalit të kampionit.

Tabela 14. Rezultatet e testit për shkallët e inteligjencës emocionale sipas gjinisë së pjesëmarrësve për kampionin e përgjithshëm.

Tabela 15. Mesataret dhe devijimi standard për tiparet e inteligjencës emocionale të ndara sipas shtetit dhe totalit të kampionit.

Tabela 16. Rezultatet e testit për shkallët e inteligjencës emocionale sipas shtetit vec e vec.

Tabela 16a) Rezultatet e testit për shkallët e inteligjencës emocionale sipas gjinisë së pjesëmarrësve për kampionin e përgjithshëm.

Tabela 17. Rezultatet e korrelacionit të personit për moshë të ndryshme, vitet e shkollimit dhe të ardhurat në familje me nënshkallët e TEIQ dhe totalit të saj.

Tabela 18. Të dhënat e analizës eksploruese për 4 faktorët dhe totalin e TEIQ.

Tabela 19. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për totalin e TEIQ me shtetin.

Tabela 20. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin tolerant të nënës me shtetin.

Tabela 21. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin autoritar të nënës me shtetin .

Tabela 22. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin autoritativ fleksibël të nënës me shtetin.

Tabela 23. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin tolerant të babait me shtetin.

Tabela 24. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin autoritarian të babait me shtetin.

Tabela 25. Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe i numrave për stilin autoritativ flexibel të babait me shtetin

FIGURAT

Figura 1. Shpërndarja e përqindjeve për totalin e inteligjencës emocionale në kampionin e përgjithshëm.

Figura 2. Shpërndarja e përqindjeve për stilin tolerant të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Figura 3. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritarian të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Figura 4. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritativ fleksibel të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Figura 5. Shpërndarja e përqindjeve për stilin tolerante të babait në kampionin e përgjithshëm.

Figura 6. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritarian të babait në kampionin e përgjithshëm.

Figura 7. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autotitativ flexibe të babait në kampionin e përgjithshëm.

Figura 8. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritativ/ flexibel të babait në kampionin e Fier Shqiperi e Prishtine Kosove.

Figura 9. Boks ploti për totalin e shkallës së tipareve të inteligjencës emocionale.

Figura 10. Histogrami për shkallën për mirëqenien emocionale.

Figura 11. Histogrami për shkallën e vetëkontrollit.

Figura 12. Histogrami për shkallën e shoqërizimit

Figura 13. Histogrami për shkallën e emocionalitetit.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi dhe identifikimi i marrëdhënieve mes inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, në një kampion të përzier në Fier Shqiperi e në Prishtinë Kosove.

Inteligjenca emocionale karakterizohet nga aftësia për të kuptuar, për të menaxhuar, për të lehtësuar dhe për të rregulluar emocionet. Këto aftësi e ndihmojnë individin për rregullimin e emocioneve, si dhe për përdorimin e tyre me synim motivimin, planifikimin dhe arritjen e objektivave jetësore.

Është argumentuar gjerësisht se stili prindëror luan një rol të rëndësishëm në krijimin e inteligjencës emocionale gjatë periudhës së fëmijërisë. Edhe faktori gjenetik luan rol për këtë, ndërkohë që po bëhen shumë studime për të kuptuar se cilat specifika të stilit prindëror rrisin nivelin e inteligjencës emocionale.

Komponentët e prindërimit tregojnë se në çfarë shkalle përfshihet prindi në marrëdhënie me fëmijën për t'i inkurajuar pavarësi në marrjen e vendimeve dhe vetiniciativën, për t'i shprehur

afërsi dhe për t'i inkurajuar autoritetet. Shumë studime kanë treguar se stili autoritativ është parashikues i rëndësishëm i rregullimit emocional. Për shembull: nga një studim i kryer me adoleshentë është mësuar se fëmijët me prindër autoritativ kanë më shumë aftësi sociale, si dhe janë më empatikë.

Ndërsa nga një studim tjetër ka rezultuar lidhshmëria mes stilit autoritativ të prindit me inteligjencën emocionale të fëmijës. Për t'u përmendur është edhe studimi, nëpërmjet të cilit u bë e njohur se fëmijët me prindër autoritar demostrojnë shkallë më të ulët të fleksibilitetit psikologjik. Kjo mund të jetë si pasojë e mënyrave të rritjes të fëmijëve që përdorin prindërit me ta. Kështu, edhe pse janë në gjendje të menaxhojnë emocionet e tyre, ata janë më pak të aftë t'ua lehtësojnë emocionet.

Studimet kanë treguar se ngrohtësia prindërore ndikon në rritje e inteligjencës emocionale. Ndërkohë që stili autoritativ i prindit, që parashikon ngrohtësi nga ana e tij në sjelljen ndaj fëmijës, e ndihmon atë të rregullojë emocionet, si dhe të jetë kompetent në aspektin emocional. Kampioni i këtij studimi me pjesëmarrës nga Fier Shqipëria (K_F) 42.9% (N = 203) dhe Prishtine Kosova (K_p) 57.1% (N = 270) parashikon ngrohtësi nga ana e prindit në sjelljen ndaj fëmijës.

Në këtë studim janë përfshirë 473 pjesëmarrës, 38.5% (N = 182) nga të cilët kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 61.5% (N = 291) të gjinisë femërore.

Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur tre pyetësorë: 1)pyetësori demografik, 2)ai mbi “Tiparet e Inteligjencës Emocionale” (Trait Emotional intelligence Questionnaire, TEIQ) 3) dhe pyetësori “Stilet e Autoritetit Prindëror (PAQ), të cilat janë përkthyer dhe përshtatur për kontekstin.

Testi dhe analiza e regresionit linear janë përdorur për të arritur rezultatet. Studimi ka arritur në dallime të rëndësishme mbi totalin e inteligjencës emocionale të paraqitur mes pjesëmarrësve (kampionit) nga Fieri Shqipëria dhe atyre nga Prishtina Kosova ndërsa sipas gjinisë, nuk pasur dallime.

E rëndësishme konsiderohet korrelacioni gjetur mes marrëdhënis mbi totalit të inteligjencës emocionale me stilin autoritar dhe atë autoritativ fleksibël të prindërve përkatës. Stili autoritativ fleksibël i nënës dhe i babait ishin parashikues mbi nivelin e inteligjencën emocionale, e cila mund të përmirësohet me rritjen e moshës dhe me kalimin e viteve të arsimimit.

Mbi bazën e përfundimeve të këtij studimi sugjerohet se është shumë e rëndësishme të vëzhgohet korrelacioni lidhshmëria e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit, të cilët shërbejnë si çelës për të përmirësuar të kuptuarin e kësaj marrëdhënie dhe, njëkohësisht, për rëndësinë e afrimit të strategjive që përmirësojnë inteligjencën emocionale dhe sjelljen e prindërve.

Fjalë kyç: inteligjencë emocionale, stili tolerant, stili autoritativ, stili fleksibël, Shqipëri-Kosovë.

ABSTRACT

The goal of this research is to evaluate the relationship between traits of emotional intelligence with parenting styles in a sample from Fier Albania and Prishtin Kosova.

Emotional intelligence is characterised by the ability to perceive, facilitate, understand and regulate one's emotions. These skills contribute to the accurate expression of emotions, and in using emotions to motivate, plan and achieve. It has been argued that parenting style can

influence the extent of emotional intelligence in children. While genetic factors play a role in this, many studies have been conducted to find What specific parenting styles produce an increased level of emotional intelligence in children. Components of parenting include the extent to Which the parents are involved, the extent to Which they encourage independent decision-making and self-initiation, warmth (parent's sensitivity towards the child), and authority.

Studies have shown that adopting an authoritative parenting style is a significant predictor of emotional regulation. For example, a study on adolescents found that children of authoritative parents tend to have better social skills and empathy. Another study also found a significant correlation between authoritative parents and emotional intelligence. However, another finding suggests that adolescents with authoritarian parents demonstrated lower psychological flexibility. This may be due to strict upbringing which means that although they are able to manage their emotions adequately, they are less able to facilitate their emotions. Studies have also shown that warmth is associated with an increased level of emotional intelligence. While an authoritative parenting style enables a child to regulate their emotions, adopting warmth as a parenting style generates the motivation for a child to be able to achieve emotional competency.

The research involved 473 participants, were male 38.5% (N = 182) and 61.5% (N = 291) female. For the collection of data we used three questionnaires; Demographic questionnaire, Trait Emotional intelligence Questionnaire, TEIQ, and Parenting Authority Questionnaire, which was translated and validated in our context. The analysis of the Pearson's correlation, T-Test and Linear regression is provided the results of this study. The study found a significant differences in total of emotional intelligence between Fier Albania and Prishtin Kosova but did not found gender differences in TEIQ. A significant correlation was found between global emotional intelligence and authoritarian and flexible parent's style. Mather and fathers flexible style is

found to be a significant predictor for emotional intelligence. Emotional intelligence was found to be increased with age and years of education. Findings suggest that it is important to explore emotional intelligence with the parenting style as a key for improving our understanding about this relationship but also for the importance of providing strategies to improve both emotional intelligence and parenting approach.

Keywords: emotional intelligence, permissive style, authoritarian style, flexible style, Albania, Kosovo,

PËRCAKTIMI I TERMAVE

Inteligjenca emocionale është aftësia e individëve për të njohur dhe menaxhuar emocionet e tyre, si dhe emocionet e njerëzve të tjerë. Individët me inteligjencë emocionale të lartë e kanë më të lehtë të kuptojnë gjendjen e tyre psikologjike, të krijojnë marrëdhënie me njerëzit e tjerë dhe t'i ruajnë ato, të menaxhojnë në mënyrë efektive stresin, si dhe janë më të mbrojtur ndaj problemeve psikologjike.

Tiparet e inteligjencës emocionale i referohen veçorive të cilat mund të përkufizohen zyrtarisht si një përmbledhje e perceptimeve emocionale, vlerësuar përmes pyetësorëve dhe shkallëve të klasifikimit (Petrides, 2010) për këtë qëllim. Tiparet e inteligjencës emocionale në thelb kanë të bëjnë me perceptimet tona mbi botën tonë të brendshme. Një etiketë alternative për të njëjtin ndërtim është tipar emocional i vetë-efikasitetit

Vetëbesimi është mënyra se si ne vlerësojmë veten tonë, perceptimet dhe besimet se kush jemi dhe çfarë jemi të aftë të bëjmë. Vetëbesimi mund të influencohet shumë nga mënyra se çfarë perceptimesh kanë të tjerët ndaj nesh.

Motivimi si koncept lidhet me aftësinë për të drejtuar veten drejt objektivave, si dhe dëshirën për t'u përmirësuar dhe arritur nivele të caktuara. Ajo është e lidhur me aftësinë e individit për të organizuar qartë qëllimet e tij dhe të mos hezitojë për të pasur iniciativë.

Motivimi lidhet dhe me aftësinë për të ecur përpara sidomos kur ballafaqohesh me pengesa në arritjen e qëllimeve.

Rregullimi emocional lidhet me aftësinë për t'i kuptuar ndjenjat personale, për t'i identifikuar dhe për të mos i lejuar t'i shtypin qëllimet. Personat të cilët kanë shkallë të lartë të rregullimit emocional janë në gjendje t'i tolerojnë vetes dobësitë, janë të hapur emocionalisht, janë në gjendje t'u bëjnë ballë presioneve dhe të lehtësojnë veten e tyre nga emocionet.

Lumturia është një ndjenjë ose gjendje kënaqësie, gëzimi i madh që përjetohet nga njeriu. Personat të cilët janë të lumtur kanë aftësi t'i përjetojnë emocionet pozitive dhe janë të prirë që ta pranojnë veten ashtu siç janë.

Empatia është aftësia që të bashkohesh dhe të kuptosh situatën, ndjenjat dhe motivet e tjetrit. Përshkruhet si aftësia për të qenë i vetëdijshëm për ndjenjat dhe emocionet e tjetrit. Është një çelës element i inteligjencës emocionale, pasi shërben si lidhje mes vetes dhe të tjerëve.

Empatia shpjegon se si individit kupton përjetimin e eksperiencave të të tjerëve, sikur ai apo ajo të ishte duke i përjetuar vetë ato.

Vetëdijesimi social është aftësia për të qenë në dijeni të problemeve sociale, ku përfshihen dhe vështirësitë me të cilat përballen thuajse për ditë grupet sociale.

Ky term nënkupton edhe aftësinë për të ndjerë dhe për të simpatizuar me gjendjen psikologjike të një individit, përmes ndjenjave që janë në përputhshmëri me kontekstin social.

Kontrolli i impulsive i referohet aftësisë për të kontrolluar emocionet apo sjelljen kur ballafaqohesh me ngasje (tundime) apo impulse. Si proces njohës ai është i domosdoshëm për individin që të kontrollojë sjelljen dhe të jetë shoqërisht i pranueshëm.

Perceptimi emocional i referohet kapacitetit dhe aftësisë për të njohur dhe identifikuar emocionet e të tjerëve, përmes reagimit fiziologjik. Gjithashtu ai u referohet aftësive për të marrë vendimin e duhur mbi eksperiencat e të tjerëve përmes interpretimit të reagimeve të tyre fizike dhe përdorimit të sistemit të shqisave, për afrimin e tyre në paraqitje mendore. Aftësia për të kuptuar emocionet besohet të jetë e lindur dhe subjekt i ndikimit mjedisor, i cili gjithashtu është një komponent kritik në ndërveprimet sociale. Përjetimi dhe interpretimi i emocioneve varet nga mënyra se si perceptohen ato.

Menaxhimi i stresit i referohet aftësisë për të kontrolluar stresin. Personat me aftësi të larta të menaxhimit të stresit përdorin strategji efektive të ballafaqimit me stresin, duke mos e lejuar këtë të fundit të prishë dinamikat fizike dhe psikologjike.

KAPITULLI I

1 - Hyrje

Njeriu është qenie komplekse për nga ndërtimi dhe zhvillimi, sepse në formimin e integritetit të tij fizik dhe psikik janë të integruar shumë faktorë socialë, biologjikë, si dhe ndërveprimi mes tyre. Si rrjedhojë, individi është produkt i rrethanave specifike, që skalitin karakteristika specifike të personalitetit dhe të vlerave të tjera të rëndësishme individuale dhe familjare. Në këtë kontekst praktikat e prindërimit shikohen si një faktor i rëndësishëm jo vetëm në arritjen akademike të fëmiut por edhe në zhvillimin e qëndrimeve, motiveve, vlerave, besimeve, si dhe fuqisë së vetbesimit që lehtësojnë negocimin e shumë proceseve individuale dhe shoqërore.

Inteligjenca emocionale karakterizohet nga aftësia për të kuptuar, për të menaxhuar, për të lehtësuar dhe për të rregulluar emocionet. Këto aftësi e ndihmojnë individin për rregullimin e emocioneve si dhe përdorimin e tyre për të motivuar, për të planifikuar dhe për të arritur objektivat jetësore. Të kuptuarit e inteligjencës emocionale është e rëndësishme si në fushën e psikologjisë klinike, edukative dhe industrial. Individët të cilët janë kompetent në fushën e inteligjencës emocionale kanë më shumë të arritura positive akademike dhe sociale. Shumë njerëz kanë paaftësi për të drejtuar emocionet e tyre dhe po ashtu të mos jenë të vetdijshëm për gryerjen që I bëjnë emocionet kohezionit shoqëror. Inteligjenca emocionale është një arritje në fushën e psikologjisë e cila ka marrë një vëmendje shumë të madhe në katër dekadat e fundit. Ajo përfshinë në konceptin e saj se si proceset njohëse dhe emocionale ndërveprojnë për të përmirësuar të menduarit. Emocionet si zemërimi, lumturia dhe frika, si dhe gjendjet e humorit,

preferencat dhe gjendjet trupore, ndikojnë se si njerëzit mendojnë, marrin vendime dhe kryejnë detyra të ndryshme.

Shkencat shoqërore mbi inteligjencën emocionale mbështesin nocionin se emocionet janë funksionale kur informacioni që ata ofrojnë interpretohet me saktësi, integrohet në të menduarit dhe sjelljen dhe menaxhohet në mënyrë efektive. Sipas teorisë së inteligjencës emocionale, ndryshimet njohëse, fiziologjike dhe të sjelljes që shoqërojnë përgjigjet emocionale janë adaptive dhe se këto ndryshime na përgatisin për t'iu përgjigjur ngjarjes që shkaktoi emocionet. Teoria pohon gjithashtu se emocionet shërbejnë si funksione të rëndësishme sociale, duke përcjellë informacione për mendimet, synimet dhe sjelljen e njerëzve të tjerë. Në të vërtetë, aftësia për të integruar informacionin emocional në aktivitete njohëse është thelbësore për funksionimin efektiv gjatë gjithë jetës

Gjithashtu inteligjenca emocionale është një evolucion në modelet e vetë inteligjencës së përgjithshme. Në vend që të shikonte inteligjencën në mënyrë rigoroze, aq sa një njeri i angazhuar në detyra analitike të lidhura me kujtesën, arsyetimin, gjykimin dhe mendimet abstrakte, teoricienët dhe hetuesit filluan ta konsideronin inteligjencën si një grup më të gjerë të aftësive mendore. Kështu që koncepti i përgjithshëm i inteligjencës së njeriut duke përfshirë kapacitete si inteligjenca intrapersonale, dhe aftësinë për të monitoruar emocionet dhe gjendjen e të tjerëve (inteligjenca ndërpersonale), ka siguruar një sfond të pajtueshëm për të konsideruar inteligjencën emocionale si një konstrukt të rëndësishëm.

Në kuadër të argumenteve mbi ndërlidhjen e inteligjencës emocionale me funksione të tjera, është argumentuar gjerësisht dhe stili prindëror. Ndërsa faktori gjenetik mendohet të ketë ndikim në inteligjencën emocionale, shtrohet pyetja nëse ajo ndikohet nga stili prindëror, si një

faktor i pakontestueshëm i zhvillimit të fëmijut. Vitet e fundit janë duke u bërë shumë studime për të kuptuar se cilët janë faktorët, të cilët ndërmjetësojnë ekspresionin gjenetik të inteligjencës emocionale.

Në studimin aktual shtrohet pyetja se si ndikon e cili stil i prindërimit ka shumë influencë në nivelin e inteligjencën emocionale. Stili i prindërimit lidhet me faktin se sa prindërit përfshihen në jetën e fëmijës duke inkurajuar pavarësinë, iniciativën, motivimin, menaxhimin e emocioneve dhe stresit, komponentë këto shumë të rëndësishëm për inteligjencën emocionale. Studimi në fjalë është unik sa i takon përmbajtjes së tij pasi ka për qëllim të studiojë inteligjencën emocionale dhe lidhshmërinë me stilet e prindërimit në prefekturën (rrethin) e Fierit Shqipëri dhe në prefekturën (rajonin) e Prishtinës Kosovë. Ndërsa sipas modelit të aftësisë së inteligjencës emocionale, secila aftësi influencën se si individët përdorin emocionet për të lehtësuar mendimin ose rregullojnë emocionet për t'u përqëndruar në informata të rëndësishme, ky studim ngre me të drejtë pyetjen se a influencohet inteligjenca emocionale nga stili i prindërimit. Duke qenë qeniet njerëzore shoqërohen përgjatë gjithë jetës së tyre nga emocionet dhe interaksioni me të tjerët, në mënyrë të vecantë me prindërit do të ishte shumë e rëndësishme të kuptohen kahjet e kësaj marrëdhënie.

Bazuar në literaturën e deri tanishme janë identifikuar dimensionet kryesore të prindërimit që janë të rëndësishme për studimin e inteligjencës emocionale: përgjegjësia prindërore, kërkesa pozitive prindërore, kërkesa negative e prindërve dhe stërvitja e emocioneve prindërore.

Këto dimensione lidhen me kombinimin e ngrohtësisë prindërore, të kujdesit dhe të mbështetjes, ndërkohë që kërkesat prindërore lidhen me praktikën e përgjegjshme të prindërimit. Përgjegjësia pozitive përfshin praktikën prindërore siç janë monitorimi dhe mbikëqyrja, kontrolli i sjelljes,

dhënia e autonomisë, kërkesat dhe pritshmëritë e përshtatshme të pjekurisë dhe disiplinim pozitiv. Përgjegjësia prindërore shoqërohet me rezultate pozitive në zhvillimin e fëmijëve, si vetë-rregullimi më i lartë i fëmijëve dhe sjellja adekuate në përputhje me normat shoqërore, vetëvlerësim më i lartë.

Përgjegjësia prindërore, stërvitja e emocioneve prindërore dhe kërkesa pozitive e prindërve lidhen me inteligjencën më të lartë emocionale të fëmijëve, ndërsa kërkesat negative të prindërve lidhen me inteligjencën më të ulët emocionale të fëmijëve.

Shqipëria dhe Kosova për shkak të kontekstit historik kanë kaluar periudha, të cilat kanë formësuar dhe orientimin e këtyre dy shoqërive në drejtime të ndryshme të sjelljes ndaj individit. Ndonëse këto shoqëri mund të konsiderohen të përafërta, duket se në Shqipëri, ndryshe nga çfarë ndodh në Kosovë, vitet e fundit sjellja po shkon drejt individualizimit.

Vitet e fundit, komponenti i inteligjencës emocionale është vendosur në vëmendjen të shkencës si një tentativë esenciale për të shpjeguar sjelljen e individit, sidomos në shoqërinë e sotme ku ka shumë stres. Për popullaritetin e inteligjencës emocionale flet qartë edhe numri i madh i botimeve ku trajtohet ky problem. Sipas Furnham (2012), ndonëse inteligjenca emocionale ka dalë në pah vetëm 21 vitet e fundit, numërohen më shumë se 10 000 libra akademike, kapituj dhe artikuj vetëm kushtuar kësaj teme. Botimet kanë dalë që nga koha kur ky komponent është paraqitur për herë të parë në literaturën e Psikologjisë.

Disa hulumtime tregojnë se në dallimet kulturore (individualizmi kundrejt kolektivizmit) ekziston një gamë e gjerë ndryshimesh, pasi konstrukti i inteligjencës emocionale është i lidhur ngushtë me emocionin që përbën dhe thelbin e kulturës.

Nëse krahasojmë shoqëritë me karakter kolektiv, me ato që kanë karakter individualist, këto të fundit janë më efektive në njohjen dhe të kuptuarit e emocioneve të tyre duke raportuar reagime emocionale verbale dhe jo verbale më të shprehura, kanë më pak gjasa të shtypin emocionet e tyre, janë më të sigurt, janë më pak impulsive, kanë tendencë për të parë dhe për të paraqitur veten pozitivisht (vetë-respekt të lartë), janë më të lumtura, kanë tendencë të jenë më optimistë, shfaqin mundësi më të mëdha për të përballuar stresin, kanë aftësi më të mëdha social), dhe janë më të motivuara (Jandt, 2010).

Përmbledhja e këtyre hulumtimeve tregon qartë se kultura ndikon dukshëm në inteligjencën emocionale.

Fieri dhe Prishtina ashtu si dhe 2 vendet ku bëjnë pjesë Shqipëria dhe Kosova për sa i përket autonomisë personale mund të kenë dallime. Prindërit që kanë në kulturën e tyre konceptin e pavarësisë për trashëgimtarët e tyre, janë të shqetësuar që në moshë të vogël të edukojnë fëmijët e tyre me një princip të fortë të "vetes". Aftësia për të fituar pavarësinë, këmbënguljen dhe të shprehurit e lirshëm që në moshë të re është e theksuar te kjo kulturë prindërore.

Nga ana tjetër, prindërit që karakterizohen nga koncepti i ndërvarësisë, duket qartë se në stilet e tyre të prindërimit i kushtojnë rëndësi të veçantë në njësisë familjare (Rothbaum, Morelli, Pott, & Liu, 2000).

Sipas mendimit të tyre, respektimi i autoritetit brenda familjes, siguron vendin dhe respektin ndaj njëri-tjetrit. Ata parashikojnë gjithashtu që këta fëmijë t'i binden autoritetit dhe të mësojnë e të kenë karakter të mirë moral në jetë.

Koncepti i pavarësisë te ky stil prindëror është i lidhur ngushtë me të qenit anëtarë dhe kontribuues të familjes, larg zhvillimit të "ndjenjës ndaj vetes" (Rothbaum et al, 2000).

Stilet prindërore varen shumë nga konteksti kulturor ku ata janë rritur dhe zhvilluar. Shqipëria dhe Kosova gjatë dy dekadave të fundit janë përfshirë nga një mori ndryshimesh në të gjitha nivelet e funksionimit të individit dhe të shoqërisë si në sferën politike, atë ekonomike dhe sferën sociale.

Në një tranzicion të tillë ku ndihet një mospërputhje e dukshme mes gjeneratave, është e domosdoshme që të kuptohen qëndrimet, të cilat përcillen përmes gjeneratave dhe kush janë faktorët të cilët do të lehtësojnë këtë proces. Ky studim sigurisht që i referohet influencës së stilit prindëror tek të rriturit që tashmë mund ose janë prind vetë. Edhe pse këta të rritur ju referohen stileve të prindësimit në të kaluarën e tyre, mendojmë që eksperiencat e tyre janë shumë të rëndësishme për literaturën psikologjike, sociale dhe pedagogjike pasi do të ndihmojnë në formësimin e praktikave të mira në raport me edukimin e inteligjencës emocionale në komunitetin shqiptar por jo dhe vetëm.

Edhe pse formimi emocional varet dukshëm nga strukturat biologjike dhe, pavarësisht nga këto, funksionimi i lidhjeve neuronale është subjekt i ndërveprimit intra dhe inter personal të njeriut.

Por te çdo individ, me veçoritë e zhvillimit si një qenie e gjallë, rol të rëndësishëm luan mjedisi. Ka shumë mënyra se si ambienti ndikon dhe formon sjelljen e individit dhe të familjes. Prandaj për të pasur një pasqyrë më të qartë funksionimi të individit si të tillë, është logjike që, përveç predispozitave biologjike dhe aftësive të lindura, të hulumtohen edhe efektet e mjedisit në formësimin e personit në fjalë, prej kontaktit të parë me botën e deri në vdekje.

Prindërit luajnë rol të madh në formimin emocional të individit, por edhe në ngulitjen e besimeve, ideve, sjelljeve, etj. Kjo kërkohet pavarësisht prej stilit të prindërimit në bazë të së cilit një person është ekspozuar. Më pas një gjë e tillë vërehet në krijimin e lidhjeve me

personat e rinj në jetë, në adaptimin me situata të reja, por edhe në sjelljeve antisociale dhe prosociale.

Filozofia e prindërimit është e ndikuar nga mënyra se sa rëndësi i kushtojnë prindërit kësaj çështje, të tilla mënyrat e disiplinimit dhe cilat janë perceptimet gjinore brenda familjes. Disa prindër kanë një ide të veçantë prindërore në mendje, ndërsa të tjerët kanë një qasje më pak të specifikuar. Gjithashtu filozofia prindërore gjithashtu merr parasysh temperamentin dhe motivimin për të pasur fëmijë. Familja e origjinës ushtron një ndikim të madh mbi llojin e prindit që një individ bëhet. Shumë besime, vlera, zakonet dhe modelet e mendimit janë rrënjësor përmes jetës së hershme familjare. Megjithatë njerëzit janë shumë të aftë të prindërojnë ndryshe nga ç'kanë bërë prindërit e tyre, është e natyrshme që prindërit ua mësonin mësimet e para se si të bëhesh prind. Për shkak se partnerët prindër shpesh vijnë në prindër me përvoja të ndryshme familjare, është e llogjikshme të kemi prindër me stile të ndryshme apo edhe me të njëjtë. Në këtë kontekst mund të sugjerojmë që familjet shqiptare në Fier Shqipëri dhe Prishtinë Kosovë mund të kenë ndryshime në dominimin e stilit prindëror. Asnjë studim nuk është gjetur në literaturën shqiptare e cila ka marrë në konsideratë të shohë faktorët që ndikojnë në stilet që përvetson një individ si prind. Gjithashtu feja, ose mungesa e fesë, mund të ndikojë në filozofinë prindërore. Prindërit që e vendosin fenë në listën e tyre prioritare shpesh përfshijnë këto besime në prindërimin e tyre. Familjet fetare priren të kenë rregulla dhe norma në jetën familjare që pasqyrojnë ato të kishës së tyre dhe koha e familjes shpesh ndërtohet rreth pjesëmarrjes dhe ndikimeve në kishë. Familjet që nuk kanë lidhje të forta fetare mund të krijojnë ideale familjare nga burime të tjera. Ndonjëherë, prindërit sjellin përvoja ose besime fetare të mëparshme në jetën familjare, edhe nëse ato nuk janë veçanërisht aktive në besimn e tyre.

Edhe në këtë kontekst Kosova dhe Shqipëria janë dy mjedise të ndryshme, pasi pjesmarrësit e këtij studimi në Fier janë individë të rritur në një mjedis më pak besimtarë krahasuar me atë në PrishtinëKosovë.

Edhe pse Shqipëria dhe Kosova kanë një kulturë konteksti zhvillimor social, ekonomik, politik dhe psikologjik ka qenë i ndryshëm. Kjo e bën këtë studim unik.

Si përfundim studimi i inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, ndërlidhjet, kundërtëhëniet, dhe bashkëveprimet japin një pamje të rëndësishme në atë se çfarë e bën një person ai që është, dhe me të qarta janë përfundimet kur kuptojmë stilin e prindërimit dhe inteligjencën emocionale të prindërve.

Komponentët e inteligjencës emocionale si vetëbesimi, motivimi, kontrolli emocional, perceptioni dhe shprehja e emocioneve, përshtatshmëria, impulsiviteti dhe afekti që janë studiuar në këtë punim janë parë në lidhshmëri me influencën e stilit prindëror. Për shkak se stilet dhe praktikatat e prindërve parashikojnë shumë rezultate zhvillimore, ka kuptim të besohet se ato mund të parashikojnë gjithashtu inteligjencën emocionale të fëmijëve. Ka një rëndësi të madhe ky studim pasi realizohet në dy vende të cilat kanë të njëjtën kulturë, por që sistemi i edukimit ka qenë i ndryshëm dhe nuk mund të mos ndërtojme dhe hipotezën që kjo mund të ketë influencuar jo vetëm stilin prindëror por edhe inteligjencën emocionale të individëve brenda këtyre shoqërive. Gjithësesi studimi edhe pse nuk është në gjendje të përfshijë të gjithë faktorët që ndërlidhin këto dy variabla gjithësesi do të hapi rrugë për hulumtime të tjera.

Ky studim është i një rëndësie të veçantë për fushën e psikologjisë dhe shkencave sociale pasi ndërthur në mënyrë të veçantë faktorët individual dhe familjar.

Inteligjenca emocionale për herë të parë studiohet në trevat e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Të gjithë profesionistët e psikologjisë janë të interesuar që në Shqipëri dhe në Kosovë të kryhen intervenime (ndërhyrjeve) të cilat janë të përshtatshme ndaj kulturës për të mënjanuar shabllonizmin dhe kopjimin e intervenimeve nga vendet e zhvilluara.

Ky studim ne Fier e Prishtine do të japë një informacion të rëndësishëm mbi dinamikat shqiptare në formimin e individit dhe dallimin në mes dy rajone te te dy vendeve (Shqipërisë e Kosovës)

1.1.Qëllimi:

Ky studim ka për qëllim vleresimin(njohjen) e inteligjencës emocionale dhe identifikimin e marrdhenies mes inteligjences emocionale me stilet e prindërimit në një kampion me popullsi shqiptare: rajonin Fierit ne Shqiperi e Prishtines ne Kosove.

Objektivat e studimit

Matja e inteligjencës emocionale për popullatën Shqiptare në Fier (Shqipëri) dhe Prishtine (Kosovë).

Të identifikojë lidhshmërinë mes inteligjencës emocionale dhe stilit të prindërimit në Fier.

Të identifikojë lidhshmërinë mes inteligjencës emocionale dhe stilit të prindërimit në Prishtine.

Të identifikojë dallimet e raportimit te inteligjencës emocionale dhe të stilit të prindërimit me ndryshimet demografike në zonen e Fierit (Shqipëri)

Të identifikojë dallimet e raportimit te inteligjencës emocionale dhe të stilit të prindërimit me ndryshimet demografike në zonen e Prishtines (Kosovë).

Pyetja kërkimore

1.Cili është ndikimi i inteligjencës emocionale në stilin prindëror ?

2. A ka dallime mes raportit të inteligjences emocionale me stilin e prindërimit në Fier dhe Prishtine?

3.Si ndikon mbi raportin e inteligjences emocionale ne Fier e Prishtine niveli i i arsimimit te prinderve?

4.Si ndikojne dallimet gjinore e te moshes ne raportin e inteligjences emocionale ?

Hipoteza e studimit

H1. Stili prindëror është i përcaktuar nga dimensionet e inteligjencës emocionale.

H2. Ekziston lidhje e rëndësishme mes inteligjencës emocionale dhe stileve prindërore

H3. Nuk ka dallime të rëndësishme në raportimin e inteligjencës emocionale midis Fierit (Shqipëri) dhe Prishtines (Kosovë) në lidhje me nivelin e arsimimit të prindërve.

H4. Ekzistojnë dallime gjinore dhe te moshes në raportimin e inteligjencës emocionale.

1.3 Struktura e punimit

Ky punim ka pesë kapituj të cilët janë të ndërlidhur me njëri- tjetrin në varësi të qëllimit kryesor dhe të hipotezave të shtruara.

Kapitulli i parë përshkruan nevojën për një studim të tillë, shtrirjen e kontekstit të problemit, që ka marrë në konsideratë ky hulumtim, duke përshkruar arsyet logjike të këtij

punimi. Ndërkohë janë paraqitur disa gjurmime, të cilat shtrojnë rrugën për një studim të tillë në Republikën e Shqipërisë (Fier) dhe të Kosovës(Prishtine)

Gjithashtu në këtë kapitull parashtrohen pyetja hulumtuese objektivat, hipotezat kryesore dhe nën hipotezat. Po ashtu këtu gjen dhe informacione mbi metodologjinë e përdorur dhe strukturën e punimit.

Kapitulli i dytë. Në këtë kapitull bëhet një paraqitje dhe analize e tërë literaturës në raport me konceptet që e ndërtojnë spektrin e tipareve të inteligjencës emocionale si dhe të komponentëve që e përbëjnë atë si dhe mbi stilet e prindërimit. Janë përshkruar të dhëna mbi evoluimin e këtij koncepti në fushën e psikologjisë si dhe janë shqyrtuar fakte pro dhe kundër vlerësimit të saj.

Në pjesë të ndryshme ky punim hedh dritë mbi fakte të cilat i kanë shërbyer psikologjisë për të krijuar konstruktin e tipareve të inteligjencës emocionale. Ka një përshkrim të modeleve të inteligjencës emocionale.

Në kapitull shpjegohen edhe stile të prindërimit si koncepte dhe njëkohësisht afrohet literaturë e bollshme mbi studimet e kryera në këtë fushë. Një shfletim i kujdesshëm i literaturës është bërë mbi lidhshmërinë e inteligjencës emocionale me stilin tolerant, autoritarian dhe autoritativ fleksibël të nënës si dhe lidhshmëria me stilin tolerant, autoritarian dhe autoritativ fleksibël të babait.

Kapitulli i tretë përfshin metodologjinë e hulumtimit, procedurat, pjesëmarrësit, mbledhjen e të dhënave, instrumentet dhe analizat e të dhënave. Analiza përshkruese është përdorur për të pikëzuar ndryshimet mes mesatares aritmetike (M) dhe devijimit standard (SD). Koeficienti i besueshmërisë Alfa e Cronbach është përdorur për të vlerësuar

qëndrueshmërinë e brendshme të pyetësorëve. Sa më afër vlerës 1 të jetë ky koeficient aq më e lartë është besueshmëria e pyetësorit. Mesataret janë nxjerrë duke bërë mbledhjen e shumës së pyetjeve dhe janë pjesëtuar për numrin e tyre.

Për të eksploruar lidhshmëritë e mundshme mes inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit është përdorur testi i korrelacionit të Pearsonit. Kjo analizë është parë e lidhur ngushtë me hipotezat e këtij studimi.

Kapitulli i katërt shtjellon rezultatet. Në të përshkruhet analiza e lidhjeve për nënshkallët dhe faktorët e inteligjencës emocionale (përshtatshmëria, vetëbesimi, shprehja emocionale, motivimi, rregullimi emocional, lumturia, empatia, vetëflijimi social, Kontrolli i impulseve, perceptimi emocional, menaxhimi i stresit, menaxhimi i emocioneve, optimizmi, marrëdhënia, vendosmëria, si dhe katër faktorët e inteligjencës emocionale: mirëqenia emocionale; vetëkontrolli; emocionaliteti; shoqërizimi dhe shkalla globale e inteligjencës emocionale (Totali i TEIQ).

Më pas, janë paraqitur analiza e regresionit linear për përcaktimin e shkallës së parashikimit të stileve të prindërimit (stili tolerant i nënës, stili autoritarian i nënës, stili dhe autoritativ fleksibël i nënës; stili tolerant i babait, stili autoritarian i babait si dhe stili dhe autoritativ fleksibël i babait).

Në një analizë të veçantë janë përshkruar dallimet në raportimin e shkallëve të inteligjencës emocionale në raport me gjininë, si dhe një përshkrim i kujdesshëm i është bërë rezultateve të dallimit të këtyre shkallëve në kampionin e Fierit Shqipërisë dhe atë të Prishtinës Kosovës. Rezultatet përmbillen me dallimet të cilat janë gjetur në shkallët e inteligjencës

emocionale si dhe me një analizë të lidhjeve mes totalit të TEIQ me moshën, me vitet e arsimimit, të ardhurat në familje duke bërë të ditur dhe se me cilën dorë shkruajnë pjesmarresit.

Kapitulli i pestë përshkruan diskutimin e gjetjeve si dhe përfundimet e këtij studimi.

Kapitulli II

2-1 - Inteligjenca emocionale – vështrim i përgjithshëm

Inteligjenca emocionale i ka rrënjët në inteligjencën sociale, në të cilën vlerësohet si aftësia apo kapaciteti që të kuptojmë, të matim dhe të menaxhojmë jo vetëm emocionet tona, por dhe emocionet e të tjerëve (Nazanin, 2011).

Termi inteligjencë është paraqitur në literaturën shkencore për herë të parë në vitin 1990 dhe që nga ajo kohë vazhdon të jetë një nga fushat më nxitëse për të gjithë ata hulumtues, që përpiqen të japin shpjegime të ndryshme mbi inteligjencën emocionale dhe njëkohësisht të krijojnë metoda më të mira që të kuptojmë atë.

Si rrjedhojë, ajo ka marrë një vëmendje të konsiderueshme për të gjeneruar aplikimin e saj në edukim, në psikologji klinike dhe në organizata (Petrides, 2010).

Por për të pasur një kuptim më të mirë rreth inteligjencës emocionale dhe për t'i adresuar vërtet konceptet e saj, duhet të kemi një kuptim më të qartë rreth emocioneve dhe inteligjencës (Mayer, Salovey & Caruso, 2004; Mayer & Salovey, 1997).

2.2 Inteligjenca emocionale

Karakteristikat e inteligjencës emocionale bëhen më të ndjeshme, nëse kemi të qartë përdorimin e koncepteve të para të inteligjencës nga pionierët e saj, nga edhe rrjedhin apo dalin rrënjët e saj.

Fakti që individët dallojnë nga mënyra se si gjenerojnë njohuritë e tyre, si adaptohen në mjedise të ndryshme dhe situata të reja, si i kuptojnë emocionet e tyre dhe të tjerëve, si kuptojnë mendimet abstrakte dhe si përdorin mënyra të ndryshme të të kuptuarit ka bërë që pionierët e parë të shfaqin interesin mbi inteligjencën.

Rrënjët e para të fillimi të studimit dhe të kuptimit të inteligjencës gjenden në punën e kryer nga Alfred Binet dhe Theodor Simone në shek. XX.

Pavarësisht nga informacionet që kanë pranuar dhe mënyra se si kanë operuar ata kanë rezultuar në forma të ndryshme të inteligjencës. Kështu, format e para të të kuptuarit i ka paraqitur në punën e tij Spearmani, i cili arriti të formojë një koncept për inteligjencën gjeniale.

Thorndike e shikonte inteligjencën të përbërë nga tri pjesë: inteligjenca abstrakte, ajo mekanike dhe inteligjenca sociale. Rëndësi të veçantë i kushtoi ai inteligjencës sociale krahasuar me format e tjera të inteligjencës, me të cilat formuloi dhe përcaktoi si të kuptuarit e të tjerëve ashtu dhe të vepruarit me mençuri në marrëdhëniet interpersonale.

Duke analizuar pikëpamjen e Spearmanit, Thurstone shfaqet kritik mbi inteligjencën gjeniale. Në lidhje me këtë ai deklaroi se që të kemi një të kuptuar më të qartë mbi inteligjencën duhet ta ndajmë atë në shtatë aftësi (Thurstone, 1938; Thurstone & Thurstone, 1941).

Shtatë aftësitë e inteligjencës, sipas Thurstone, janë: rrjedhshmëria e fjalëve, të kuptuarit e fjalëve, aftësitë spatiale (e vazhdueshme), aftësitë numerike, të menduarit induktiv dhe memoria.

Pikërisht në këto forma të matjes së inteligjencës mund të gjenden edhe rrënjët e para të matjes së inteligjencës emocionale.

Me zhvillimin e mëtejshëm të hulumtimeve lindën forma të tjera të të shpjeguarit të inteligjencës. Kështu Howard Gardner propozoi tetë lloje të inteligjencës.

Linguistike- si aftësi për përdorimin e fjalëve, për manipulimin e gjuhës dhe për shprehjen e kuptimit të tyre në kontekste të ndryshme.

Logjike- matematikore- si prirje për përdorimin e numrave, për analizimin e të menduarit shkencor, si dhe për përfundimet deduktive dhe produktive.

Vizuale dhe spatiale- si mundësi për perceptimin e pozitave dhe për krijimin e imazheve mentale.

Fizike- kinetike- si zotësi për përdorimin e trupit në shprehjen e ndjenjave dhe të ideve si vallëzimi, gjuha trupore dhe sporti.

Njohja e muzikës- si aftësi për prodhimin dhe kumtimin e formave muzikore të ndryshme.

Perceptimi interpersonal- për disponimin e ndjenjave dhe për motivimin e të tjerëve, për bashkëpunimin dhe komunikimin në grup me të tjerët.

Aftësitë personale- për vetënjohje, për kuptimin e disponimeve të ndjenjave, për motivimin dhe për aftësinë vepruese të bazuar në njohurit tona.

Aftësia *naturaliste* është zotësia për të dalluar fenomenet natyrale në botë dhe për t'i vlerësuar ato, gjë që e bën atë si një ndër burimet me të rëndësishme të inteligjencës emocionale. Në dallim me Gardnerin, i cili tregoi për ekzistencën e tetë llojeve të inteligjencës, Sternberg paraqiti teorinë triarkive të inteligjencës. Ai njëjtësoi inteligjencën analitike, inteligjencën kreative dhe inteligjencën praktike.

Ka kritika që komponenti i tretë e inteligjencës së Sternbergut është një mbivendosje me inteligjencën emocionale, sepse kjo menaxhon aftësitë tona që t'i mbajmë vështirësitë në mënyrë eficiente dhe praktike, ku inteligjenca analitike është lloj i inteligjencës që vlerësohet nga testet e saj.

Inteligjenca kreative bën më të mundshme që të adaptohemi në situata të reja, të gjenerojmë ide të reja dhe të kemi inteligjencën praktike që kërkohet për detyrat e përditshme.

Të gjitha këto forma të ndryshme të të kuptuarit të inteligjencës dhe mënyra se si duhet të ndahet dhe matet ajo, kanë sjellë edhe përcaktime të ndryshme rreth saj, duke e bërë, pothuajse të pamundshme, të kemi një përkufizim që të përdoret nga të gjithë.

Sternberg dhe Detterman (1986), përcaktuan se si mundet që aftësia e individit të adaptohet në mjedise, duke mësuar edhe nga përvojat. Të gjitha këto mënyra të të kuptuarit të inteligjencës nga pionierët e saj influencuan në mendimin e hulumtuesve të ndryshëm, në shfaqjen e inteligjencës emocionale, të cilat për një kohe ishin studiuar si dy komponentë të ndarë. Njëkohësisht, ato e bënë atë një temë mjaft të "nxehte" studimi, në të cilën janë afruar modele të ndryshme të të kuptuarit të saj, duke krijuar metoda të ndryshme të matjes të kësaj problematike e cila, si objekt studimi, është sa e re, aq edhe e vjetër,.

2.3 Emocionet

Emocionet, procese të rëndësishme të aparatit psikik, si në mirëqenien e përgjithshme ashtu dhe në funksionimin tonë adekuat luajnë rol për krijimin e marrëdhënieve personale edhe në ato interpersonale. Kjo lehtëson aftësinë për të kuptuar emocionet tona dhe të të tjerëve dhe mundëson të jemi më fleksibël dhe të përshtatshëm me rrethin. Emocionet kanë qenë pjesë e studimit që nga kohët e lashta, përkatësisht që nga koha e filozofëve grekë deri në ditët tona, por mënyra së si janë kuptuar dhe studiuar ka ndryshuar me kalimin e kohës.

Ndonëse kanë qenë të studiuara për një kohë të gjatë, është shumë e vështirë të gjendet një përkufizim ekzakt dhe unanim. Edhe në të ardhmen do të jetë i vështirë ky problem nëse nuk arrihet një konsensus për mënyrën se si duhet të studiohet (Scherer, 2005).

Pra, emocionet si proces psikologjik përfshijnë ndërveprimet dinamike me mjedisin, të cilat sjellin stimul sensorik nga mjedisi në trupin e njeriut, pasoja tek individit për funksionimin e proceseve dhe prodhojnë efekte në mjedis (Frijda, 2008).

Studimi emocioneve mbetet një ndër kapitujt më konfuzë, që ende qëndron i hapur në fushën e Psikologjisë. Filozofët kanë qenë të interesuar për emocionet që nga koha e Sokratit dhe përcjellësit e tij. Por ndryshimet në perceptimin e rolit të emocioneve ka qenë të ndryshme pavarësisht nga pikëpamja filozofike. Hegeli, ndonëse nuk i neglizhonte emocionet, nuk i shihte në qendër të rëndësisë. Ndërsa Aristoteli mendonte se emocionet janë kryesore për një jetë të mirë dhe se të kuptuarit e tyre është shumë i rëndësishëm.

Hulumtues të ndryshëm rivendosën idenë e Darwin- it se emocionet kanë evoluar përgjatë specieve dhe se emocionet janë shprehje universale e ndjenjave të brendshme rreth marrëdhënieve..

Studimet më konstruktive dhe të detajuara për të kuptuar rolin e emocioneve filluan në botën perëndimore, nga u krijuan një varg teorish si nga sociologët po ashtu edhe nga psikolog të ndryshëm, ku shumica e tyre pajtoheshin që emocionet duhen të interpretohen në rolin e tyre social.

Paraqitja e formave konstruktive të të kuptuarit të rolit të emocioneve vazhdon të ndryshojë dita -ditës nëpërmjet diskutimeve për mënyrat e interpretimit të tyre. Ato kanë nxjerrë në pah rolin e kontekstit kulturor në funksionin e emocioneve, që në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon përjetimin e emocioneve dhe fjalët apo frazat që përdoren për të shprehur atë (Gordon, 1989).

Në lidhje me rolin e ndryshëm të emocioneve, pavarësisht nga kultura me vlerat e ndryshme që ato përdorin, kemi edhe dallime në mënyrën se si i përdorim dhe i kuptojmë ato. Nisur nga kjo sociologë të ndryshëm analizojnë emocionet në kuadër të vlerave kulturore të internalizuara.

Kultura influencon ideologjinë rreth emocioneve dhe fjalëve që përdoren për ta shprehur atë dhe këto baza kulturore influencojnë në mënyrën si e vlerësojmë njohjen e emocioneve tona dhe të të tjerëve në situata të ndryshme dhe si i atribuojmë ato. Për rrjedhojë, kemi edhe zgjimin emocional ndaj vetes dhe të tjerëve që janë të vendosura në strukturat sociale dhe ku kultura shërben si një udhërrëfyes në këtë proces. Të gjitha këto kanë mënyrën e ndërveprimit, duke përfshirë rolin që kemi, gjestet e shprehjes dhe të formës në të cilën flasim.

Nga kjo mund të shihet influenca e rolit të kontekstit në mënyrën se si ne i perceptojmë, i përjetojmë dhe i shprehim emocionet dhe e bën shumë të rëndësishme që të kuptojmë secilën nga këto faza të lidhura drejtpërdrejt me inteligjencën emocionale.

Sipas Salovey, Dettweiler- Bedell & Mayer, (2008), perceptimi emocional, është shkalla e parë e inteligjencës emocionale, aftësia të detektojë dhe të dallojë shprehjen emocionale përmes fytyrës, në piktura, në zë dhe në arte faktet kulturore. Kjo përfshin gjithashtu aftësinë e identifikimit të emocioneve tona dhe të të tjerëve.

Mos aftësia që të kuptojmë emocionet, t'i përjetojmë dhe t'i shprehim ato na çon në një drejtim jo të mirë dhe në një përkrahje me të vogël sociale (Niedenthal & Brauer, 2012). Emocionet dhe njohja e tyre funksionojnë së bashku si një sistem i kontrollit të sjelljeve.

Emocionet shihen si një mjet shumë i rëndësishëm i ndërveprimit tonë me mjedisin, në krijimin e fakulteteve të ndryshme të komunikimit në jetën tonë sociale, përkatësisht në marrëdhëniet interpersonale dhe, si një faktor zhvillues jashtëzakonisht i rëndësishëm i mirëqenies sonë psikologjike, mbetet një fushë e gjerë hulumtuese dhe një “kapitull i hapur” studimesh. Kompleksiteti i saj zmadhohet kur nga bashkimi me inteligjencën përbëjnë atë që është një “arenë” e nxehte studimesh.

Që të kemi me të qartë rolin e emocioneve, duhet që ti shohim ato si mesazh ose si shenjë lajmëruese, prej nga reagimi emocional është një shenjë evolutive.

Njerëzit përjetojnë ndjenjat rreth asaj që ata duan, që dëshirojnë dhe që vlerësojnë konform realizimit të qëllimeve të tyre (Scheier & Carver, 1992).

Emocionet kanë komponentin motivues, prej nga emocionet motivojnë shmangien e sjelljeve problematike dhe përdorimin e një teknike më konservative, metodologjike dhe analitike në zgjedhjen e problemeve dhe komponenti i tretë është emocionet si lehtësues, prej nga eksperiencia emocionale ndërton burimet mentale, duke lehtësuar procesin e të mësuarit dhe rritjes të.

2.4 Si lindi dhe u zhvillua inteligjenca emocionale

Tradicionalisht emocionet dhe proceset njohëse janë studiuar të ndara (Frijda, 2008). Stoikët e Greqisë antike besonin se logjika është superiore në krahasim me ndjenjat, për arsye se njerëzit mund të pajtoheshin lidhur me argumentet racionale, por nuk mund të pajtoheshin me ndjenjat (Mayer, Roberts & Barsade, 2008). Ndërsa ndërlidhja ndërmjet të menduarit dhe emocioneve në kulturën perëndimore që prej 2000 vitesh (Mayer, 2001). Ndonëse në kulturën perëndimore ka ndryshime lidhur me perceptimin e emocioneve, Salovey dhe Mayer (1990), shtruan pyetjen nëse inteligjenca emocionale është kontradiktore si term, për arsye se tradita e të menduarit perëndimor i gjykonte emocionet si ndërprerje të disorganizuara të aktiviteteve mentale dhe, si pengesa të tilla, ato duhet të kontrollohen.

Romero (2008), thekson se inteligjenca emocionale nuk është ndikim i logjikës mbi djenjat, por një ndërveprim i të dyjave. Teoritë e inteligjencës emocionale paraqesin këndvështrime ndryshme, duke sugjeruar se emocionet i bëjnë proceset njohëse më të përshtatshme dhe individët mund të mendojnë më racionalisht rreth emocioneve (Brackett, Rivers & Salovey, 2011). Në lidhje me proceset funksionale të emocioneve, të njohjes dhe të mënyrës se si ato funksionojnë është parë se sistemi i neuroneve është një mekanizëm ku emocionet dhe njohja janë në ndërveprim prej perceptimit të hershëm deri në rezonim (Phelps, 2006). Ndërsa këndvështrimi i dytë, me një pikëpamje të ngjashme me atë të teorive të inteligjencës emocionale, që i mendon emocionet si përgjigje të organizuara, ato janë të fokusuara në mënyre të përshtatshme në aktivitetet njohëse dhe në veprime konkrete.

Përveç pikëpamjeve të ndryshme se si kuptohet raporti ndërmjet emocioneve dhe njohjes, në lidhje edhe me origjinën e inteligjencës emocionale, janë ofruar argumente të shumta

nga hulumtues të ndryshëm. Përdorimi i termit inteligjenca emocionale për herë të parë është bërë nga Leuner në vitin 1966, i cili tregonte se femrat e hipnotizuara, që kishin një inteligjencë të ulët emocionale, refuzonin rregullat shoqërore. Ndërsa në gjuhën angleze termi inteligjencë emocionale është përdorur nga Payne në 1986. Për një kohë të gjatë ato janë studiuar ndaras; ndonëse inteligjenca emocionale është e përbërë nga inteligjenca dhe emocionet, ajo është ndryshe prej tyre (Mayer, Roberts & Barasade, 2008).

Bashkimi i këtyre dy aspekteve dhe krijimi i inteligjencës ka kaluar faza të ndryshme, Mayer (2001). Ai thekson se kemi pesë periudha të ndryshme në mënyrën se si kuptoheshin emocionet dhe inteligjenca, të cilat në fillim studioheshin ndaras dhe me kalimin e kohës kemi përafrimin ndërmjet tyre dhe zhvillimin e inteligjencës emocionale. Në periudhën e parë, 1900-1969, inteligjenca dhe emocionet janë studiuar si të ndara, ku kemi testet e para të inteligjencës. Periudha e dytë , 1970- 1989, mund të shihet si një përafrim ndërmjet këtyre dy proceseve, ku gjatë kësaj kohe fusha e njohjes dhe afeksionit u afruan lidhur me faktin se si emocionet ndërveprojnë me të menduarit. Në periudhën e tretë, 1990- 1993, që përbën lindjen dhe zhvillimin e inteligjencës emocionale, brenda një periudhë katër vjeçare kemi një varg publikimesh nga Mayer dhe Slaovey rreth inteligjencës emocionale. Botimet treguan një fushë relevante për inteligjencën emocionale dhe krijimin e matjes së parë të kësaj aftësie. Periudha e katërt është prej vitit 1994- 1997, është koha e popullarizimit dhe e zgjerimit, është koha kur Goleman publikoi librin e tij të njohur “ Emotional Intelligence”, kur ky libër bëhet best-seller dhe një numër i konsiderueshëm i shkallëve të personalitetit janë botuar nën emrin inteligjencës emocionale. Në periudhën e pestë prej 1998- e në vazhdim përmenden një sërë hulumtime në zhvillimin e inteligjencës emocionale.

E gjithë kjo kohë e shkurtër dhe njëkohësisht një rrugë e gjatë zhvillimi e ndërlidhjes se këtyre dy proceseve dhe krijimin e asaj që njihet si inteligjencë emocionale, bënë që të jetë një nga temat më të nxehta si për hulumtim dhe debatim, duke zgjeruar përdorimin e saj në fusha të ndryshme të psikologjisë si psikologji organizative, psikologji klinike, si dhe psikologji e edukimit. Por përdorimi i saj vazhdon që të jetë i madh edhe në fusha të tjera. Që nga koha kur u përdor për herë të parë si term shkencor kemi ndryshime të qëndrueshme sidomos në drejtim përdorimit, pasi në fillimet e saj kishim një përdorim sporadik, ndërsa me kalimin e kohës kemi një rritje konstante të hulumtimeve. Koncepti i inteligjencës emocionale është bazuar në tri premisa: Së pari, duhet thënë se emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në jetë; së dyti, njerëzit variojnë në aftësitë e tyre si i perceptojnë, si i kuptojnë, si i përdorin dhe si i menaxhojnë emocionet dhe së treti, këto diferenca afektojnë përshtatjen e individit në kontekste të ndryshme, përfshirë edhe vendin e punës (Cherniss, 2010). Si rrjedhojë, janë paraqitur përkufizime dhe mënyra të ndryshme të të kuptuarit të inteligjencës emocionale.

1. Salovey and Mayer (1990, faqe 5), përcaktuan inteligjencën emocionale si nëngrup të inteligjencës sociale që përfshin aftësinë të monitorojë emocionet dhe ndjenjat e tyre dhe të tjerëve, të bëjë dallimin mes tyre dhe të përdorë këto informacione e të drejtoj të menduarit dhe veprimet e veta. Sipas tyre, kjo konsiston në tri kategori të aftësive përshtatëse si të shprehurit dhe të kuptuarit e emocioneve, të rregulluarit e tyre dhe vënia në përdorim e emocioneve për zgjedhjen e problemeve.

Një përkufizimi tjetër është ai i BarOn model:

2. *BarOn model përkufizon inteligjencën emocionale/ sociale si një shigjetë e ndërlidhur e kompetencave dhe aftësive sociale dhe emocionale që sa efektivisht determinojnë individët,*

kuptojnë dhe veten e tyre, kuptojnë te tjerët lidhen me ta dhe tejkalojnë kërkesat, sfidat dhe presionin (BarOn, 2010).

Ndër përkufizuesit e tjerë të inteligjencës emocionale është edhe Mayer and Slovey, (1997), me një ndryshim dhe zhvillim të përkufizimit të tyre rreth inteligjencës emocionale, duke u fokusuar më shumë në aspektin konjitiv (njohës) të inteligjencës emocionale.

3. *Inteligjenca emocionale përfshin aftësinë të perceptojmë saktë, të vlerësojmë dhe të shprehim emocionet, aftësinë të aksesojmë ose gjenerojmë ndjenja kur ato lehtësojnë të menduarit, aftësinë të kuptojë dhe të njohë emocionet dhe aftësinë që të rregulloj emocionet dhe të promovojë rritje intelektuale dhe emocionale.*

Ndërsa Goleman, i cili zgjeroj kuptimin e inteligjencës emocionale duke bërë atë shumë të popullarizuar e përkufizoi atë si :

4. *Inteligjenca emocionale është aftësia që të kuptoj ndjenjat e tij, të dëgjoj tek të tjerët dhe ti ndjej ata dhe të shpreh emocionet e tij në mënyre me produktive.*

Përveç këtyre përkufizimeve të inteligjencës emocionale ekzistojnë edhe përkufizime tjera që bëjnë të kuptojmë se sa është e vështirë që të kemi në mënyre unanime përdorimin e vetëm të një koncepti.

Mayer, Salovey dhe Caruso (2004), përkufizuan inteligjencën emocionale si një lloj të inteligjencës sociale, që përfshinë aftësinë që të monitoroj emocionet e tij dhe të tjerëve, manipulimin e informacioneve në menaxhimin e mendimeve dhe veprimet e veta, rregullimin e emocioneve të tij dhe të tjerëve dhe përdorimin e emocioneve të përshtatshme për zgjedhjen e problemeve dhe vështirësive ditore në mënyre efektive dhe aktivisht.

Ndërsa sipas Cherniss (2010), inteligjenca emocionale duhet të përfshijë aftësit bazike si njohja e emocioneve, rezonimi dhe rregullimi emocionale.

Si një përmbledhje i të gjitha këtyre përkufizimeve të ndryshme mund të konkludojmë se: *inteligjenca emocionale është aftësia të menaxhojmë e të kontrollojmë emocionet, të kuptojmë emocionet tona dhe të tjerëve dhe njëkohësisht ti përdorim ato në mënyre me konstruktive.*

Për përkufizime tjera të inteligjencës emocionale shih (Goleman, 2001; Nazanin, 2011; Mayer, Salovey & Caruso, 2001; Mayer et al., 2008).

Inteligjencën emocionale nga përkufizimet e ndryshme mund ta kuptojmë si një lehtësues në komunikimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve në përditshmëri, si e tillë ajo shërben si një urë lidhëse mes qenieve njerëzore si qenie sociale. Efektet e saj nuk mbeten vetëm në marrëdhëniet didaktike, nga ku është raportuar se efektet e saj mund të jenë më të gjëra në jetën e një individi. Megjithatë ende nuk ka ndonjë argument se inteligjenca emocionale është një aftësi individuale, një aftësi jo konjitive (njohëse) dhe nëse është kompetence (Akerjordet & Severinsson, 2007). Janë paraqitur katër premisat e inteligjencës emocionale janë: se pari, koncepti në vetvete sjell emocionet në diskutim të sjelljeve instrumentale. Se dyti, ideja e inteligjencës emocionale kthen diskutimin e inteligjencës, duke shikuar se si njerëzit marrin rezultate në një problem aktual. Se treti, konstrukti njeh emocionet si një tip i informacionit që mund të përdoret në mënyrë inteligjente dhe e katërta, hapa si një konjektur që të rris inteligjencën emocionale (Wexler, 2000).

Konceptualizimi i ndryshëm i inteligjencës emocionale dhe premisat e ndryshme të ndërlidhura me funksionimin e saj, kanë bërë që të shikojnë rolin e saj në funksionimin si në mirëqenien psikologjike, funksionimin ditore dhe performcën në punë. Nga është treguar se

inteligjenca emocionale kishte një efekt substancial në përfomancën në punë. Shahhosseini, Silong, Ismaill dhe Uli (2012), kanë treguar përmes rezultatetve të tyre se inteligjenca emocionale ka rolin çelës në rritjen e performancës në punë. Sipas tyre hulumtime të ndryshme kanë treguar se individët që posedojnë një nivel të lartë të inteligjencës emocionale, gjithashtu kanë një performanë të jashtëzakonshme në punë. Ndërlidhje rëndësishme mes inteligjencës emocionale dhe performancës në punë ka raportuar edhe (Shamsuddin & Rahman, 2014) Raportimet e ndryshme mbi rolin e inteligjencës emocionale në performancën në punë treguan një ndërlidhje mes inteligjencës emocionale dhe indikatorëve të ndryshëm në performancën në punë si: pozita në kompani, rritja përqindjes së meritave dhe vlerësimi i lehtësirave ndërpersonale, ndjenjat dhe qëndrimet (Lopes, Grewal, Kadis, Gall & Salovey, 2006). Efektet e inteligjencës emocionale në rritjen e performancës mund të ndodhin për arsye të ndryshme, nga është raportuar se niveli i lartë i saj kishte korrelacion negative me stresin në punë (Nikolaou & Tsaousis, 2002). Por ajo nuk është e lidhur vetëm me performancën individuale në punë, por ka dhe një impakt të jashtëzakonshme në performancën e ekipit.

Niveli i lartë i inteligjencës emocionale (IE), kishte ndërlidhje me efektivitetin e lartë të lidershit dhe shpjegonte variancën (ndryshueshmërinë që nuk shpjegohej as nga personaliteti dhe IQ (Rosete & Ciarrochi, 2005). Rol pozitiv i inteligjencës emocionale në efektivitetin e lidershit kanë treguar edhe (Kerr, Garvin, Heaton & Boyle, 2006). Por efektet e IE nuk mbetën vetëm në nivelin e performancës, nga ku sipas Kafetsios & Zametakis (2008), ka një korrelacion të fuqishëm ndërmjet Inteligjencës emocionale dhe kënaqësisë në punë. Ndërsa e kundërta është raportuar nga Carmeli (2003), që ka raportuar se nuk kishte korrelacion ndërmjet inteligjencës emocionale dhe kënaqësisë në punë, por kishte një ndërlidhje me qëndrimet pozitive ndaj punës, sjelljet alturistike, përfundimet në punë dhe një efekt të moderuar në konfliktin familje- punë.

Aspektet e ndryshme të funksionimit social dhe intrapersonal janë të asociuar me nivelin e IE, prej nga meshkujt me nivel të ulët të inteligjencës emocionale, posaçërisht me paaftësinë në perceptimin dhe përdorimin e emocioneve që t'i lehtësojnë mendimet, kishte lidhje me përfundimet negative si përdorimi ilegal i drogës dhe i alkoolit, sjelljet deviante dhe marrëdhëniet jo të mira me shokët (Brackett, Mayer & Warner, 2004). Personat që kanë nivel të lart të inteligjencës emocionale raportuan se kanë raporte më pozitive me të tjerët, në perceptimin e mbështetjes së prindërve dhe po ashtu raportojnë më pak ndërveprime negative me shokët e tyre të ngushte (Lopes, Salovey & Straus, 2003). Gjithashtu individët që kanë nivel të lartë të inteligjencës emocionale ishin më të vetëdijshëm në krahasim me bashkëmoshatarët që kishin nivel më të ulët të inteligjencës emocionale në perceptimin e pasojave negative sociale të konsumimit të duhanit dhe ajo kishte ndërlidhje të qarta me mirëqenien dhe përballjen e fokusuar në probleme (Por, Barriball, Fitzpatrick & Roberts, 2011).

Efektet pozitive të inteligjencës emocionale janë të prekshme në jetën mentale dhe mirëqenien individuale. Nivelet e larta të vetëdijshimit emocional kishin lidhje me nivelin e lartë të IE, ndërsa niveli i lartë i inteligjencës emocionale kishte marrëdhënie të dukshme me ndjenjat pozitive të kënaqësisë në jetë dhe nivelin e ulët të afekteve negative (Schutte & Malouff, 2011).

Schutte, Malouff, Simunek, McKenley dhe Hollander (2002), realizuan tri hulumtime për të kuptuar ndërveprimin ndërmjet inteligjencës emocionale, disponimit dhe vetëvlerësimit. Dy hulumtimet e para investiguan ndërlidhjen mes tyre, nga raportuan se niveli i lart i inteligjencës emocionale kishte korrelacion pozitiv me disponimin pozitivë dhe nivelin e lartë të vetëvlerësimit. Hulumtimi i tretë vëzhgoi efektin e inteligjencës emocionale në rregullimin e disponimit dhe vetëvlerësimit, nga rezultoi se niveli i lartë i inteligjencës emocionale tregonte më pak zvogëlim të disponimit pozitiv dhe vetëvlerësimit pas situatave negative.

Inteligjenca emocionale ishte lidhur me identifikimin e shprehjes së emocioneve, me sasinë e mbështetjes sociale, me përjetimin e kënaqësisë për mbështetjen sociale dhe me sjelljet e menaxhimit të gjendjeve emocionale (Ciarrochi, Chan & Bajgar, 2001). Gjithashtu u arrit në përfundimin se ka korrelacion pozitivë ndërmjet inteligjencës emocionale dhe marrëdhënies së kënaqshme martesore, ku analiza e regresionit tregonte se IE predikonte kualitetin e kënaqësisë së marrëdhënies martesore (Eslami, Hasanzadeh & Jamshidi, 2014). Nga ana tjetër, ata që kanë nivel të ulët të inteligjencës emocionale raportuan se kishin më pak mbështetje dhe marrëdhënieve pozitive në martesë dhe më shumë konflikte në marrëdhënie.

Në kërkim të një piktore më të qartë rreth të kuptuarit e inteligjencës emocionale, vazhdohen të bëhen krahasime mes atyre që kanë nivel të ulët dhe atyre që kanë nivel të lart të IE, nga ka dalë se ata që kishin një nivel më të lartë të inteligjencës emocionale përjetonin nivel më të lartë të mirëqenies psikologjike (Carmeli, Yitzhak- Halewey & Weisberg, 2009), në të cilën, komponentët e mirëqenies psikologjike si vetëvlerësimi, kënaqësia ndaj jetesë dhe vetëpranimi kishin lidhje pozitive me inteligjencën emocionale.

Përveç mirëqenies psikologjike, inteligjenca emocionale prek edhe fenomene tjera të jetës së individit, duke e bërë rolin e saj shumë të rëndësishëm dhe duke rritur edhe përdorimin e saj. Hoerger dhe shokët e tij (2012), kanë treguar se inteligjenca emocionale lidhet me predikimin e saktë, dekodimin dhe konsolidimin e reagimit emocional, për më tepër inteligjenca e emocionale lidhet me përmasimin e parashikimit të detyrave afektive. Një aftësi e tillë e ndërlidhjes së inteligjencës emocionale me parashikimin dhe saktësinë e përshkrimit të emocioneve prek dimensionet të ndryshme të emocioneve dhe përdorimin të tyre. Parker, Taylor dhe Bagby (2001), hulumtuan ndërlidhjen mes inteligjencës emocionale dhe Alexthermis, nga provuan që

konstruktet, edhe pse janë të pavarura nga njëra- jetra, mbulojnë njëra- tjetrën dhe janë të lidhura fuqimisht dhe negativisht.

Si rezultat i përdorimit të gjerë të saj janë shfaqur metoda dhe mënyra të ndryshme për të kuptuar rolin dhe funksionin e saj, duke na ofruar shpjegime alternative se si duhet ta shohim dhe ta matim atë dhe, pavarësisht nga orientim teorik, kanë ofruar shpjegime të ndryshme, ku sipas Mayer et al (2008), paraqitjet teorike duhet të ndahen në dy kategori: orientime të aftësive specifike që ekzaminojnë aftësi mentale relativisht diskrete (të përmbajtur) dhe që sjellin informacione emocionale dhe paraqitje teorike me model integrativ (të ripërtërirë,) që paraqesin një mënyrë pune të aftësive mentale, duke kombinuar aftësitë prej zonave të ndryshme të inteligjencës emocionale.

2.5. Modelet e inteligjencës emocionale

Qysh në hapat e parë të paraqitjes së inteligjencës emocionale janë gjetur mënyra të ndryshme për të kuptuar rolin dhe funksionin e saj. Si rezultat i kuptimeve të ndryshme që u janë dhënë atyre nga hulumtues të ndryshëm, kemi edhe modele të ndryshme që përpiqen të shpjegojnë, të ndajnë dhe të matin atë.

Ndër modelet më të rëndësishme të inteligjencës emocionale janë: The EI Ability- Based Model (Mayer & Salovey, 1997), që është modeli i parë, i cili e paraqet inteligjencën emocionale si aftësi për t'u dhënë arsye emocioneve. Formulimi që i bënë këtij modeli përfshin aftësinë që, në mënyrë të qartë, të perceptojë, të vlerësojë dhe të shprehë emocionet; aftësinë për të gjeneruar ndjenja që lehtësojnë formimin e mendimeve; aftësinë për të kuptuar dhe njohur emocionet si dhe për të rregulluar emocione që promovojnë rregullimin dhe rritjen emocionale. Një model

tjetër është ai i BarOnit, Emotional- Social Intelligence model (BarOn, 2000), që paraqet një inteligjencë emocionale, e cila konsiston në përzierjen e aftësive sociale, emocionale, të kompetencave personale dhe në aspektet e personalitetit. Ndërsa modeli i Golemanit fokusohet te kompetencat në vendin e punës (Goleman, 2001). Ai përmend edhe aftësitë njohëse dhe aspektet e personalitetit, por fokusohet më tepër te roli i këtyre faktorëve në vendin e punës.

Modeli i fundit, i cili po zhvillohet, duke marrë një hov të konsiderueshëm, mbështetet në tiparet e inteligjencës emocionale që përfshijnë disa kualitete të personalitetit, (Petrides, 2011).

2.5.1. Modeli i bazuar në aftësitë e inteligjencës emocionale

Ndër modelet e para konstruktive që përpiqet ta shpjegoj inteligjencën është ai i Mayer and Salovey, të cilët formën apo konstruktin e parë e paraqitën në vitin 1990, ku inteligjencën emocionale e përkufizuan si aftësinë për të drejtuar të menduarin dhe të vepruarin përmes monitorimit të emocioneve personale dhe të të tjerëve, si dhe dallimeve në mes (Mayer & Salovey, 1997).

Modeli i tyre qëndron në shpjegimin që inteligjenca emocionale si një aftësi për t'u angazhuar në një procesim (avancim) të sofistikuar të emocioneve personale dhe të tjerëve si dhe në aftësitë për ta përdorur atë informacion me qëllim udhëheqjen e të menduarit dhe të sjelljes. Sipas tyre, një person me inteligjencë të lartë emocionale e përqendron vëmendjen në përdorimin, në të kuptuarin dhe në menaxhimin e emocioneve. Në këtë mënyrë individi me inteligjencë të lartë është në gjendje të përdorë aftësi të ndryshme të arsyeshme, të cilat i sjellin atij përfitime për veten por dhe nga të tjerët.

Modeli i tyre fillestar përbëhet nga tri komponentë: vlerësimi dhe shprehja e emocioneve, rregullimi dhe përdorimi i tyre (Mayer & Salovey, 1997). Komponenti i vlerësimit dhe shprehjes së emocioneve, përfshin vlerësimin e emocioneve vetjake dhe të tjerëve, ku emocionet vetjake janë verbale dhe jo-verbale, ndërsa në emocionet e të tjerëve përfshihen perceptimi jo-verbal dhe empatin (shprehës).

Rregullimi emocional si komponent i dytë përfshin vetërregullimin dhe rregullimin emocional të të tjerëve. Ndërkohë ky komponent përfshin brenda tij edhe mënyrën se si individët i përdorin emocionet e tyre, nga dhe ndërtohet vetë planifikimi fleksibil (i lakueshëm), të menduarit kreativ, ri-drejtimi i vëmendjes si dhe motivimi.

Sipas Mayer dhe Salovey (1997), kjo ndarje e rregullimit emocional është e rëndësishme ngaqë nxjerr në pah dallimet individuale të cilat klinikistët si: psikologë, psikiatër, terapisë etj, duhet t'i njohin me qëllim që të kuptojnë llojshmërinë e madhe të shprehjes së emocioneve. Rëndësi të veçantë përbën dhe fakti se këto ndarje lidhen edhe me formësimin e qasjes ndaj klientit Kështu, dinamikat emocionale dhe të gjitha intervenimet e hershme apo edhe ato terapeutike duhet të formësohen nga individualiteti emocional i klientëve.

Po këta autorë e zhvilluan dhe e eksploruan më tej modelin e tre komponentëve, duke bërë një varg hulumtimesh me synimin që të afronin një model me gjithëpërfshirës të inteligjencës emocionale. Ata e ndryshuan modelin e tyre në një formë tjetër, duke e ndarë në katër shkallë: rregullimi reflektiv (pasqyrues) i emocioneve, të kuptuarit e emocioneve, asimilimi i emocioneve në mendime dhe perceptimi dhe shprehja e emocioneve (Mayer & Salovey, 1997).

Me kalimin e kohës ata krijuan modelin tjetër, i cili është më i pranuar dhe më i argumentuar se modeli paraprak, pasi konsiston në katër shkallët e inteligjencës emocionale të

organizuar në hierarki, ku niveli më i ulët ose bazik është ai i perceptimit të emocioneve dhe niveli më i lartë dhe më kompleks është menaxhimi i emocioneve. Prandaj, aftësia që të rregullojmë emocionet tona dhe të tjerëve është ndërtuar në bazë të tri niveleve të tjera (Fernandez- Berrocal & Extremera, 2006).

Në nivelin e parë individi mëson të identifikoj emocionet e tij dhe të tjerëve, si dhe të diskriminojë (dallojë) shprehjen e emocioneve të ndryshme. Në fazën e dytë individi përdor emocionet me qëllim që të vendosë për marrjen e vendimeve. Faza e tretë karakterizohet me aftësinë që të sistemojë njohuritë emocionale. Kapaciteti (aftësia) për të njohur marrëdhënien ndërmjet emocioneve dhe tranzicionin (kalimin) nga një emocion te tjetri i atribuohen kësaj faze. Ndërsa faza e katërt karakterizohet nga aftësia për menaxhimin e emocioneve nga sjellja, e shoqëruar me informacionet që përmbajnë emocionet (Finegan, 1998).

Katër aftësitë emocionale të modelit të inteligjencës emocionale janë të vendosur në një mënyrë të tillë, që proceset psikologjike bazike (perceptimi i emocioneve) përbëjnë bazamentin dhe proceset më të avancuara (si rregullimi reflektiv (pasqyrues) i emocioneve) janë në majë të këtij modeli si mendime që në disa forma varen prej nivelit më të ulët të emocioneve (Brackett, Rivers, Shiffman, Lerner & Salovey, 2006).

Modeli prej katër shkallësh është model integrativ (i ripërtërirë) i inteligjencës emocionale dhe përbën një grumbullim të aftësive nga katër zona: a) perceptimi i saktë i emocioneve, b) përdorimi i emocioneve që të lehtësojë mendimet, c) të kuptuarit e emocioneve dhe d) menaxhimi i emocioneve (Mayer et al., 2003). Secila nga këto zona është parë dhe vëzhguar në vijimësi që prej fëmijërisë (Mayer et al., 2008).

Me qëllim që të kuptohen proceset e ndryshme të zhvilluara gjatë procesimit (avancimit) të informacioneve të ndryshme, që kanë të bëjnë me aktivitete të ndryshme mentale e të lidhura me inteligjencën emocionale, ata krijuan hierarkinë e zonave të inteligjencës emocionale. Duhet pohuar se këto zona apo arena të inteligjencës emocionale janë e lidhura me njëra-tjetrën.

Niveli i parë, ose më i ulëti, konsiston në aftësinë e perceptimit dhe të vlerësimit të emocioneve; si shprehjet e fytyrës, kualiteti i zërit (Mayer, Caruso & Salovey, 2000). Ato na japin informacione për çka ndodh me individin dhe gjendjen emocionale të tij, pra, mund të na tregojnë nëse individ i është i lumtur, i pikëlluar, apo për emocione të tjera që përjetohej nga qeniet njerëzore.

Niveli i dytë përfshin përdorimin e emocioneve për lehtësimin e të menduarit. Gjatë kësaj faze ndodh asimilimi i emocioneve bazike të përjetuara brenda jetës mentale, që përfshin peshimin e një emocioni kundër një tjetri dhe kundër impulseve të tjera e mendimeve, si dhe lejimin e emocioneve gjatë një vëmendjeje të drejtpërdrejtë.

Një shembull i tillë përfshin mbajtjen e gjendjes emocionale në vëmendje për aq kohë sa të krahasojë korrespondencën e sensacioneve të ngjashme në ngjyra, në tinguj dhe në shije. Edhe pse kjo ka të bëjë me të qenurit (qenit) i vetëdijshëm rreth emocioneve tona, shkon më tej në përdorimin e këtyre emocioneve për informimin e të menduarit.

Niveli i tretë përfshin të kuptuarit dhe rezonimin (jehonën) rreth emocioneve, ku secili emocion lëviz në pajtim me rregullat e atij emocioni. Në këtë mënyrë inteligjenca emocionale përfshin aftësinë që të shohë pjesët përbërëse të emocioneve, ndërthurjen dhe të kuptuarit e tyre në përputhje me aftësitë njohëse që ka individ. Individët të cilët kanë inteligjencë të lartë emocionale janë në gjendje të bëjnë përputhjen e të menduarit me emocionet dhe të mos i kenë të

disbalancë (të paekuilibruar) këto dy funksione. Përveç kësaj në këtë nivel duhet që individi të kuptojë emocionet, të vlerësojë dhe të kuptojë përfundimet e tyre (Mayer et al., 2004). Sipas Mayer-it dhe të tjerëve, niveli i kuptimit të emocioneve zhvillohet dhe bëhet më i përsosur me kalimin e kohës.

Niveli i katërt përfshin menaxhimin dhe rregullimin e emocioneve, mënyrën se si individët janë në gjendje të qetësojnë veten, të mos lejojnë përcjelljen e ankthit të tyre te të tjerët apo edhe e kundërta.

2.5.2. Modeli i inteligjencës emocionale sipas BarOn.

Qëndrimet e hershme të Darëinit mbi rolin e shprehjes së emocioneve kanë influencuar punën dhe zhvillimin e BarOn Model (BarOn, 2006). Ata theksuan së bashku rëndësinë e të shprehurit të emocioneve e të vëmendjes së përfundimeve të inteligjencës sociale dhe emocionale në termat e Darëinit në rastin e një adaptim (përshtatjeje) efektive.

BarOn ishte i interesuar për identifikimin e tipareve dhe të aftësive që ndihmojnë njerëzit të adaptohen në inteligjencën sociale dhe emocionale të jetës (Cherinss, 2010).

Nga koha e Darëin-it e deri në ditët e tashme shumica e përkufizimeve dhe konceptualizimeve të inteligjencës emocionale- sociale kanë përfshirë këta komponentë: aftësinë që individi të njohë, të kuptojë dhe të shprehë emocionet dhe ndjenjat, aftësinë që të kuptojë se si ndihen të tjerët dhe lidhjet me ta, aftësinë që të menaxhojë dhe të kontrollojë emocionet, aftësinë që të menaxhojë ndryshimet, të adaptohet (përshtatet) dhe të zgjidhë probleme të natyrës personale dhe interpersonale, si dhe aftësinë që të gjenerojë ndjenja pozitive dhe të jetë vetë motivues. (Bar- n, 2006). BarOn Model përkufizon konstruktin e inteligjencës emocionale- sociale, i cili është

formuar nga një ndërlidhje kros- seksionale ndërmjet emocioneve dhe tipareve të personalitetit. Pikërisht, inteligjenca emocionale- sociale korrespondon me pesë faktorë të nivelit të lartë të cilët janë të ndarë në 15 nënfaktorë (Fernandez- Berrocal & Extremera, 2006).

Hulumtimet e tij sugjerojnë këto kualitete personale, përfshirë aftësinë që të jetë i vëmendshëm, të kuptojë dhe të shprehë veten; aftësinë që të jetë i vetëdijshëm, të kuptojë dhe të lidhet me të tjerët; aftësinë të adaptohet, të ndryshojë dhe të zgjidhë probleme të natyrës personale dhe sociale (Cherniss, 2010).

Pesë faktorë e nivelit të lartë të këtij modeli janë:

a) Faktorët intrapersonalë që përfshijnë aftësinë për të qenë i vetëdijshëm dhe për të kuptuar emocionet, ndjenjat dhe idetë në vetvete, dhe e cila është e ndarë në pesë nën ndarje: vetë respekti, vetë ndërgjegjësimit emocional, këmbëngulësia, pavarësia dhe vet aktualizimi.

b) Faktorët interpersonalë që i referohen aftësisë së të qenit i vetëdijshëm dhe të kuptuarit të emocioneve, të ndjenjave dhe të ideve të të tjerëve. Tre nënkategoritë e ndarjes së këtyre faktorëve janë: Empatia (emocionaliteti), përgjegjësia sociale dhe marrëdhëniet interpersonale.

c) Menaxhimi i stresit, i cili referohet aftësisë të gjendjes në stres dhe kontrollimit të emocioneve. Dy nënfaktorët përbërës janë: toleranca dhe kontrollimi i impulseve.

d) Adaptibiliteti që i referohet aftësisë i të qenit i hapur për ndryshim pavarësisht nga situata. Nënfaktorët përbërës janë: testimi i realitetit, fleksibiliteti dhe zgjidhja e problemeve.

e) Disponimi apo humori gjeneral, që përbën shkallën e fundit, i referohet aftësisë për të ndjerë shprehjen e emocioneve pozitive dhe të qenit optimist, që është i ndarë në dy nënshkallë:

optimizmi dhe lumturia (Fernandez- Berrocal & Extremera, 2006; BarOn, 2006; BarOn, Tranel, Denburg & Bechara, 2004).

BarOn model është një ndër modelet më të studiuar të inteligjencës emocionale dhe ka një përdorim të konsiderueshëm në fushën e studimit të inteligjencës. BarOn (2006), modelin miks të inteligjencës emocionale e ka ndarë në pesë kategori të cilat u parashtruan më lart.

Secila nga ndarjet ka veçoritë e veta dhe prek fusha të ndryshme të jetës, që mundësojnë një sukses në jetë. Kategoria e parë është ajo intrapersonale, me nëndarjet: vetë respekti, vetë ndërgjegjësimi emocional, këmbëngulësia, pavarësia dhe vet aktualizimi.

Vetë ndërgjegjësimi emocional- është aftësia që individi të njohë emocionet e veta. Kjo nënkupton jo vetëm ndërgjegjshmërinë për të qenë i vetëdijshëm rreth emocioneve dhe ndjenjave të veta, por aftësinë për të bërë dallimin mes tyre. Pra, të përcaktojë se ç'është një ndjenjë dhe të dijë se kush e shkakton atë.

Këmbëngulësia- është aftësia e individit të shprehë ndjenjat, besimet dhe mendimet dhe të mbrojë të drejtat e tij në mënyrë konstruktive. Këmbëngulësia përbëhet nga tri komponentë: 1) aftësia për të shprehur ndjenjat (të shprehësh dhe të frenosh nervozizmin, ngrohtësinë dhe ndjenjat seksuale); 2) aftësia për të shprehur besimet dhe mendimet hapur, të jesh i aftë të shprehësh emocionet dhe të marrësh qëndrime definitive dhe pse kjo mund të jetë e vështirë ta bësh emocionalisht dhe 3) aftësia të luftosh për të drejtat personale dhe të mos lejosh të tjerët të shqetësojnë dhe të marrin përparësi.

Vetë respekti - është aftësia për të respektuar dhe për të pranuar veten si të mirë. Është esenciale të pranosh veten ashtu si je, pra, të njohësh aspektet negative dhe pozitive të vetes, si dhe limitet dhe mundësitë e vetes.

Vet- aktualizimi- është aftësia për të kuptuar potencialet apo kapacitetet e vetes. Ky komponent i inteligjencës emocionale është manifestuar duke qenë i involvuar (i përfshirë) në ndjekjen e asaj që drejton për një jetë të kuptimshme, të pasur dhe të plotë. Vet- aktualizimi është një proces dinamik i përpjekjeve drejt zhvillimit maksimal të aftësive, të kapaciteteve dhe të talenteve të vetes.

Ky faktor është i lidhur me përpjekjet konsistente (të qëndrueshme) për të qenë më i miri dhe për tu bërë më i miri.

Pavarësia- është aftësia për drejtuar dhe për të kontrolluar veten ndaj një mendimi dhe veprimi dhe për tu çliruar nga varësia emocionale. Pavarësia është një aftësi esenciale për funksionimin e autonomisë personale ndaj nevojës për mbrojtje dhe mbështetje.

Komponentja e dytë është ajo interpersonale, me këto nën ndarje: Empatia, përgjegjësia sociale dhe marrëdhëniet interpersonale.

Empatia- paraqet aftësinë për të qenë i vetëdijshëm, për të kuptuar dhe për të vlerësuar ndjenjat e të tjerëve. Pra, kjo nënkupton që të jesh i ndjeshëm se si njerëzit ndihen dhe të kuptosh mënyrën se si ata i bëjnë gjërat. Të jesh empatik do të thotë të jesh në gjendje të lexosh emocionalisht njerëzit.

Marrëdhëniet interpersonale – përfshijnë aftësinë për të vlerësuar dhe për të pasur marrëdhënie të kënaqshme që karakterizohen nga intimiteti, si dhe për të dhënë dhe për të marrë afeksin.

Ky komponent nuk është i lidhur vetëm me krijimin e marrëdhënieve shoqërore të dëshiruara me të tjerët, por edhe me aftësinë që të ndihesh rehatshëm në këto marrëdhënie dhe të kesh pritje

pozitive. Kjo aftësi, në përgjithësi, kërkon ndjeshmëri ndaj të tjerëve dhe të ndihesh i kënaqur me marrëdhëniet.

Përgjegjësia sociale – është aftësia për të demonstruar veten si bashkëpunues, kontribuues dhe një anëtar konstruktiv i një grupi social. Kjo aftësi lidhet me të bërit gjërave me të tjerët dhe për të tjerët, me pranimin e të tjerëve dhe me veprimin sipas bindjeve të tua dhe vlerave sociale.

Komponenti i tretë i këtij modeli është *përshtashmëria*, me tri nën ndarje a) zgjidhja e problemeve, b) testimi i realitetit dhe c) fleksibiliteti.

Zgjidhja e problemeve- është aftësia për të identifikuar dhe përcaktuar problemet, si dhe për të gjeneruar dhe për të implementuar zgjidhje potenciale efektive.

Testimi i realitetit – është aftësia për të vlerësuar korrespondencën ndërmjet asaj që përjeton dhe asaj që ekziston realisht. Testimi i shkallës së korrespondencës ndërmjet asaj që përjetohet dhe asaj që realisht ekziston, kërkon evidenca objektive që konfirmojnë, arsyetojnë dhe mbështesin ndjenjat, perceptimin dhe mendimet.

Fleksibiliteti- është aftësia për të rregulluar emocionet, mendimet dhe sjelljet, duke ndryshuar kushtet dhe situatën. Ky komponent i inteligjencës emocionale i referohet aftësisë për t'u përshtatur në rrethana jo familjare, të papritura dhe dinamike.

Komponenti i katërt është menaxhimi i stresit, që ka dy nën ndarje: Toleranca ndaj stresit dhe kontrolli i impulseve.

Toleranca ndaj Stresit- është aftësia për t'u qëndruar situatave të pafavorshme dhe stresuese dhe në mënyre efektive e pozitive të përballesh me stresin. Toleranca ndaj stresit

përfshin aftësinë për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme situatave stresuese, pa u lëkundur nga emocionet e fuqishme.

Kontrolli i impulseve- është aftësia për t'u rezistuar impulseve ditore që të drejtojnë në një veprim të menjëhershëm. Është esencial kapaciteti i pranimit të impulseve të agresivitetit që kemi, të qenit i qetë, kontrollimi i agresionit, i nervozizmit dhe i sjelljeve të papërgjegjshme. Komponenti i pestë e BarOn Model është deponimi gjeneral, me dy nën ndarje: Lumturia dhe optimizmi.

Lumturia – është aftësia për t'u ndierë i lumtur me jetën, i kënaqur me veten dhe me të tjerët. Ky komponent i inteligjencës emocionale përfshin aftësinë për të shijuar aspekte të ndryshme të jetës dhe jetën në përgjithësi.

Optimizmi – është aftësia për të parë anën e ndritur të jetës dhe për të mbajtur qëndrime pozitive dhe në përballje me çdo fatkeqësi.

2.5.3 Modeli i inteligjencës emocionale sipas Golemanit.

Hapat e parë të inteligjencës emocionale janë prezantur në vitin 1990, ku edhe është botimi i parë në një revistë shkencore, por popullaritetin dhe jehonën e madhe si konstrukt e arriti me botimin e librit të famshëm nga Daniel Goleman “ Emotional Intelligence” që u botua në vitin 1995 dhe që nga ajo kohë kemi një rritje sinjifikante të studimit dhe përdorimit të inteligjencës emocionale.

Në punën e tij konsistente në konstruktimin e teorisë se tij rreth inteligjencës emocionale Goleman (1998, 2001), prezantoi modelin e tij teorik të inteligjencës emocional, që reflekton

potencialin e individit, të përvetësoj aftësitë e vet- vetëdijes, vet- menaxhimit, vetëdijes sociale dhe marrëdhëniet e menaxhmentit të përkthyer në sukses në vëndin e punës.

Goleman (1998), theksoi se inteligjenca emocionale determinon potencialin tonë për mësimin e aftësive praktike bazuar në pesë elementë: vetvetëdija, motivimi, vetërregullimi, empatia dhe adaptimi në marrëdhënie. Secili nga këta elementë ka nëngrupet e veta që bëjnë të mundur të kemi më të qartë pikturën e secilës aftësi të modelit të Goleman dhe mënyrën se si ai e perceptonte dhe e kuptonte inteligjencën emocional.

Te elementi i vetvetëdijes ai përfshin vetëvlerësimin e saktë dhe vetëbesimin; te vetë rregullimi përfshin komponentët si: vetëkontrolli, besueshmëria, ndërgjegjësimi, përshtatshmëria dhe inovacioni.

Ndërsa komponentët e elementit të tretë, motivimit, janë: arritja, angazhimi, iniciativa dhe optimizmi.

Empatia, elementi i katërt, përfshin të kuptuarit e të tjerëve, zhvillimin e të tjerëve, orientuar drejt shërbimit dhe vetëdijës politike.

Kategoria e pestë, është aftësia sociale me këto nën ndarje: influencimi, komunikimi, menaxhimi i konflikteve, lidhshipi, ndërtimi i lidhjeve, bashkëpunimi e kooperimi dhe aftësitë ekipore (Mayer, 2001). Secila nga pesë kategoritë, që konceptualizoi Goleman-i, kanë funksione të ndryshme, të cilat vërehen në situata specifike.

Njohja e emocioneve vete - njerëzit me shumë siguri në gjendjen emocionale dhe ndjenjat e tyre janë pilot me të mire të jetës së tyre. Ata marrin vendimet me të mira dhe vendosin pritje me real për jetën e tyre.

Menaxhimi i emocioneve- njerëzit me këtë kompetencë ia dalin me emocionet e fuqishme ose shqetësuese dhe mund ta qetësojnë veten e tyre në kohën e duhur. Ata mund ta shkundin ose largojnë ankthin e fuqishëm dhe nervozizmin. Ata e ekspozojnë një formë të qëndrueshmërisë ndaj stresit.

Motivimi i vetvetes- individët me kapacitetin për vet- efikasitet, jo vetëm që manifestojnë vet- kontroll të emocioneve, por ata përdorin këtë në përfundimin e qëllimeve specifike të vendosura me herët. Kjo ndrydh të gjitha impulset që janë të ndërlidhura me përfundimin e të gjitha detyrave.

Njohja emocioneve tek të tjerët- njerëzit me këtë aftësi dallojnë emocionet tek të tjerët, bazuar në situatën dhe shenjat e shprehjes, sjellin informacione që mund të përdoren e të krijojnë përfundimet e dëshiruara.

Empatia vjen me kapacitetin jo vetëm të njohim, por edhe të shpërndajmë emocionet e përjetuara nga të tjerët.

Mbajtja e marrëdhënieve- individët me këtë aftësi mund të marrin gjërat që kanë bërë me të tjerët. Gjatë gjithë kohës konsiston me aftësinë të mbaj marrëdhëniet dhe të krijoj mundësitë e lidershit për individët me këtë kompetencë.

2.5.4. Modeli i tipareve të inteligjencës emocionale

Ky model konsiderohet si gjenerata e dytë e modeleve të inteligjencës emocionale (Cherniss, 2010) dhe konsiston në të treguarit e një vëmendjeje më të madhe dhe në përfshirjen e disa cilësive të personalitetit.

Gjithashtu ky model i referohet mbledhjes së vetë perceptimit të emocioneve me një pozicion në nivelin më të ulët të hierarkisë së personalitetit (Petrides, 2001). Sipas Petrides, motivimi teorik në krijimin e këtij modeli është që të zhvillojë një operacionalizim të kuptueshëm, aspekte këto të lidhura me emocionet në personalitet gjatë jetës.

Teoria e tipareve të inteligjencës emocionale na tregon se si dallimet individuale mund të ndryshojnë mendimet dhe të transformojnë idetë, spekulimet dhe opinionet brenda një konstrukti psikologjik, i cili mund të inkorporohet (përfshihet) brenda një taxonomie (vlerësimi) (Petrides dhe Furnham, 2001). Modeli konsiston në katër komponentë:

Mirëqenia- është komponenti i parë, që përfshin tri nën ndarje: vetëbesimi, lumturia dhe optimizmi. Ky komponent reflekton një sens të përgjithshëm të mirëqenies, që rrjedh nga arritjet në të kaluarën drejt pritjeve në të ardhmen.

Individët që kanë pikë të larta ndihen pozitivë, të lumtur dhe të plotësuar, ndërsa ata me pikë të ulëta provojnë ndjenja keqardhjeje ndaj vetes dhe ndihen të dëshpëruar ndaj jetesës së tashme (Petrides, 2001).

Të qenit i shoqërueshëm, komponenti i dytë, përmban nën ndarjet: kompetencat sociale, këmbëngulësia dhe menaxhimi i emocioneve të tjerëve. Ky faktor ndryshon nga komponentët e tjerë, veçanërisht nga komponenti i emocionalitetit sepse në këtë faktor theksohen lidhjet sociale dhe influenca sociale (Petrides, 2011).

Sipas Petrides, ata që kanë pikë të larta janë më të mirë në interaksionet (ndërveprimet) sociale, besojnë se kanë aftësi të mira dëgjimi dhe komunikojnë qartë dhe me vetëbesim me njerëzit me background të ndryshëm. Ndërsa ata që kanë pikë të vogla janë të paafte të ndikojnë tek

emocionet e të tjerëve dhe me pak gjasa për të qenë negociatorë të mirë dhe të kenë një rreth social të mirë.

Te komponenti i tretë, *vetëkontrolli*, përfshihen menaxhimi i stresit, rregullimi i emocioneve dhe impulsiviteti i ulët. Individët me pikë të larta dallohen për shkallë të lartë të kontrollit ndaj urgjencave dhe dëshirave të tyre. Ata janë në gjendje të rregullojnë shtypjet e jashtme dhe stresin, nuk janë shumë ekspresive ndaj emocioneve të tyre, në kontrast me ata me pikë të ulëta që janë pronë e sjelljeve impulsive dhe të paafte për menaxhimin e stresit.

Emocionaliteti- komponenti i katërt, përfshin perceptimin e emocioneve të veta dhe të të tjerëve, shprehjen e emocioneve dhe empatinë (Petrides et al., 2004). Individët me pikë të larta në këtë faktor besojnë se kanë një rang të gjerë të aftësive të lidhura me emocionet. Ata mund perceptojnë dhe shprehin emocionet dhe t'i përdorin këto aftësi për të zhvilluar dhe për mbajtur lidhje të kënaqshme që janë të rëndësishme për të tjerët. Ndërsa individët me pikë të ulëta në këtë faktor e kanë të vështirë të njohin gjendjen e brendshme emocionale të tyre dhe t'ua shprehin të tjerëve emocionet që ndiejnë.

Davies et al. (1998) ka zbuluar një numër të problemeve të këtyre matjeve. Së pari, disa prej tyre kanë një besueshmëri të ulët. Se dyti, matjet raportuese më të besueshme janë të lidhura me faktorët e personaliteti.

2.6. Inteligjenca emocionale, tipar apo aftësi ?

Inteligjenca emocionale është një nga konstruktet më të studiuara dhe më të debatuar në fushën e psikologjisë, e cila prek fusha të ndryshme të jetës. Përpjekjet e vazhdueshme për të patur një kuptim më të qartë rreth inteligjencës emocionale kanë ofruar modele dhe shpjegime të

ndryshme teorike rreth saj. Njëkohësisht matjet e ndryshme kanë krijuar konstrukte të ndryshme rreth saj dhe, për rrjedhojë, kemi konceptualizime dhe përkufizime të ndryshme.

Disa hulumtues të inteligjencës emocionale e shohin atë si aftësi dhe disa të tjerë e kuptojnë dhe e matin atë si tipar, gjë që ka ngjallur një debat të gjerë rreth kësaj problematike. Tiparet e inteligjencës emocionale janë vetefikasiteti emocional, ndërsa aftësitë e saj janë aftësi kognitive (njohëse)– emocionale. Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë se këto forma të të kuptuarit të inteligjencës janë të ndryshme, dhe se shumë e rëndësishme është dallimi mes tyre në organizimin e literaturës se inteligjencës emocionale (Petrides & Furnham, 2001).

Tiparet e inteligjencës emocionale janë matur me instrumente vetëraportuese, ndërsa aftësitë e saj janë matur përgjatë testeve të performancës maksimale (Petrides & Furnham, 2000).

Dallimet ndërmjet tipareve dhe aftësive të inteligjencës emocionale konsistojnë në metodat që përdoren për t'i matur ato dhe jo në elementët që ndërtojnë tiparet dhe aftësitë e saj. Gjithashtu secili nga këto modele ka përvetësuar paraqitje te ndryshme teorike edhe njëkohësisht janë përdorur matje të ndryshme që mund ta shpjegojnë edhe dallimet e mëdha që ekzistojnë ndërmjet tyre (Petrides & Furnham, 2000).

Tiparet e inteligjencës emocionale janë të lidhura me tendencat e sjelljes dhe aftësitë e vetëperceptimit. Fillimisht, ky vëzhgim duhet të realizohet brenda punës së personalitetit, në kontrast me aftësitë e inteligjencës emocionale që, së pari, duhet të studiohen, duke respektuar matjet psikometrike të inteligjencës (Petrides & Furnham, 2001). Ka modele të ndryshme të cilat e shikojnë inteligjencën emocionale si tipar dhe modele të tjera si aftësi.

Hulumtues të ndryshëm kanë treguar për dallimet ndërmjet këtyre dy mënyrave të matjes së inteligjencës emocionale. Sipas Petrides dhe Furnham (2001), një pikë e dallimit ndërmjet tyre

është se tiparet e inteligjencës emocionale në vetvete kanë një lidhje të fuqishme me dimensionet themelore të personalitetit dhe se nuk janë aftësi konjitive (njohëse), ndërsa aftësitë e inteligjencës emocionale janë lloji i dytë i saj dhe i përkasin fushës konjitive (njohëse). Megjithatë, nevojiten studime më të detajuara për të parë dallimet mes këtyre dy mënyrave se si trajtohet dhe matet inteligjenca emocionale.

2.7. Matjet e inteligjencës emocionale dhe kritikrat ndaj tyre

Inteligjenca emocionale, e cila si term përcillet si aftësia për të njohur e për të kuptuar, është përdorimi dhe menaxhimi i emocioneve tona, po ashtu edhe i emocionet e të tjerëve.

Në vargun e alternativave të ndryshme rreth konceptualizimit të inteligjencës emocionale janë paraqitur edhe forma të ndryshme të matjes, duke krijuar për të metoda pavarësisht nga mënyra se si e kuptojmë. Ndër mënyrat më të popullarizuara të matjes së inteligjencës emocionale janë: modeli katër shkallësh i Mayer-Salovey-Caruso,- Testi i Inteligjencës Emocionale (MSCEIT), Vetë raporti i Tipareve të Inteligjencës Emocionale (TEIQ- ue), i Modelit të Tipareve të Inteligjencës Emocionale, Inventari Bar-On i Koeficientit të Emocioneve, i modelit miks të inteligjencës emocionale, dhe Modeli Miks i Inteligjencës Emocionale të Goleman-it, ku përdoren matje të ndryshme rreth këtij modeli si: Inventari i Inteligjencës Emocionale (ECI) , Vlerësimi i Inteligjencës Emocionale (EIA), Pyetëtori i Profilit të Punës dhe Versioni i Inteligjencës Emocionale (PQei).

Mayer-Salovey-Caruso Emotional Intelligence Test (MSCEIT)- Është analizë e kësaj matjeje që synon pranimin e aftësive të inteligjencës emocionale, duke shikuar katër shkallët apo aftësitë të inteligjencës emocionale, ku aftësia e shkallëve 1, 3, dhe 4 përfshijnë perceptimin, kuptimin dhe menaxhimin e emocioneve dhe të menduarit rreth emocioneve. Ndërsa aftësia e shkallës 2

përfshin përdorimin e emocioneve në lehtësimin e mendimeve dhe ka të bëjë me përdorimin e emocioneve në ngritjen e mendimeve (Brackett & Salovey, 2006). Kjo matje përdoret në matjen e katër shkallëve të inteligjencës emocionale.

Sipas Mayer, Salovey, Garuso dhe Sitarenios (2003), MSCEIT arrin kriteret klasike të inteligjencës standarde dhe predikon përfundime të rëndësishme sociale. MSCEIT ka disa nënteste të ndryshme, të cilat përdoren për matjen e inteligjencës emocionale dhe secila nga këto nënteste dallon nga shkalla e modelit që kemi qëllim të matim.

Në shkallën e parë, perceptimi i emocioneve, aftësia për të perceptuar emocionet në veten dhe të tjerët, si dhe objekte, artin, tregimet, muzikën dhe stimuj të tjerë. Ky nëntest matet duke pyetur personat për të identifikuar emocionet e shprehura nga fytyrat e njerëzve në fotografi, po ashtu edhe nga ndjenjat e sugjeruara nga artisti që të dizenojë dhe pikturojë foton.

Në shkallën e dytë, lehtësimin e mendimeve, që është aftësia për të gjeneruar, përdorur dhe ndier emocionet e nevojshme për të komunikuar ndjenjat ose për t'i përdorur ato në procese të tjera njohëse. Për këtë shkallë përdoren dy teste duke matur aftësinë e njerëzve që përshkruajnë sensacionet emocionale dhe paralelet e tyre me modalitetet e tjera shqisore dhe identifikimin e ndjenjave që mund të lehtësojë ose ndërhyjnë me performancat e suksesshme në detyrat e ndryshme konjitive (njohëse) dhe sjelljeje.

Shkalla e tretë, të kuptuarit e emocioneve, është e matur nga dy teste. Ajo përbën aftësinë e individit për të analizuar emocionet komplekse dhe për të kuptuar se si reaksionet emocionale ndryshojnë gjatë kohës, se si ata përcjellin nga një ndryshim në tjetrin dhe shkalla apo aftësia e pestë e inteligjencës emocionale, që është të kuptuarit e emocioneve dhe ka dy nënteste, që

vlerësojnë se si pjesëmarrësit i menaxhojnë emocionet e të tjerëve (menaxhimi social), dhe se si personi rregullon emocionet e tij ose të saj (menaxhimi i emocional)

Në raport me vlefshmërinë dhe besueshmërinë janë realizuar hulumtime të ndryshme me qëllim që të vërtetohen këto karakteristika të rëndësishme të një matjeje shkencore. Që të vërtetohet zbatueshmëria dhe besueshmëria e Mayer-Salovey-Caruso Emotional Intelligence Test, janë bërë studime kros- kulturor si në Francë, Pakistan, Itali ku rezultatet ishin të dallueshme prej rezultateve të fituara nga modeli BIG-5 faktorë i personalitetit, matjeve vetë raportuese të inteligjencës emocionale, dhe inteligjencës konjitive.

Në raport me vlefshmërinë e saj, Mayer, Salovey dhe Caruso (2012), raportuan se artikujt e fundit shkencor kanë provuar evidenca për vlefshmërinë e MSCEIT, krahasuar me teste të tjera që janë përdorur për këtë qëllim.

Nëntesti i parë i parë i MSCEIT, që është perceptimi i emocioneve, ka treguar se vlefshmëria dhe koeficienti i alpha ishin të moderuar (Louis & Barchard, 2005). Por hulumtimet treguan se MSCEIT ka arritur një besueshmëri dhe se analiza faktoriale konfirmuese ka mbështetur modelin teorik të inteligjencës emocionale. Kjo matje është më e besueshme kur përdoret tek adoleshentët, me një efekt më të madh te femrat se sa te meshkujt.

Në hulumtimin e realizuar për të parë vlefshmërinë e MSCEIT, Rossen dhe Kranzel (2009), raportuan se inteligjenca emocionale shpjegonte në mënyrë sinjifikante përdorimin e alkoolit dhe kishte një korrelacion pozitiv me arritjet akademike, mirëqenien psikologjike, lidhjen me bashkëmoshatarët dhe marrëdhëniet pozitive me të tjerët, pas kontrollimit të aftësive konjitive (njohëse) dhe të personalitetit. Këto tregojnë se kemi rezultate të përziera rreth përdorimit të kësaj matjeje, në raport me instrumente e tjera matëse të konstrukteve të ndryshme.

Megjithatë MSCEIT ka treguar të këtë një zbatueshmëri të gjerë edhe kur shikohet ndërveprimi me faktorët e tjerë si personaliteti dhe inteligjenca konjitive (njohëse). Edhe pse disa studime nuk është gjetur korrelacion ndërmjet performancës akademike dhe inteligjencës emocionale, është i njohur fakti se niveli i lartë i inteligjencës emocionale ka ndërlidhje me kënaqësinë ndaj jetës, perceptim më të mirë të aftësive të zgjidhjes së problemeve dhe të përballjes edhe me nivelin e vogël të ankthit.

Sipas disa studimeve është raportuar një korrelacion pozitiv në mes MSCEIT, matjeve vetë raportuese të inteligjencës emocionale dhe të detyrave emocionale dhe sociale. Gjithashtu hulumtuesit treguan se kjo matje ka disa cilësi të një inteligjence dhe është e lidhur më shumë me aftësitë e kristalizuara, se sa me aftësitë fluide.

Në përgjithësi MSCEIT është treguar një korrelacion pozitive me performancën në punë, në mbajtjen e një disponimi pozitiv dhe një botëkuptimi me të mirë në jetë (Extremera et al., 2011).

Bar-On Emotional Quotient Inventory- është pjesë shumë e rëndësishme në zhvillimin dhe konstituimin (vijimin) e këtij modeli, duke ofruar një formë dhe mënyrë tjetër të të kuptuarit dhe të matjes së inteligjencës emocionale. Është një matje vetë raportuese e inteligjencës emocionale dhe sociale, që provon një vlerësim të tyre (BarOn, 2006).

Sipas BarOn, kjo matje është e besueshme nga mosha 17- vjeçare deri në moshat më të vjetra. Përgjigjet e individit renditen në pikët e përgjithshme të koeficientit të inteligjencës dhe në pikët të pesë shkallëve përbërëse të kësaj inteligjence (BarOn, 2006).

Në raport me besueshmërinë dhe vlefshmërinë e kësaj matje të inteligjencës emocionale janë realizuar hulumtime të ndryshme, nga është raportuar për besueshmëri të kësaj matjeje vetë raportuese.

Ndërsa, në raport me përdorimin e saj në kultura të ndryshme janë bërë hulumtime intensive për të vërtetuar përdorimin e saj, nga është gjetur se ajo mund të ketë besueshmëri për përdorimin e saj në kulturën greke dhe të përdoret me grupe të ndryshme të popullatës.

Përveç kësaj është raportuar se kjo matje është e besueshme dhe mund të përdoret për matjen e inteligjencës emocionale dhe sociale edhe në kulturën belge.

Gjithashtu ka rezultuar se koeficienti i inteligjencës së Bar-On model influencon për krijimin e marrëdhënieve me të tjerët, për adaptime e ndryshime, për zgjidhjen e problemeve të natyrës personale dhe interpersonale, për përballimin mënyrë efikase të pengesave ditore, të vështirësive dhe presionit (BarOn, 2006), dhe për të pasur efekt pozitiv në mirëqenie.

Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i hulumtimeve kanë treguar se inteligjenca emocionale ka efekt pozitiv për shëndetin fizik dhe mirëqenien shëndetsore, si dhe për performancën akademike

Përveç këtyre të dhënave mbi zbatueshmërinë e këtij instrumenti në disa lloj fushash me interes, janë realizuar edhe hulumtime të ndryshme që kanë prekur fusha të tjera.

Slaski dhe Carëright (2002), raportuan për ndërlidhje mes inteligjencës emocionale dhe performancës së menaxherëve. Sipas tyre, menaxherë me nivel më të lartë të inteligjencës emocionale përjetojnë më pak stres, janë më të shëndetshëm dhe e shijojnë më shumë punën në krahasim me menaxherët me nivel më të ulët të inteligjencës emocionale.

Inventari i Kompetencave Emocionale- është matja e zhvilluar nga Daniel Goleman, që është bazuar në modelin e tij të kompetencës emocionale. Gjithashtu janë zhvilluar edhe matje të tjera të këtij modeli, që janë bazuar në modelin e inteligjencës emocionale dhe në kompetenca

korresponduese. Në grupin e këtyre matje janë: Inventari i kompetencave emocionale (Boyatzis,1994), Vlerësimi i inteligjencës emocionale (Bradberry et al., 2003) dhe Pyetëtori i profilit të punës, Version i inteligjencës emocionale (Performance Assessment Network, 2000).

Janë realizuar hulumtime të ndryshme për secilën nga metodat matëse të lart përmendura. Inventari i kompetencave emocionale ka tërhequr më shumë vëmendje nga hulumtuesit sidomos në fushën e inteligjencës emocionale.

Inventari i kompetencës emocionale ka treguar se ka një vlefshmëri të brendshme (Sala, 2002). Cavallo dhe Brienza (2002). Duke parë dallimet mes menaxherëve dhe kompetencave të inteligjencës emocionale, kanë rezultuar se menaxherët me performancë më të mirë kanë në mënyrë sinjifikante (kuptimplote) më shumë kompetenca emocionale.

Një fokusim më i madh i kësaj matjeje ka qenë i lidhur me punën në organizata, përkatësisht me efektivitetin e liderëve, me punën në ekip dhe me performancën në punë.

Offerman, me kolegë (2009), raportuan se kompetenca emocionale predikonte performancën dhe kishte korrelacion pozitiv me qëndrimet e ekipit, emergjencat dhe efektivitetin e liderëve.

Një gjetje e ngjashme u takon edhe hulumtuesve Koman dhe Wolf (2008), që kanë raportuar se inteligjenca emocionale e liderëve është e lidhur me kompetencat emocionale në grupet që ata drejtojnë dhe se këto norma të grupit ishin të ndërlidhura me performancën e ekipit e lidhur me suksesin në punë dhe suksesin në jetë.

Pyetëtori i Tipareve të Inteligjencës Emocionale- është predikuar prej teorisë së tipareve të inteligjencës emocionale, i cili përmban 153 tema, provon pikët për 15 aspekte, për 4 faktorë dhe për globalin e tipareve të inteligjencës emocionale (Petrides, 2011).

Sipas Petrides, ky pyetësor është i preferuar për tri arsye në krahasim me pyetësorët e inteligjencës emocionale: Së pari, ofron një rrugë të drejtpërdrejtë që ndërlidhet me teorinë e tipareve të inteligjencës emocionale, së dyti, promovon një përmbledhje të kuptueshme të domeneve të tipareve të inteligjencës emocionale dhe së treti, ka një vlefshmëri dhe predikim të madh.

Në dy studime që kanë kryer Petrides dhe Furnham (2001), rezulton se tiparet e inteligjencës emocionale i përkasin nivelit më të ulët të vlerësimit (taxonomis) të personalitetit. Sipas tyre, matjet e tipareve të inteligjencës emocionale nuk pritet të kenë një korrelacion të fuqishëm me matjet e inteligjencës gjenerale, ndërsa matjet e tipareve të inteligjencës emocionale duhet të ndërlidhen me matjet e tipareve të personalitetit.

TEIQue është matje e mirë e konstruktuar që tregon një term të kuptueshëm të vlefshmërisë konvergjente me shumë kritere të tjera si kënaqësia në jetë, dimensionin e deponimit dhe stili i përballjes.

Në lidhje me vlefshmërinë e matjeve të tipareve të inteligjencës, Petrides et al. (2007), është konfirmuar se tiparet e inteligjencës emocionale janë të asociuar me ndryshueshmërinë klinike dhe vlefshmërinë e tipareve të inteligjencës emocionale me tiparet e pesëshes së madhe të personalitetit. Është gjetur se tiparet e inteligjencës emocionale janë të lidhura me kënaqësinë ndaj jetës, mendimin e thellë (ruminacionin), depresionin, qëndrimet disfunktionale dhe stilin e përballjes. Tiparet e inteligjencës emocionale të matur nga TEIQue ishin negativisht e lidhur me çrregullimet mentale.

Në raport me vlefshmërinë dhe besueshmërinë TEIQue në popullatën franceze, rezultatet treguan se ishin të shpërndara në mënyrë normale dhe të besueshme e të ngjashme si në Britaninë e

Madhe. Gjithashtu treguan për vlefshmërinë konvergjente dhe dalluese, të lidhur pozitivisht me dimensionet e personaliteti.

Pikët në TEIQue predikonin depresionin, ankthin dhe mbështetjen sociale, po ashtu një gjendje të mirë afektive në të ardhmen dhe një reaktivitet emocional në situata neutrale dhe stresuese.

Nje vlefshmëri shtesë e TEIQue, por në versionin e shkurtër rezultoi edhe në studentët e universitetit kanadez, duke provuar një mbështetje dhe përdorim të formës së shkurtër të TEIQue (Siegling, Vesely, Petrides & Saklofske, 2015).

Këto të dhëna tregojnë për mundësi replikimi të hulumtimeve që raportojnë besueshmëri në mesin e kulturave dhe të moshave të ndryshme dhe, njëkohësisht, korrelacion dhe ndërveprim pozitiv me cilësitë që promovojnë mirëqenien e individit.

Në raport me përdorimin dhe ndërlidhjen e tipareve të inteligjencës emocionale, TEIQue ka realizuar disa matje me interes të hulumtueseve të ndryshëm. Maraveli et al. (2007), raportuan se tiparet e inteligjencës ishin të lidhura negativisht me mendimet depresive dhe stilin e përballjes dhe në korrelacion pozitiv me stilin pozitiv të përballjes.

Tiparet e inteligjencës, të lidhura në mënyrë negative me sjelljet antisociale si pengimi dhe agresioni, ishin në korrelacion pozitiv me sjelljet prosociale (Zacharatos, Barling & Kelloëay, 2000).

Tek të gjitha të dhënat e tipareve të inteligjencës emocionale, që ishin të lidhura me lumturinë. Chamorro- Premuzix, Bennett & Furnham (2007), panë ndërlidhjen ndërmjet tipareve të personalitetit, të inteligjencës emocionale dhe të lumturisë. Ata raportuan se katër, nga pesëshja e madhe ishin të lidhura me lumturinë dhe tiparet e inteligjencës emocionale, ndërsa tiparet e

inteligjencës emocionale shpërndanin shumicën e varianteve të ndërlidhjes të personalitetit dhe lumturisë.

Aplikueshmëria (zbatueshmëria) e TEIQue ka prekur fusha të ndryshme duke treguar vlefshmëri të qëndrueshme në mesin e hulumtuesve dhe kulturave të ndryshme. Sipas një gjetjeje të rezultonte se ata që kishin nivel të lartë të inteligjencës emocionale nuk iu shmangën diskutimit të problemeve të ndryshme dhe se çiftet më të lumtuara me marrëdhëniet e tyre kishin një nivel më të lartë të inteligjencës emocionale (Smith, Heaven & Ciarrochi, 2008).

Ekzistojnë forma të ndryshme të TEIQue, që përdoren në grup mosha të ndryshme pavarësisht nga qëllimi i hulumtimit. Sipas Petrides (2011), ekzistojnë TEIQue- forma e shkurtër ka 30 item që është e bazuar në formën e plotë që përfshin dy itema prej secilit artikujt të TEIQue. Ata janë të zgjedhur, duke u bazuar në korrelacionin korrespondues me pikët totale. Kjo ka treguar një konsistencë të vogël për adoleshentët, një version i thjeshtuar që mbledh pikët prej artikujve dhe faktorëve të njëjtë. Targeti (objektivi) kryesor i këtij instrumenti janë adoleshentët nga mosha 13 deri 17 vjet.

Datat paraprake (preliminare) sugjerojnë se konsistenca e brendshme është si për artikujt, për faktorët dhe për nivelin global të TEIQue (Petrides, 2011). Gjithashtu ekziston edhe forma shkurt e kësaj matjeje për adoleshentë dhe për një nivel të vogël të konsistencës së brendshme.

TEIQue- Qëllimi i shkurtër i kësaj forme është që të vlerësojë faktet e lidhura me emocionet të personalitetit të fëmijës. Ndryshe prej formës së adoleshentëve, kjo formë është zhvilluar veçanërisht te fëmijët nga mosha 8 deri 12 vjet.

Këndvështrimet e ndryshme rreth matjeve të inteligjencës emocionale diktuan shfaqjen e një numri të madh të instrumenteve matëse. Secila nga matjet ka vështirësitë dhe të metat e veta, gjë që ka sjellë një numër të konsiderueshëm të kritikave në drejtim të tyre.

Sipas Conte (2005), si rrjedhojë e problemit të pikëzimit, shqetësim serioz përbëjnë të gjitha matjet e inteligjencës emocionale, duke filluar nga matjet e bazuara në aftësi, deri te problemi i vlefshmërisë diskriminative (dalluese) të matjeve vetë raportuese të inteligjencës emocionale.

Nëse vlerat psikometrike të matjeve të një konstrukti që janë më të larta, ato duhet të kenë një ndërlidhje sa më të lartë rreth vetes, ndërsa është parë korrelacioni ndërmjet matjeve të ndryshme të inteligjencës emocionale.

2.8 Stilet e Prindërimit

Prindërve, si figura qendrore në një familje dhe si shtylla të zhvillimit dhe funksionimit të saj, u është kushtuar kujdes i veçantë në rrafshin shkencorë, sidomos për rolin e tyre rreth zhvillimit emocional, njohës dhe social të fëmijëve të tyre.

Mënyra se si prindërit ndërveprojnë me fëmijët që nga momenti i lindjes e deri në fazat e më vonshme të zhvillimit të tyre është reflektuar në shumë fusha të zhvillimit të tyre. Zhvillimi i duhur i personalitetit të fëmijës është i varur nga qëndrimet dhe niveli i pranisë emocionale të prindërve në drejtim të tij ose asaj.

Përvoja, vlera dhe besimet e ndryshme të prindërve janë përcaktuese në mënyrat si e kuptojnë dhe e besojnë se duhet të rrisin fëmijët e tyre, duke përdorur një larmi teknikash dhe metodash, të cilat mund të jenë ose jo më të mirat për zhvillimin e tyre.

Stilet e prindërimit paraqesin një konstrukt kompleks dhe reflektojnë një reagim tipik të sjelljes prindërore gjatë periudhës të rritjes së tyre si fëmijë. Praktikën ose stilet e prindërimit influencohen nga eksperiencat negative dhe pozitive që kanë pasur fëmijët me prindërit e tyre, gjatë kohës të rritjes së tyre, dhe si të tilla ato duhen kuptuar më shumë si një proces në të cilën ndodh socializimi se sa një praktikë socializimi në vetvete.

Praktikat e prindërimit janë konceptuar si një sistem dinamik i ndërveprimit, që përfshin monitorimin (vëmendja dhe strukturimi i kontekstit), menaxhimin e sjelljeve (si negociimi dhe zgjidhja e problemeve), dhe njohjen sociale (motivimi, vlerat, qëllimet dhe normat), me kualitetin e marrëdhënieve prindër-fëmijë (si besimi) që shërbejnë si burim i këtij procesi.

Perceptimi i autonomisë së prindërve dhe i stilit të tyre se bashku kanë efekt sinjifikant në autonominë emocionale të adoleshentëve dhe në konfliktin me prindërit e tyre

Prandaj, mënyra e prindërve në ndërveprime dhe në rritjen e fëmijëve të tyre, ka ngjallur kureshtjen e hulumtuesve për të parë stilet e ndryshme të prindërimit dhe kualitetin e jetesë së këtyre fëmijëve.

Duke njohur forma të ndryshme të rritjes së fëmijëve, Baumrind (1971), identifikoi tri stile të prindërimit, bazuar në dy aspekte të sjelljeve: kontrolli dhe ngrohtësia.

Kontrolli i referohet shkallës në të cilën prindërit i menaxhojnë sjelljet e fëmijëve të tyre, duke filluar nga kontrolli fortë e deri në vendosjen e rregullave dhe kërkesave të pakta. Ndërsa *ngrohtësia* e prindërve i referohet shkallës në të cilën prindërit pranojnë dhe përgjigjen për sjelljen e fëmijëve të tyre ose, e kundërta, refuzojnë dhe bëhen të papërgjegjshëm.

Më vonë, Maccoby dhe Martin (1983), duke u bazuar në këto karakteristika që përshkroi Baumrind, paraqitën edhe stilin e katërt të prindërimit.

Sipas Baumrind-it (1988, 1967), këtyre dimensioneve të prindërimit i referohet edhe kërkesa dhe përgjegjshmëria. E para ka të bëjë me ngrohtësinë, pranimin dhe përfshirjen që tregojnë prindërit, ndërsa e dyta me kontrollin, kërkesat e matura dhe mbikëqyrjen e prindërve ndaj fëmijëve të tyre (Maccoby & Martini, 1983).

Që të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme këto të dhëna të ndryshme shkencore, është e domosdoshme që të jenë të lidhura me përmbajtje teorike dhe ndërveprimin ndërmjet besimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të prindërve në drejtim të fëmijëve të tyre si dhe benefitet (përfitimet) dhe pasojat që rrjedhin te gjenerata e re si rezultat i stileve të ndryshme të prindërimit.

Baumrind (1966), theksoi se prindërit dallohen nga kërkesat dhe përgjegjshmëria në raport me fëmijët e tyre dhe se nga kombinimi i tyre rrjedh burimi teorik i saj në konceptualizimin dhe kuptimin e stileve të prindërimit.

Në konceptualizimin e stileve të prindërimit, nga Baumrind (1968), prindërit besojnë në vlerat që ata mbajnë si prindër dhe se natyra e fëmijëve ndihmon në vendosjen e prezantimit të sjelljeve, të afekteve dhe të vlerave.

Sipas Darling-ut dhe Steinberg-ut (1993), formimi teorik i Baumrind-it ndahet në tri grupe.

Së pari, Ai specifikoi një funksionim (veprimtari) të gjerë të funksionit të kontrollit të prindërve dhe shtoi artikulime të ndryshme brenda këtij domeni.

Se dyti, Sugjeroi që kontrolli i prindërve të organizohet në mënyrë lineare prej lart-poshtë, si dhe i diferencoi kontrollet në tipe të ndryshme kualitative..

Se treti, Ndikimi në aspektin e prindërimit si ideologjia, pjekuria e kërkesave ose përdorimi i një teknike specifike disiplinore është e varur nga konfigurimi i të gjitha aspekteve.

Baumrind e shikoi socializimin si një proces dinamik dhe hipotetizoi se stilet e prindërimit, që përdoren, janë të ndryshme dhe varen nga fakti se sa fëmijët janë të hapur në përpjekjet e prindërve të tyre për t'i socializuar ata (Darling & Steinberg, 1993). Sipas tyre, modelet më të hershme të prindërimit kanë identifikuar tri karakteristika të prindërimit që determinojnë proceset përgjatë së cilave stilet e prindërimit influencojnë zhvillimin e fëmijës, vlerat dhe qëllimet që prindërit kanë në socializimin e fëmijëve të tyre, në praktikat e prindërimit që ata punësojnë, si dhe në qëndrimet që ata shprehin në drejtim të fëmijëve të tyre.

Si rrjedhojë, këndvështrimi teorik i Baumrind takohet në ndërveprimin ndërmjet nivelit të kontrollit dhe të ngrohtësisë në drejtim të tyre.

Kontrolli i prindërve si për fëmijët ashtu dhe për adoleshentët e tyre ka marrë shpjegime dhe kahje të ndryshme në shpjegimin e efekteve të tij tek gjenerata më e re, por që duhet të jetë mjaft kompleks.

Steinberg (1990), kunkludoi (postuloj) se dy format e kontrollit të prindërve, kanë efekte të kundërta te fëmijët. Kontrolli psikologjik rezulton me efekte negative te fëmijët dhe adoleshentët e tyre.

Kontrolli i prindërve ka efekte të ndryshme në mirëqenien e fëmijëve të tyre, ku sipas Barber-it (1996), kontrolli psikologjik në para adoleshencë dhe në adoleshencë, predikonte internalizimin e problemeve si depresioni dhe eksternalizimin e problemeve si delikuenca, ndërsa kontrolli i sjelljes ishte i lidhur me eksternalizimin e problemeve. Lidhjet negative të kontrollit psikologjik me shëndetin e fëmijëve dhe të adoleshentëve janë konsistente (të qëndrueshme)

Në raport me kontrollin e prindërve janë paraqitur 15 forma të ndryshme të shpjegimit dhe të përshkrimit të kontrollit të prindërve në fëmijët e tyre, ndonëse të shoqëruar me termin e armiqësisë si, autoritativ, disiplinë, kërkesa, dominim, mbrojtës, ndëshkues dhe kufizues si dhe termat e tjerë përfshinë autoritativ, shtrëngim, pohim i pushtetit etj. Janë paraqitur forma të ndryshme të cilat përpiqen që të gjejnë shpjegim mbi kontrollin e prindërve në fëmijët e tyre.

Duhet të kuptohet roli kompleks i prindërve në socializimin e fëmijëve , që ata të formojnë interesin, aftësitë dhe identitetin e tyre. Këto forma shumë dimensionale pranojnë se presioni, bezdisja dhe dominimi i prindërve sulmon individualitetin e tyre, dhe se këto relacione të fuqishme minojnë zhvillimin e fëmijëve.

Kontrolli psikologjik ka të bëjë me presionin dhe dominimin e prindërve në raport me atë se çfarë ndiejnë dhe mendojnë fëmijët, ndërsa kontrolli i sjelljes ka të bëjë me dimensionin e udhëzimit si një strukturë e prindërimit në raport me aktivitetet e fëmijës.

Kontrolli i sjelljes i referohet reagimit të prindërve në raport me sjelljet e fëmijëve, përgjatë strategjive, si rregullimi i pritjeve dhe monitorimi, ndërsa kontrolli psikologjik i referohet manipulimit të sjelljeve të prindërve si fajësimi, turpërimi dhe tërheqja e dashurisë. Kontrolli i prindërve është i shoqëruar me një varg problemesh të fëmijët dhe adoleshentët e tyre.

Sipas hulumtuesve Soenens, Park, Vansteenkiste dhe Mouratidis (2012), efektet negative të kontrollit psikologjik mund të gjeneralizohen (përgjithësohen) në kultura të ndryshme, prej nga u gjetur lidhja mes këtij domeni psikologjik dhe personalitetit e simptomave depresive, si në kulturën belge dhe koreano jugore.

Nëpërmjet dy formave të kontrollit të prindërve janë demonstruar efekte të ndryshme të fëmijët e tyre edhe kur kombinohen me faktorët e tjerë. Kështu, kontrolli psikologjik i nënës, kombinuar

me ndjeshmëri të lartë emocionale, parashikon rritjen e nivelit të problemeve emocionale dhe të sjelljes tek fëmijët, ndërsa kontrollimi i sjelljes zvogëlonte problemet në sjelle të fëmijëve, por vetëm kur niveli i kontrollit psikologjik ishte i vogël (Aunola & Nurmi, 2005).

Nga ana tjetër, ngrohtësia e prindërve ka treguar se kishte korrelacion pozitiv me rritjen e rregullimit psikologjik (Suchman, Runsaville, DeCoste & Luthar, 2007).

Secili nga stilet e prindërimit ka një nivel të caktuar të zotërimit dhe të përdorimit të këtyre dimensioneve(kontrollin dhe ngrohtësinë prindërore), duke ndikuar në formën se si ata e konceptojnë mënyrën dhe metodat më të mira të rritjes së fëmijës. Si rezultat, kemi dhe stile të ndryshme që postuloi Baumrind (1971, 1991), si stili i prindërimit autoritativ, ai autoritarian, stili tolerant në kuadër të së cilit përfshihej edhe stili neglizhues, që u shtua me vonë.

Stili neglizhues u konceptualizua nga (Maccoby & Martin, 1983). Prindërit autoritativ janë edhe kërkues dhe të përgjegjshëm, prindërit neglizhues nuk janë as kërkues dhe as të përgjegjshëm, prindërit tolerantë nuk janë kërkues, por janë të përgjegjshëm dhe prindërit autoritarian janë kërkues, por jo të përgjegjshëm (Steinberg, 2005).

Kontrolli autoritarian dhe tolerant, te dyja se bashku minojnë mundësinë e fëmijëve për një interaksion (ndërveprim) energjik me njerëzit e tjerë.

Por a kemi dallime ndërmjet nënave dhe baballarëve, moshës së tyre dhe moshës së fëmijëve në stilet që ata internalizojnë si mënyra me e duhur për rritjen e fëmijëve?

McKinney dhe Renk (2008), në përgjithësi theksuan se djemtë i vlerësuan nënat e tyre si shumë mbrojtëse, të bezdisshme dhe të ngrohta, ndërsa baballarët e tyre si të largët dhe jo të ngrohtë.

Vajzat i vlerësuan nënat e tyre si ofruese për një marrëdhënie dy anshme e mbështetëse dhe baballarët e tyre si autoritativ që kalonin shumë pak kohë me to.

Halpenny, Nixon dhe Eaton (2010), kanë treguar se dy aspekte të sjelljeve ndaj fëmijëve mund të lidhen me moshën e prindërve. Kur këta të fundit kanë qenë 45 vjet e lart shënuan pikë më të larta në perceptimin demokratik se prindërit e rinj, ndërsa kur ishin më të rinj se 35 vjet shënuan pikë më larta në ndëshkimin trupor.

Në strategjitë prindërore mund të ndikojë edhe moshja e fëmijëve, sepse fëmijët e prindërve më të vjetër tentojnë që edhe ata të hiqen si të tillë, ndonëse nuk është gjetur ndonjë lidhje mes moshës së prindërve dhe pikëve në stilin autoritarian dhe autoritativ të prindërimit. Gjinia e prindërve rezultoi se ishte lidhur me tri dimensionet e sjelljeve së tyre. Kështu nënat kishin pikë më të larta se baballarët në ngrohtësi dhe përfshirje, në njoftime dhe arsyetim dhe në krejt shkallën e stilit autoritativ dhe nuk u gjet asnjë dallim ndërmjet nënave dhe baballarëve në ndonjë aspekt të prindërve autoritarianë. Gjithashtu nuk vërejtën dallime në stilin e prindërimit bazuar në shtresën sociale të kategorizuar dhe në nivelin e edukimit të prindërve (Halpenny et al., 2010).

Po ashtu, sipas tyre sjelljet e prindërve dallonin dhe kishin lidhje sinjifikante me moshën e fëmijës së selektuar, ku prindërit e fëmijëve më të rinj treguan pikë më të ulëta në perceptimin demokratik, në arsyetim dhe në armiqësinë verbale; ndërsa pikët në ndëshkimet trupore ishin më të larta te prindërit e fëmijëve më të rinj (0 – 4 dhe 5 – 9 vjet) dhe më të vogla te prindërit e moshës më të vjetër. Nga ana tjetër pikët në stilin autoritativ ishin më të vogla te fëmijët të moshës (0 – 4), në krahasim me prindërit e fëmijëve të moshave (10 – 14 dhe 15 – 17 vjet) (Halpenny et al., 2010).

2.8.1. Stili autoritativ i prindërimit

Stilet e prindërimit përfaqësojnë një konstrukt makro-nivel dhe supozohet të reflektojnë përgjigjet tipike të prindërve ndaj situatave të rritjes së fëmijëve. Në të kundërt, besimet prindërore dhe përgjigjet emocionale zakonisht shihen si më specifike për situatën, duke ndryshuar si një funksion i kontekstit fëmijëror

Prindërit autoritativ tentojnë t'i drejtojnë aktivitetet e fëmijëve të tyre në mënyrë racionale (Baumrind, 1966). Sipas saj këta prindër inkurajojnë komunikimin verbal, domethënë jep dhe merr, shpjegojnë arsyen racionale mbrapa rregullave dhe objektivin e saj/ tij kur fëmijët refuzojnë të konfirmohen.

Këta prindër, që mbahen si njerëz të rritur, njohin dhe pranojnë interesat individuale të fëmijëve në mënyrë speciale. Prindërit autoritative afirmojnë kualitetet prezente të fëmijëve të tyre, por vendosin edhe standarde që duhen arritur (Baumrind, 1966). Prindërit autoritativ shfaqin karakteristika të ndryshme në raport me fëmijët tyre si komunikimin e duhur, besimin në drejtim të fëmijëve të tyre si dhe nivel të lartë kontrolli dhe monitorimi.

Si përfundim, ky kategorizim tregon se stili i kontrollit si prindër dhe autonomia e fëmijëve të tyre të bazohen në konceptin Hegelian të lirisë dhe të vlerësimit të nevojës. Gjithashtu tregon aftësinë e prindërve për të vendosur rregulla të arsyeshme rreth pritjeve të fëmijëve të tyre, për t'i ndryshuar ose për t'i përshtatur rregullat nëse parimet e caktuara prej tyre janë shkatërruese për fëmijët e tyre.

Përveç rregullave prindërit shfaqin edhe ngrohtësinë e nevojshme për fëmijëve, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për rritjen e tyre.

Në raport me përfitimet dhe me efektet e prindërve autoritativ se si duhet rriten fëmijët janë realizuar një sërë hulumtimesh që kanë prekur fusha të ndryshme të zhvillimit emocional dhe kognitive (njohës) të fëmijëve, si dhe sjelljet dhe performancat e tyre në mjedise të ndryshme.

Adoleshentët, që janë trajtuar nga prindërit e tyre ngrohtësisht, në mënyrë demokratike dhe të vendosur, ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre, karakterizohen nga qëndrime dhe besime pozitive rreth arritjeve të tyre, dhe për rrjedhojë ata kanë më shumë gjasa që të kenë rezultate më të mirë në shkollë.

Fëmijët e këtyre prindërve janë në gjendje t'i shmangen influencës së keqe të bashkëmoshatarëve dhe sjelljeve të rrezikshme pasi ata konsultohen dhe diskutojnë planet dhe problemet e tyre me prindërit e tyre. Fëmijë të tillë janë me kompetentë nga ana sociale. Adoleshentët të cilët janë më të aftë në shoqëri dhe kanë marrëdhënie më të mira miq dhe shokë dhe i përshkruajnë prindërit e tyre si të ngrohtë, përkrahës, fleksibël dhe si të inkurajojnë autonominë e fëmijëve të tyre edhe pse vazhdojnë të monitorojnë aktivitetet e tyre.

Autonomia e prindërve ka rezultuar pozitivisht e lidhur me vetë raportin e autonomisë së fëmijes, vetë rregullimin emocional, me arritjet shkollore dhe shoqërore, me vlerësimin pozitiv të mësuesve rreth kompetencave, notave dhe arritjeve në shkollë.

Ndër karakteristikat e rëndësishme të prindërve autoritativ është monitorimi ndaj fëmijëve që jep efekte pozitive në sjelljet e tyre. Borawski, Ieverd- Landis, Lovegreen dhe Trapl (2003), raportuan se te fëmijët që u mungonte monitorimi i plotë dallohej një korrelacion i fuqishëm me rritjen e sjelljeve të rrezikshme si (aktivitetet seksuale, përdorimi alkoolit dhe marijuanës). Te

meshkujt monitorimi i prindërve ishte i lidhur me përdorim më pak të alkoolit dhe të prezervativëve.

Monitorimi i prindërve ka efekte në periudha të ndryshme, ngaqë rreziku i përdorimit të drogave në mes të rinjve është më i lartë nëse monitorim i prindërve është më i vogël në fëmijëri

Monitorimin këta prindër nuk e ngatërrojnë me kontrollimin, por ju shërben si një mjet i ndërlidhjes me interesat e fëmijës dhe në të njëjtën kohë të sigurojnë vazhdimësinë e kërkesave apo pritjeve që kanë ndaj fëmijës së tyre. Monitorimi ndikon veçanërisht në reduktimin e sjelljeve me rrezik të lartë.

Këta prindër i shohin fëmijet si të barabartë jo nga përvoja dhe mënçuria, por nga ajo e vlerave njerezore. Prindërit autoritativ apo demokratik vendosin rregulla dhe kufij, por ua shpjegojnë pse duhen ndjekur rregullat. Ata nuk i ndeshkojnë pa vend fëmijet, por njekohesisht nuk u japin shperblime të pamërituara. Karakteristikat pozitive të prindërve autoritativ janë shfaqur në sensin pozitiv edhe të fëmijët, nga vetëbesimi i ndërsjellët me prindërit e tyre. Për këto arsye ata kanë më pak gjasa të përfshihen në sjellje me rrezik të lartë si delikuenca, dhe të kenë një performancë (paraqitje) më të mirë akademike nëse të dy prindërit e tyre janë autoritativ.

Po ashtu, fëmijët e prindërve autoritativ kanë treguar se janë të pavarur, vetëkërkues, të shoqërueshëm me bashkëmoshatarët dhe bashkëpunues me prindërit (Baumrind, 1971).

Efektet pozitive të stilit autoritativ të prindërimit janë si pasojë e balancimit të qartë të kërkesave të larta prindërore me përgjegjshmëri emocionale, e pranimit dhe e njohjes së autonomisë së fëmijës. Këto karakteristika janë parashikuesit më të qëndrueshëm për një zhvillim optimal të fëmijut dhe të arritjes së kompetencave të pritura për ta në pika të ndryshme të zhvillimit

Sipas Laible-s dhe Carlo-s (2004), stili autoritativ i prindërimit, si kombinim i një kontrolli fleksibël dhe i një niveli të lartë të mbështetjes, duket se është stili më i efektshëm dhe me benefite për fëmijët dhe adoleshentët. Ai është i lidhur me disa përfundime pozitive si vetëvlerësimi, sjellja prosociale, nivel i vogël i agresionit, i ankthit dhe i depresionit.

Stili autoritativ raportohet është i lidhur në mënyrë të qëndrueshme me aspekte pozitive si notat dhe angazhimit akademik, kompetencat sociale, vetërregullimin, marrja e perspektivës se tjetrit. Gjithashtu është provuar në shumë studime r që fëmijët e prindërve autoritativ janë psikologjikisht më të pjekur, më kompetentë në aspektin akademik, më pak pronë e problemeve emocionale, veçanërisht të ankthit si dhe më pak probleme me bashkëmoshatarët e tyre.

Adoleshentet nga familje autoritative që kanë aplikuar (zbatuar) më shumë strategji përshtatëse, janë më të vetdijshëm për peshën e vendimeve të tyre, kanë prirje të ulta për dështime, nuk karakterizohen nga sjellje jo të përshtatshme, janë aktiv në jetën shkollore dhe sociale, janë në gjendje të vlerësojnë rëndësinë e pavarësisë së tyre, kanë koncepte të qarta për vehten si dhe gjithashtu kanë aftësi shumë të mira për të arritur qëllimet e tyre.

Në shumë situata adaptimi i fleksibilitetit dhe ngrohtësisë së prindërve autoritativ është një metodë me më shumë benefite për zhvillimin emocional, social, intelektual dhe moral të fëmijëve (Bornstein & Bornstein, 2007).

Përfundimet pozitive janë të qëndrueshme në mes hulumtuesve që tregojnë përfundime të dëshiruara që ofron ky stil i prindërimit. Kopka (2007), theksoi se hulumtimet kanë demonstruar se adoleshentët me prindër autoritativ mësojnë si të negociojnë dhe të angazhohen në diskutime, të kuptojnë se opinionet e tyre vlerësohen dhe, si rezultat, kanë më shumë gjasa të jenë të përgjegjshëm, kompetentë socialë dhe autonomë.

Karavasilis, Doyle dhe Markiewicz (2003), treguan se stili autoritativ i prindërimit parashikon një atashim të sigurt ndërmjet fëmijëve dhe kujdestarëve dhe kontribuon në një sens më të madh të autonomisë.

Kur u bë krahasimi mes adoleshentëve me prindër autoritativ me atyre me prindër neglizhues, u konstatua një nivel i lartë i kompetencave psikologjike të parët dhe nivel i ulët në funksionimin psikologjik dhe në sjelljen për të dytët (Lamborn, Mounts, Steinberg & Dornbusch, 1991).

Ngrohtësia emocionale dhe kontrolli neutralizues i këtyre prindërve në drejtim të fëmijëve të tyre ka treguar benefite të vazhdueshme për ata dhe këto rezultate janë më ekuivalente kur kombinohen me faktorë të tjerë pozitivë që vijnë nga temperamentit i fëmijës. Nga kjo është gjetur se stili autoritativ i prindërimit dhe komunikimi i hapur i ndjenjave dhe i emocioneve, së bashku me minimizimin e përgjigjeve të prindërve ndaj emocioneve negative të fëmijëve të tyre, të jetë faktor mbrojtës për zhvillimin e problemeve emocionale. Stili autoritativ i prindërimit ka treguar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme) se është stili i duhur dhe më efektiv i prindërimit.

2.8.2. Stili autoritarian i prindërimit

Një nga mënyrat më destruktive (shkatërruese) në rritjen e gjeneratës së re dhe me efekte negative në mirëqenien e fëmijëve është stili autoritarian i prindërimit. Sipas Baumrind (1971), ky stil i prindërimit është tepër kërkues, ushtron kontroll të fortë mbi sjelljet e fëmijëve të tyre dhe i detyron të zbatojnë kërkesat e tyre me kërcënime dhe ndëshkime.

Prindërit autoritarianë tentojnë të modelojnë dhe të vlerësojnë sjelljet dhe qëndrimet e fëmijëve në akordim me një set standardesh të vendosura, zakonisht, me një standard absolut

teorik i motivuar dhe formuluar nga një autoritet i lartë.. Ata vlerësojnë bindjen si një virtyt dhe favorizojnë ndëshkimin dhe forcën që të mbajnë nën kontroll këmbëngulësinë në pikën kur besojnë se besimet dhe qëndrimet e fëmijëve të tyre janë në konflikt me atë që ata besojnë se është një udhëheqje e drejte.

Ata janë shpesh të ftohtë, jo mbështetës dhe të pandjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve të tyre dhe bëjnë kërkesa që t'i kenë nën kontroll (Rothrauff et al., 2009). Këta prindër mbajnë në një shkallë të lartë kontrollin mbi jetën e fëmijëve të tyre dhe se ndërveprimi i tyre me fëmijën si prindër është i bazuar në një hierarki strikte të fuqisë.

Stilin e prindërimit autoritarian e karakterizojnë zemërgurësia, pandjeshmëria, të qenit strikt dhe mungesa e vëmendjes ndaj nevojave zhvillimore të fëmijëve

Prindërit autoritarianë limitojnë rritjen e pasardhëseve të tyre duke jua kufizuar lirinë e mjaftueshme që të zhvillojnë strukturat e tyre kognitive (njohëse) dhe të inkorporojnë mundësitë e reja.

Qëndrimet e një autoritariani mund të përkufizohen si besime prindërore për kontrollin total të fëmijëve dhe favorizimin e nënshtrimit të verbër të fëmijëve ndaj autoritetit të tyre. Këta fëmijë ndihen të frikësuar ndaj sfidave dhe eksperiencave që bëjnë.

Autoritarianët janë më pak fleksibël në reagimet e tyre ndaj fëmijëve dhe ndërveprimi i tyre me fëmijët është zakonisht i fokusuar në disiplinim dhe kontrollim të tyre. Prindërit autoritarianë janë të prirur më shumë nga përdorimi i forcës, mungesës së ngrohtësi dhe kujdesit emocional. Ata tentojnë të vlerësojnë dhe kontrollojnë sjelljet dhe qëndrimet e fëmijëve të tyre sipas standarteve të vendosura mbështetur në parimet, vlerat dhe besimet e tyre personale. Ky kontroll mund të rezultojë me përfundime jo të mira, pasi vëzhgimet e kryera në shumë

studime kanë treguar se ndërveprimet ndërmjet këtyre prindërve me fëmijët e tyre të ketë rezultuar me fëmijë të turpshëm, me mungesë iniciative si dhe shumë ansioz.

Ka prindër, që karakterizohen si autoritarianë, jo fleksibil dhe tejet kontrollues, duke pasur një ndikim shumë të madh në aftësitë e menagjimit të inatit. Është e llogjikshme të mendohet që nëse fëmijët rriten nën një presion të vazhdueshëm për kontroll të jenë pasivo-agresive dhe të jenë të pavendosur. Gjithashtu duke arritur në adoleshencë ndërsa ata kanë problemet e tyre të zakonshme me identitetin mund të anashkalojnë autoritetin prinderor duke ju drejtuar alkolit dhe drogave.

Kontrolli dhe ashpërsia e prindërve në qëndrimet ndaj fëmijëve të tyre ka bërë të paraqiten hipoteza të ndryshme që të japin shpjegimin të duhur ndaj strategjive të rritjes që përdorin këta prindër. Coplan et al. (2002), kanë parë qëndrime dhe atribuime të nënave autoritariane dhe autoritative dhe ka theksuar se nënat autoritariane nuk demonstuan një zhvillim optimist në atribuimet që i karakterizon nënat tjera. Tendencat e tyre që sjelljet pozitive të fëmijëve t'i shohin si të shkaktuar nga faktorët e jashtëm, ndërsa sjelljet negative si të shkaktuara nga shkaktarët e brendshëm dhe që mund të përshkruhen si pesimiste.

Gjithashtu ato vlerësojnë më pak paraqitjen e qëllimeve shprehëse (empatike) që janë më pak të fuqishme në përgjigjen e sjelljeve më pak të dëshirueshme dhe se nënat autoritariane përjetojnë më shumë emocione negative si nervozi dhe shqetësime përgjatë të gjitha konteksteve të rritjes së fëmijëve (Coplan et al., 2002).

Prindërit autoritarianë përdorin strategji që janë të vështira dhe të ashpra, me nivel të vogël të komunikimit me pasardhësit e tyre dhe, si rezultat, sjellin përfundime që janë rrënuese (destruktive) për gjeneratën e re.

Është gjetur në shumë studime se nënat e ashpra ndikojnë në rregullimin emocional të fëmijëve të tyre më shumë sesa baballarët, dhe nga ana tjetër, baballarët ushtrojnë ndikim në shfaqjen e sjelljeve agresive. Efektet e babait ishin më të fuqishme për djemtë se sa për vajzat, ndërsa nuk kishte dallime gjinore në raport me efektet e nënave të ashpra. Te meshkujt e prindërve autoritarianë u shfaq nivel i lartë i neurocitizmit, që ishte i lidhur me problemet e alkoolit dhe se i njëjti qëndrim ishte gjetur të femrat (Patock- Peckham & Morgan- Lopez, 2009a).

Pra, vështirësitë e fëmijëve të prindërve autoritarian janë evidente. Një studim ndërseksional ka treguar se qëndrimet autoritariane të shprehur nga nëna kishin një ndikim sinjifikant në zhvillimin e problemeve konduktive në sjellje të fëmijët nga 5 deri në 10 vjeç (Thompson, Hollis & Richards, 2003).

Gjithashtu autoritativizmi ishte i lidhur me performancë dhe me arritje më të dobëta në shkollë të fëmijëve të tyre, dhe me inkompetencën në jetën sociale.

Prindërit autoritativsitë karakterizohen për komunikim emocional negativ si në shprehjen e emocioneve dhe për reagime jo të duhura, duke treguar një mungesë ngrohtësie dhe empatisë në drejtim të fëmijëve që afekton jetën emocionale të pasardhësve të tyre.

Eisenberg, Cumberland dhe Spinrad (1998), raportuan se emocionaliteti negativ i prindërve dhe reagimi negativ ndaj shprehjes së emocioneve të fëmijëve ishte e ndërlidhur me emocionalitetin negativ të fëmijëve dhe me kompetenca të vogla sociale.

Si rezultat i rregullave strikte të tyre, këta adoleshentë mund të jenë rebelë ose të varur ndaj prindërve të tyre; të parët janë rebelë mund të shfaqin sjellje agresive, ndërsa të dytët tregojnë varësinë me prindërit e tyre, pra, tentojnë të jenë më të nënshtruar.

2.8.3. Stili tolerant i prindërimit

Prindërit tolerantë tentojnë të sillen në mënyrë jo ndëshkuese, pranuese dhe afirmative në drejtim të impulseve, të dëshirave dhe të veprimeve të fëmijëve të tyre. Ata bëjnë pak kërkesa për detyrat e shtëpisë dhe për sjellje (Baumrind, 1966).

Sipas Baumrind-it, këta prindër i lejojnë fëmijët të vetërregullojnë aktivitetet e tyre dhe, sa më shumë të jetë e mundur, t'i shmangen ushtrimit të kontrollit; gjithashtu nuk i inkurajojnë ata që të përmbahen ose t'i nënshtrohen standardeve të përcaktuara saktësisht.

Prindërit e karakterizuar me këtë stil të prindërimit nuk kërkojnë sjellje të pjekura prej fëmijëve të tyre, por i lejojnë ata të sillen në mënyrë të pavarur (Baumrind, 1991). Moskontrolli dhe kërkesat ndaj fëmijëve të tyre sjellin përfundime të ndryshme të këta fëmijë.

Barber (1996), sugjeroi se një mjedis i pakontrolluar si ai prindërve tolerantë dhe neglizhues nuk i edukon fëmijët drejt vetërregullimit dhe mund t'i çojë ata drejt sjelljeve impulsive. Prindërit tolerantë janë ekstremisht të butë dhe tentojnë të shikojnë jashtë për sigurinë e fëmijës (Baumrind, 1978).

Në Spanjë stil tolerant është stili optimal i prindërimit, sepse është i lidhur me përfundime më të mira ose të barabarta me stilin autoritativ. Përfundimet rezultuan shumë më të mira se te adoleshentët me prindër autoritarianë dhe neglizhues (Garcia & Garcia, 2009).

Këto të dhëna treguan përfundime më të mira në vetëvlerësim që përfshinte komponentët (social, emocional, fizik, familjen dhe aspektin akademik), në mospërshtatjen psikologjike (agresioni/ armiqësia, vetëvlerësimi negativ, shikimi negativ i botës, papërgjegjshmëria emocionale dhe jostabilitet emocional), kompetencat personale (si kompetencat sociale,

mesatarja e pikëve në nota dhe numri i dështimeve në nota), si dhe probleme në sjellje (mos ndjekja e shkollës, delikuenca dhe përdormi i drogës) (Garcia & Garcia, 2009).

Sipas Million dhe Everly (1985), narcizmi mund të manifestohet si rezultat i shpërblimeve të vazhdueshme në drejtim të fëmijëve të tyre, pa shikuar nëse ai/ ajo meriton një shpërblim të tillë dhe kjo shkakton që këta fëmijë të zhvillojnë grandiozitetin që është qendra e narcizmit.

Adoleshentet me prindër tolerantë mësojnë se ka shumë pak kufij dhe rregulla; ata kanë shumë pak gjasa që të jene seriozë dhe si rezultat kanë vështirësi në vetëkontroll dhe të demonstrojnë tendenca egocentrike që mund të ndërhyjnë (interferojnë) në zhvillimin e duhur të marrëdhënieve me bashkëmoshatarët (Kopko, 2007).

2.8.4. Stili neglizhues i prindërimit

Baumrind i dalloi stilet e prindërimit duke u bazuar në nivelin e ngrohtësisë dhe të kërkesave që prindërit kanë në drejtim të fëmijëve të tyre dhe nga kombinimi i tyre me përdorimin e strategjive, praktikave dhe metodave të ndryshme të rritjes së gjeneratës së re.

Prindërit neglizhues nuk tregojnë ngrohtësi dhe nuk kanë kërkesa në drejtim të fëmijëve të tyre (Kopko, 2007). Ata minimizojnë kohën e ndërveprimit me fëmijët tyre dhe janë të pamotivuar deri në pikën e të qenit neglizhues dhe si të tillë, ata janë indiferentë për nevojat e adoleshentëve të tyre, për eksperiencat e tyre në shkollë apo me shokët e tyre. Ata shumë rrallë ushtrojnë vëmendje dhe në përgjithësi nuk dëshirojnë të pengohen nga fëmijët e tyre (Kopko, 2007).

Prindërit që nuk angazhohen për rregullimin e sjelljeve të fëmijëve të tyre janë të përcaktuar si prindër neglizhues (Turner et al., 2009)

Sipas Kopko-s (2007), hulumtimet kanë zbuluar se adoleshentët e prindërve neglizhues mësojnë se etërit janë më shumë të interesuar në jetën e tyre dhe me pak gjasa

të investojnë kohë në prindërit. Si rezultat, prirjet e tyre janë të njëjta si tek adoleshentet e familjeve tolerante; po ashtu ata kanë probleme me vetëregullimin dhe demonstrojnë sjellje impulsive. Fëmijët që treguan se prindërit e tyre ishin neglizhues ndaj tyre, janë më pak të pjekur, më pak kompetent edhe me më shumë probleme (Steinberg et al., 2006).

Perceptimi i prindërve si neglizhues në fëmijërinë e tyre kishte korrelacion me përpjekjet për vetëvrasje një herë gjatë jetës, megjithatë kjo lidhje ishte sinjifikante vetëm për femrat e jo për meshkujt (Ehnvall, Parker, Hadzi- Pavlovmi nikiic & Malihi, 2008).

Të pasurit prindër neglizhues nuk kishte ndonjë lidhje me zhvillimin konjitiv, motorik dhe zhvillimin e gjuhës ekspresive, ndonëse fëmijët prej familjeve më të sigurta kishin një gjuhë komunikimi më të mirë (Harrington, Duboëitz, Black & Binder, 1995).

Adoleshentët e këtyre familjeve në raport me strategjitë e arritjeve akademike të tyre kanë treguar strategji jo më të përshtatshme për arritjet akademike, nivel të lartë të detyrave dhe sjelljeve irrelevante, pasivitet dhe mungesë e atribuimeve të vetritjes (Aunola et al., 2000). Këta fëmijë kanë treguar që të kenë disavantazhe në arritjet akademike (Baumrind, 1991).

Stili neglizhues i prindërimit ishte lidhur me rregullimin emocional të ulët dhe rritjen e sjelljeve agresive të fëmijëve (Ramsden & Hubbard, 2002). Ndërsa Denham, Workman, Cole,

Weissbrod, Kendziora dhe Zahn- Waxler (2000), kanë gjetur të ngjashme dhe treguan se stili neglizhues mund të jetë edhe më negativ për fëmijët me shumë vështirësi në temperament.

2.9. Stilet e prindërimit dhe përfundimet e tyre

Stilet e prindërimit vazhdojnë të jenë të lidhura me funksionet e ndryshme gjatë gjithë jetes (Rothrauff, Cooney & Shin An, 2009). Sipas Belsky (1984), tri faktorët (domenet) që influencojnë prindërimin janë identifikuar si: burimet psikologjike personale të prindërve, karakteristikat e fëmijëve dhe burimet kontekstuale të stresit dhe mbështetjes.

Mënyra se si rriten fëmijët nga ana e prindërve të tyre është shoqëruar me probleme të ndryshme të fëmijët e tyre (Darling 1999).

Stilet e prindërimit promovojnë fuqishëm funksionimin e prindërve dhe predikojnë një mirëqenie përgjatë mjediseve të ndryshme dhe komuniteteve të ndryshme të fëmijëve. Nivelet e ndryshme të kërkesave dhe përgjegjshmërisë janë pjesa determinante e këtyre stileve të prindërimit. Alegre (2011), raportoi se përgjegjshmëria dhe kërkesat pozitive të prindërve, si dhe roli i tyre si mësuese të emocioneve janë të lidhur me nivelin e lart të inteligjencës emocionale të fëmijëve të tyre, ndërsa kërkesat negative të prindërve janë të lidhura me nivelin e ulët të inteligjencës emocionale.

Niveli i inteligjencës emocionale dallohet pavarësisht nga stili i prindërimit, ku janë treguar dallime sinjifikante (të rëndësishme) mes stilit autoritativ dhe atij neglizhues të prindërimit, si dhe nivelit të inteligjencës emocionale të adoleshentëve (Mohammadaryi, 2013).

Ndonëse mungojnë studime më të detajuara dhe rigorozë në këtë drejtim, kemi konceptualizim dhe metoda të ndryshme të matjes se inteligjencës emocionale. Alegre (2011), ka treguar se nuk

ka ndonjë lidhje mes tipareve të inteligjencës emocionale të fëmijëve dhe stilit të prindërve të tyre, ndonëse është raportuar se kemi një lidhje mes tipareve të inteligjencës emocionale dhe praktikave të prindërimit.

Për të kuptuar më mirë efektet e stilit të prindërimit janë prekur aspekte të ndryshme të zhvillimit që nga fëmijëria deri në adoleshencë, të cilat kanë treguar dallime mes stileve të ndryshme dhe përfundimeve që ato sjellin te gjenerata e re. Prandaj do të konsultohet literatura mbi fusha të ndryshme, të cilat janë në ndërveprim me stilet e prindërimit.

Bibi, Chaudhty, Aëan dhe Tariq (2013), raportuan se stilet e prindërimit kanë efekt në edukimin dhe mirëqenien psikologjike të fëmijëve, ku stili i autoritativ ka efekt pozitiv në këto aspekte të jetës.

Ndërvarësi në mes të performancës akademike dhe stileve të prindërimit kanë raportuar edhe (Pong, Hao & Gardner, 2005). Gjithashtu Pong dhe shokët e tij treguan se kishte dallime sinjifikante (të rëndësishme) etnike/ raciale me statusin e gjeneratave në stilet e prindërimit.

Gonzales, Doan Holbein dhe Quilter (2002), kanë theksuar se nënat autoritative ishin të lidhura me orientimin drejt zotërimit dhe stili autoritativ e ai neglizhues i tyre lidhej me orientimin drejt performancës. Ndërsa përfshirja e prindërve kishte lidhje me orientimin e zotërimit për gjithë studentët.

Stili autoritativ tregon për prezantim konstant të efektit pozitiv në performancën akademike, sepse rezultatet kanë qenë të tilla edhe për studentet e kolegjit (Turner, Chandler & Heffer, 2009).

Gjetje të ngjashme në korrelacionin mes prindërve dhe performancës akademike të fëmijëve të tyre e kanë prezantuar edhe (Kordi & Baharudin, 2010; Gota, 2012; Love & Tomas, 2014).

Prindërit autoritativ kanë karakteristikat të tilla si përgjegjshmëria dhe kërkesat. Ata paraqiten superiorë në parashikimin e performancave të larta akademike (Reitman, Rhode, Hupp & Altobello, 2002).

Fëmijëria e vonë dhe adoleshenca janë periudha të ndjeshme zhvillimi, gjatë të cilave shfaqen ndryshime të shumta në jetën emocionale dhe sociale të fëmijëve. Rol të veçantë në ndryshimet e tilla luajnë si bashkëmoshatarët ashtu dhe familja. Mjaft delikat në këtë proces marrëdhëniesh është ndërveprimi me prindërit e tyre dhe me strategjitë që ata përdorin për rritjen e fëmijëve.

Stili autoritativ i prindërimit prodhon një numër pozitiv të përfundimeve pozitive të adoleshentët dhe vihet re korrelacioni mes këtij stili të prindërimit dhe mirëqenies psikologjike (Gupta & Mehtani, 2015). Krahasimet ndërmjet stileve të ndryshme të prindërimit dhe përfundimeve që sjellin ato janë më se të nevojshme për kuptimin e efekteve të tyre dhe çfarë i dallon njërin nga tjetri.

Driscoll, Russell dhe Crockett (2008), kanë konstatuar se fëmijët e nënave neglizhuese kanë nivel të lartë vetëvlerësimi, por edhe delikvence e probleme me alkoolin. Niveli më i lartë rezultoi në mesin e gjeneratës së dytë, ndërsa gjenerata e tretë e fëmijëve të nënave tolerante kishte nivel të lartë të depresionit, krahasuar me gjenerata e dytë. Nga ana tjetër, fëmijët e nënave autoritative kishin nivel më të ulët të depresionit, të delikuencës dhe më pak probleme me alkoolin gjithashtu, më i ulët është tek ata niveli i rrjedhëve të dëmshme përgjatë gjeneratave.

Fëmijët e prindërve autoritativ kanë nivel të ulët të vetëvlerësimit dhe nivel të lartë të depresionit, pa ndonjë dallim mes brezave.

Steinberg, Lamborn, Darling, Mounts dhe Dornbusch (1994), me raportet e ndryshme hulumtuese tregojnë se kemi relacion ndërmjet stileve të prindërimit dhe përshtatjes së adoleshenteve. Në mënyrë të qartë rezultojnë avantazhet e mëdha të adoleshenteve që kanë prindër autoritativ, disavantazhe të qarta për bashkëmoshatarët e neglizhuar dhe rezultate të përziera të adoleshentët me prindër shtëpiakë autoritativ dhe tolerante.

Sipas këtyre hulumtuesve, adoleshentët e familjeve autoritative kanë avantazh nga të rinjtë e tjerë në matjet e kompetencave psikologjike, internalizimin e ankthit, performancën akademike dhe probleme në sjellje. Ndërsa të rinjtë me prindër autoritativ janë në disavantazh në vetëbesim, me rritje sinjifikante (të dukshme) sa i takon internalizimit të ankthit, në një periudhë prej një viti. Gjithashtu, kemi rezultate mikse nga stilet e tjera të prindërimit në domenet e lartpërmendura (Steinberg et al., 1994).

Fëmijët dhe në veçanti adoleshentët e rritur në familje me prindër autoritativ janë të prirur të kenë një theks të veçantë në arritjen e kompetencave psikologjike dhe kanë më pak probleme psikologjike apo sjellje. Duke qenë se kompetencat psikologjike janë të lidhura ngushtë me arritjen e aftësive të vecanta të cilat sigurojnë arritjen e vetaktualizimit. Ndërsa adoleshentët e rritur në familje autoritative janë të prirur të kenë vetëbesim të ulët për shkak të dominimit prindëror. Në familjet të cilat prindërit janë tolerante mund të kemi fëmijë me sens të fuqishëm vetëbesimi dhe frekuencë të lartë të abuzimit me substanca dhe mospërshtatje në shkollë dhe angazhim të paktë në të.

Periudhë e ndryshme e zhvillimit të njeriut është adoleshenca, ku shfaqen ndryshime të rëndësishme në jetë, ndaj ndërveprimet e të tjerëve janë esenciale për zhvillimin e tij. Prindërit si figura qendrore në jetën e fëmijëve, duhet të përdorin larmi metodash të cilat sjellin përfundime të ndryshme.

Pychyle, Coplan dhe Reid (2002), raportuan se kishte ndërveprim sinjifikant ndërmjet stilit të prindërimit dhe gjinisë dhe sa shohim veten të vlefshëm adoleshentët. Për të kuptuar efektet afatgjata të stileve të prindërimit, Rothrauff et al. (2009), realizuan hulumtimin me të rriturit, të cilët rikujtuan mënyrën e rritjes nga prindërit e tyre. Sipas raportimit të tyre, ata që rikujtuan prindërit më autoritativ, krahasuar me ata që ishin autoritarianë dhe neglizhues, treguan mirëqenie më të madhe psikologjike dhe me pak simptoma depresive dhe ata që kishin prindër jo të papërfshirë në edukimin dhe mirëvajtjen e fëmijëve treguan më shumë abuzime me substanca.

Nuk është gjetur dallim ndërmjet stilit autoritativ të prindërimit dhe atij tolerant të rikujtuar. Sipas tyre, janë gjetur dallime gjinore dhe raciale. Stili prindërimit autoritativ, krahasuar me atë neglizhues, ishte më i fuqishëm lidhur me mirëqenien psikologjike të meshkujve se sa të femrat dhe stili autoritarian, krahasuar me atë autoritativ, predikonte reduktimin e simptomave më shumë për të bardhët se sa për ata me ngjyrë.

Karakteristikat e prindërve si pranueshmëria- përfshirja dhe autonomia psikologjike të raportuara nga studentët ishte e predikues sinjifikant pozitiv i vetëvlerësimit tek ata. Analizat kanë treguar se efekti ishte më i madh për vajzat se sa për djemtë (Zakeri & Karimpour, 2011).

Ndërsa krahasimi ndërmjet nënave dhe baballarëve që kanë stile të ndryshme kanë treguar përfundime të ndryshme. Është raportuar se fëmijët e nënave autoritative kanë nivel të lartë të vetëvlerësimit, të kënaqësisë në jetë dhe nivel të ulët të depresionit, ndërsa stili i

prindërimin të baballarëve ishte i lidhur me përshtatshmërinë psikologjike, ndonëse dallimet me stile të tjera të prindërimin ishin më evidente të nënat se sa te baballarët, përveç se në nivelin e depresionit.

Ndërsa rezultate të kundërta kanë dalë për adoleshentët spanjollë. Ata me prindër tolerantë rezultuan përfundime më të mira se ata me prindër autoritativ. Adoleshentët me prindër tolerantë kishin nivel më të lartë të vetëvlerësimit, ndërsa ata me prindër autoritativ dolën me rezultate më të këqija (Martinez & Garcia, 2007).

Hulumtime të ndryshme kanë raportuar korrelacion mes stileve të prindërimin dhe vetëvlerësimit të fëmijët e tyre.

Praktikat e prindërimin janë operacionalizuar dhe matur me dimensione të ndryshme të jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve që kanë treguar variacione të ndryshme të ndikimit të këta individë dhe përfundime që dallojnë pavarësisht nga metodat e ndryshme që një gjeneratë përdor për rritjen e një gjenerate të re.

Prindërit që përdornin metoda apo stile më negative ose të ashpra kishin një korrelacion të lartë me kualitetin e ulët të gjumit, disponim negativ, rritjen e pagjumësisë ditore dhe të simptomave të depresionit dhe të ankthit. Gjithashtu adoleshentët raportuan nivel të ulët pozitiv të prindërimin dhe nivel të lartë negativ të prindërimin (Brand, Hatzinger, Beck & Holsboer-Trachsler, 2009).

Stilet e prindërimin janë gjetur të jenë parashikues të rëndësishëm për fëmijët e tyre që të përjetojnë lumturinë, të kenë më shumë shresë për jetë, të jenë vetkritik si dhe mënyrën e përdorimit të ushqimit të shëndetshëm dhe përdorimit të alkolit dhe drogave. Gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm në aftësinë njohëse për botën dhe veten e tyre.

Pavarësisht nga niveli i edukimit të prindërve dhe i strategjive të tyre janë parë efekte edhe në arritjet akademike të tyre, ku kontrolli psikologjik dhe i sjelljeve ishte lidhur me arritjet akademike të studenteve (Brown & Iyengar, 2008)

2.10. Ndërlidhja mes stileve të prindërimit dhe tipareve të inteligjencës emocionale

Format e ndryshme të kontrollit dhe të përgjegjshmërisë së prindërve në drejtim të pasardhësve të tyre kanë sjellë krijimin e katër stileve të prindërimit, ku secili prej tyre dallon nga niveli i ngrohtësisë dhe i kërkesave që ata u drejtojnë atyre, duke afruar një larmi efektesh që prekin dy skajet si në aspektin pozitiv- një mirëqenie të brendshme psikologjike dhe në skajin tjetër negativ -probleme në sjellje dhe emocione.

Stilet e prindërimit janë parashikues të rëndësishëm për skemat e hershme jo të përshtatshme që krijohen përgjatë zhvillimit të individit. Duke qenë se individi bashkëvepron në mënyrë konsistente me prindërit, stili i tyre i prindërimit do të influencojë në krijimin e koncepteve themelore mbi jetën, koncepte këto që formojnë skemat njohëse, veçanërisht ato të lidhura me praktikatat e prindërimit dhe strategjive përballuese. Efektet e ngjashme me stilet e prindërimit kanë treguar edhe tiparet e inteligjencës emocionale, ku niveli i lartë i tyre predikon përfundime pozitive si për adoleshentët ashtu dhe për fëmijët, ndërsa niveli i ulët i tyre predikon ose lidhet me përfundime negative në shumë dimensionë të jetës së individit.

Por në rrafshin shkencor është kushtuar një vëmendje e vogël në ndërlidhjen mes këtyre dy fenomeneve dhe përfundimet që mund të sjellin ato, prandaj edhe qëllimi i këtij hulumtimi është që të shikojë lidhshmërinë mes tipareve të inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, nga do të shihet nëse stilet e prindërimit që ofrojnë kontroll dhe ngrohtësi të ndryshëm të kenë lidhje me nivele të ndryshme të tipareve të inteligjencës emocionale.

Ky hulumtim do të realizohet në zona të dy vende të ndryshme si në Shqipëri dhe në Kosovë, nga do të bëhet krahasimi ndërmjet tyre dhe se është ndër hulumtimet e para që realizohet për këtë qëllim.

Sipas Nazanin-it (2011), prindërimi është bazuar në kombinimin e njohurive dhe eksperiencën e inteligjencës emocionale me empati, urtësi, vëmendje dhe vetudhëheqës, prandaj këto aftësi janë të rëndësishme në tejkalimin e sfidave të ndryshme dhe në procesin e edukimit të gjeneratës së ardhshme.

Aminabadi, Pourkazemi, Babapour dhe Oskouei (2012), kanë gjetur një korrelacion pozitiv ndërmjet inteligjencës emocionale dhe stilit autoritativ të nënave, që tregon se nënat autoritative kishin një nivel më të lartë të inteligjencës emocionale.

Inteligjenca emocionale e nënës ndikon në mënyrat si ajo ushqen dhe ndërvepron me fëmijët. Pra, shkalla e lartë inteligjencës emocionale ndihmon për të mbajtur nivel të qartësisë dhe i lejon prindërit t'u përgjigjen sjelljeve të fëmijëve në mënyrë të tillë që më tepër t'i inkurajojnë, se sa t'i dekurajojnë ata (Aminabadi et al., 2012).

Prindërit që ushtrojnë stile të ndryshme të prindërimit dallojnë në nivelet e komunikimit dhe të shprehjes të ndjenjave dhe të emocioneve të tyre ndaj fëmijëve të tyre. Gjithashtu ata kanë nivele të ndryshme në kuptimin e emocioneve të fëmijëve të tyre dhe të gjendje në të cilën gjenden ata.

Shprehja e emocioneve të prindërve brenda familjes dhe e stilit të prindërimit të tyre, rezultojnë të lidhur me stilin autoritativ të prindërimit dhe të shprehjes së emocioneve të tyre të cilat japin rezultate të ndryshme në edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve të tyre.

Sipas studimeve shprehja e emocioneve dhe stilet e prindërimit janë të ndërlidhura edhe me konstrukte të ndryshme të mirërritjes së fëmijëve. Interpretimi i sinjaleve emocionale të fëmijëve dhe të qenurit të ndjeshëm ndaj emocioneve dhe ndjenjave të tyre paraqet një rëndësi të veçantë për mirëqenien e tyre. Paaftësia për të deshifruar emocionet e njerëzve të tjerë është tregues i një inteligjence të ulët emocionale. Njerëzit rrallë i shprehin emocionet e tyre verbalisht, më lehtë e kanë t'i shprehin ato në mënyrë joverbale, nëpërmjet gjesteve, mimikës, veprimeve. Aftësia për të lexuar emocionet dhe ndjenjat e të tjerëve është dhe çelësi i marrëdhënieve të suksesshme

Përqëndrimi profesionistëve të fushës së psikologjisë në trajnimet e inteligjencës emocionale do të ndihmonte prindërit të përmirësojnë stilin e tyre të prindërimit dhe do të zvogëlojnë rrezikun e fëmijëve për sjellje agresive apo probleme të tjera emocionale. Kur prindërit ndikojnë në inteligjencën emocionale të fëmijëve të tyre, i mësojnë ata si të njohin ndjenjat e tyre, të kuptojnë nga vijnë dhe si t'i përballojnë ato ndjenja, duke ju mësuar aftësitë thelbësore për të patur sukses në jetë. Studimet kanë treguar se Inteligjenca Emocionale parashikon mbi 54% të variacionit në sukses (marrëdhënie, efektshmëri, shëndet, cilësi jete). Të dhëna shtesë konkludojnë se të rinjtë me inteligjencë emocionale më të lartë marrin nota më të mira, dhe bëjnë zgjedhje më të shëndetshme në jetë.

Tiparet e inteligjencës emocionale përcaktojnë natyrën e marrëdhënies pasi janë të lidhura ngushtë me rregullimin emocional dhe në mënyrë të pashmangshme janë kontribuesi kryesor mbi mirëqenien emocionale të vetë individit, por dhe të raporteve me të tjerët që janë në kontakt me ata. Një studim i Rubin, Cheah dhe Fox, (2001) ka treguar se sjellja e fëmijës ishte e parashikuar nga rregullimi emocional jo i mirë i nënës, si dhe nga mungesa e udhëzimeve të saj dhe kontrollit gjatë detyrave të ndryshme që duhej të bënte fëmija. Prindërit të cilët kanë temperament të vështirë e kanë të vështirë të kuptojnë nevojat emocionale të fëmijut dhe në anën

tjetër janë mjaft të preokupuar me efektet e temperamentit të tyre të vështirë. Kjo përballje i bën këta prindër të paaftë të ndihmojnë fëmijët e tyre për të rregulluar sjelljen e tyre. Gjithashtu fëmijët e këtyre prindërve pasi nuk kanë një model të mirë të komunikimit me prindërit janë në rrezik për probleme me bashkemoshatarë.

Stili i prindërimit është i rëndësishëm për të ndikuar në pavarësinë dhe në angazhimin e fëmijëve. Prindërit të cilët i shohin fëmijët e tyre si të pafuqishëm apo të frikësuar, forcojnë kontrollin për ta, duke anashkaluar ballafaqimin e tyre me rrezikun dhe duke krijuar një mjedis mbrojtës për ta. Ky mjedis, i krijuar për shkak të mosrregullimit të mirë emocional të prindërve, ndikon që të fëmijët e tyre të mbesin të varur e të mos angazhohen si moshatarët.

Prindërit të cilët janë shumë kontrollues mund të shkaktojnë probleme në vetërregullimin e sjelljeve të fëmijëve të tyre. Nënata të cilat shquhen për dëshirë të kontrollojnë jetën e fëmijes apo të japin sa më shumë udhëzime apo marrin vendime për ta, mund të influencojnë në personalitetin e fëmijes duke i lënë të kuptojnë që të jesh i pavarur apo të marrësh vendime nuk është në fuqinë e fëmijes. Këta fëmijë kanë tendencë të jenë të varur dhe të turpshëm. Mungesa e ngrohtësisë apo e kuptimit dhe e rregullimit të emocioneve nga nënat, ndikojnë në krijimin e strategjive jo efektive në rritjen e fëmijëve të tyre, duke sjellë përfundime të padëshiruara për ta.

Alegre (2011), ka raportuar se katër faktorë kryesore të prindërimit janë identifikuar që janë relevante me studimet e inteligjencës emocionale siç janë përgjegjshmëria, kërkesat pozitive, ato negative dhe trajnimet e prindërve lidhur me emocionet. Përgjegjshmëria e prindërve, kërkesat pozitive dhe trajnimet e tyre lidhur me emocionet ishin të kapura me nivelin e lartë të inteligjencës emocionale të fëmijëve, ndërsa kërkesat negative të prindërve - me nivelin e inteligjencës emocionale të fëmijëve.

Formësimi i një individi si prind bazuar në inteligjencën emocionale lidhet me faktin se si një individ është në gjendje të përdore, empatinë, motivimin emocional, kontrollimin emocional, vetdijësimin emocional si dhe mënyrën e shprehjes emocionale për të ndërtuar stilin e tij prindëror. Duke qenë se inteligjenca emocionale lidhet dhe me aftësinë se si një individ ballafaqohet me stresin, ajo duke influencuar stilin e prindërimit do të krijoj tek individi mekanizma të shëndosh ose jo që të ballafaqohet me problemet të cilat shfaqen gjatë rritjes së fëmijes. Kështu që sa më fleksibël të jetë prindi aq më e lehtë është për fëmijen që të krijoj vlera shoqërore të cilat do të influencojë qëndrimet sociale të këtij të fundit. Mungesa e fleksibilitetit të prindërit në strategjitë e tyre për rritjen e fëmijëve shoqërohet me fleksibilitet të ulët psikologjik të fëmijëve. Ata prindër që ishin më pak fleksibël aplikonin më shumë kontroll në drejtim të fëmijëve të tyre, ndërsa prindërit me shumë fleksibilitet janë më të ngrohtë dhe përgjegjshëm ndaj nevojave të fëmijëve. Stili i prindërimit autoritativ së bashku me shprehjen dhe komunikimin e emocioneve do të duhet të kenë rezultate pozitive në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Vajzat adoleshente në familje të rimartuara perceptuan (i kuptuan) prindërit si më shumë mbështetës dhe si rrjedhojë, raportuan më shumë shqetësimin e empatisë. Kjo lidhje ishte ndërmjetësuar nga kontrolli psikologjik i prindërve.

Empatia e prindërve është e lidhur me kontrollin dhe ngrohtësinë e prindërve dhe me inkurajimin që i japin fëmijëve të tyre për të shprehur sa më hapur emocionet. Kur prindërit janë empatik fëmijët mësojnë se si të kuptojnë emocionet e tyre por në të njëjtën kohë kanë një sens të balancuar të njohjes së drejtë të emocioneve të tjerëve. Studime kanë gjetur se nënat autoritative shfaqin qëndrime empatike më pak të shprehura kur fëmijët e tyre shfaqin sjelljeve

më pak të dëshirueshme nga ana e tyre dhe gjithashtu janë të prirura të shprehin më shumë nervozizëm në rrethana të ndryshme të mirërritjes së fëmijëve të tyre

Stili neglizhues dhe stili autoritariane jo rrallë janë lidhur me sjelljet antisocioale përgjatë zhvillimit të individit dhe është parë të ketë një influencë të jashtzakonshme në aftësinë e tyre për të zhvilluar empatinë. Empatia është aftësia jonë për të njohur dhe kuptuar emocionet dhe ndjenjat e të tjerëve. Ajo është një formë e vetëvetëdijës; sa më mirë t'i njohim emocionet tona, aq më lehtë do t'i kuptojmë ndjenjat e të tjerëve

Si përfundim nga kuptimi i cilësive dhe i tipareve të ndryshme që janë pjesë përbërëse e stileve të ndryshme të prindërimit, të cilat shquhen nga të qenit i ngrohtë me fëmijën në situata të ndryshme apo e kundërta e kësaj, të qenit i ftohtë ndaj nevojave psikologjike apo sociale, tregon se këta prindër dallojnë në nivelin e empatisë dhe të shprehjes së emocioneve të tyre.

Po ashtu niveli i empatisë dhe i shprehjes së emocioneve janë të ndërlidhura me aftësinë e prindërve për të identifikuar ndjenjat e fëmijëve të tyre. Cuzzocrea, Barberis, Cost dhe Larcana (2015), treguan se alexithermia (analfabetizmi emotiv) ishte parashikues (pohues) pozitiv i stilit autoritarian dhe neglizhues i prindërimit dhe predikues negativ i stilit autoritarian të prindërimit.

Prindërit tregojnë nivele të ndryshme të kontrollit duke qenë fleksibël në kërkesat, në modifikimin dhe në ndryshimin e tyre që të jenë të kapshme dhe të përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe adoleshentëve, si në jetën familjare dhe atë sociale; duke treguar vetëmotivim më të lartë në zhvillimin e strategjive më adaptuese në rritjen e fëmijëve të tyre, si dhe prindër që zhvillojnë stil për më shumë kontroll në situata të ndryshme, por pa treguar fleksibilitet për nevojat e fëmijëve të tyre.

KAPITULLI III

Metodologjia

3.1.Qëllimi:

Ky studim ka për qëllim vlerësimin (njohjen) e inteligjencës emocionale dhe identifikimin e marrëdhënies mes inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit në një kampion me popullsi shqiptare rajonin Fierit në Shqipëri e Prishtinës në Kosovë.

Duke qenë se individit bashkëvepron në mënyrë konsistente me prindërit, stili i tyre i prindërimit do të influencojë në krijimin e koncepteve themelore mbi jetën, koncepte këto që formojnë skemat njohëse, strategjitë përballuese të situatave në të ardhmen si dhe në inteligjencë emocionale ku rol luan dhe faktori gjentik. Efekte të ngjashme me stilet e prindërimit kanë treguar edhe tiparet e inteligjencës emocionale, ku niveli i lartë i tyre predikon përfundime pozitive për individin për adoleshentët ashtu dhe për fëmijët, ndërsa niveli i ulët i tyre predikon ose lidhet me përfundime negative në shumë dimensione të jetës së individit. Për këtë ndërkohë po bëhen shumë studime për të kuptuar se cilat specifika të stilit prindëror rrisin nivelin e inteligjencës emocionale. Prandaj dhe qëllimi i këtij studimi është të njohet (mase) nivelin e inteligjencës emocionale në këto 2 vende (me popullsi Shqiptare) të raportuar nga vetë pjesëmarrësit, duke e parë dhe ndikimin që mund të ketë stili i prindërimit të prindërve të tyre mbi ta. Por në rrafshin shkencor është kushtuar një vëmendje e vogël në ndërlidhjen mes këtyre dy fenomeneve dhe përfundimet që mund të sjellin ato, prandaj edhe qëllimi i këtij hulumtimi është që të shikojë lidhshmërinë mes tipareve të inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, nga do të shihet nëse stilet e prindërimit që ofrojnë kontroll dhe ngrohtësi të ndryshëm të kenë lidhje me nivele të ndryshme të tipareve të inteligjencës emocionale tek pjesëmarrësit.

Është argumentuar gjerësisht se stili prindëror luan rol në krijimin e inteligjencës emocionale te individit gjatë periudhës së fëmijërisë edhe faktori gjenetik luan rol,

3.2.Objektivat e studimit

Matja e inteligjencës emocionale për popullatën Shqiptare në Fier dhe Prishtine.

Të identifikojë lidhshmërinë mes inteligjencës emocionale dhe stilit të prindërimit në Fier.

Të identifikojë lidhshmërinë mes inteligjencës emocionale dhe stilit të prindërimit në Prishtine .

Të identifikojë dallimet e raportimit te inteligjencës emocionale dhe të stilit të prindërimit me ndryshimet demografike në zonen e Fierit (Shqipëri)

Të identifikojë dallimet e raportimit te inteligjencës emocionale dhe të stilit të prindërimit me ndryshimet demografike në zonen e Prishtines (Kosovë).

Pyetja kërkimore

1.Cili është ndikimi i inteligjencës emocionale në stilin prindëror ?

2. A ka dallime mes raportit të inteligjences emocionale me stilin e prindërimit në Fier dhe Prishtine?

3.Si ndikon mbi raportin e inteligjences emocionale ne Fier e Prishtine niveli i i arsimimit te prinderve?

4.Si ndikojne dallimet gjinore e te moshes ne raportin e inteligjences emocionale ?

3.3.Hipoteza e studimit

H1. Stili prindëror është i përcaktuar nga dimensionet e inteligjencës emocionale.

H2. Ekziston lidhje e rëndësishme mes inteligjencës emocionale dhe stileve prindërore

H3. Nuk ka dallime të rëndësishme në raportimin e inteligjencës emocionale midis Fierit (Shqipëri) dhe Prishtinës (Kosovë) në lidhje me nivelin e arsimimit të prindërve.

H4. Ekzistojnë dallime gjinore dhe të moshës në raportimin e inteligjencës emocionale.

3.4. Procedurat

Ky studim i karakterit kuantitativ ka pasur qëllim të hulumtojë lidhshmërinë e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit në Fier Shqipëri dhe Prishtinë Kosovë.

Ky është një studim kros seksional dhe kampioni është zgjedhur me metodën jo rastësore të topit të borës (çdo individ ka ftuar një individ tjetër për pjesëmarrje).

Fillimisht është punuar në përkthimin e pyetësorëve në gjuhën shqipe. Instrumenti i përdorur është Pyetësi i inteligjencës emocionale është përkthyer dhe më pas është përshtatur në Shqipëri përmes një testimi pilot. Pyetësi është përkthyer në shqip nga një prof. i gjuhës Angleze dhe më pas, është gjykuar nga këshilli i standartizimit të pyetësorëve, i cili përbëhet nga pesë anëtarë (psikiatër, psikolog, gjuhëtar, përkthyes dhe një person laik që e njeh gjuhën

angleze). Pyetësi ka marrë formën përfundimtare pasi është testuar në një grup prej 20 personash për kuptueshmërinë e tij. Ky pyetësor ka treguar një besueshmëri shumë të lartë (Koeficienti Alpha i Cronbach $\alpha = .91$) Ky pyetësor (Trait Emotional Intelligence Questionnaire, TEIQ) Petrides (2009) <http://www.eiconsortium.org/measures/measurers.html>

TEIQ është pyetësor i standartizuar nga departamenti i Psikologjisë në Prishtinë Prof. Mimoza Shahini

Mbledhja e të dhënave.

Mbasi është marrë pëlqimi nga pjesëmarrësit, të cilët për shkak të moshës së tyre kanë dhënë pëlqim gojor, dy ekipet në Fier dhe në Prishtinë kanë shpërndarë pyetësorët, të cilët janë mbledhur pasi u plotësuan dhe iu dorëzuan hulumtueses kryesore.

3.5. Pjesëmarrësit (Kampioni)

Kampioni i këtij studimi është i përbërë nga të rritur pjesëmarrës nga Shqipëria Fieri (K_F) 42.9% (N = 203) (prefektura përfshin Fier, Patos, Roskovec, Mallakaster, Lushnje, Divjake) dhe Kosova Prishtina (K_P) 57.1% (N = 270). (rajonit përfshin Prishtinë, Lipjani, Fushe Kosova, Gracanica, Besiana, Drenasi, Artana, Kastrioti) Në këtë studim janë përfshirë 473 pjesëmarrës nga ku 38.5% (N = 182) kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 61.5% (N = 291) të gjinisë femërore. Duke përdorur testin e hi katrorit është gjetur dallim i rëndësishëm në raportimin e shpërndarjes së gjinisë $\chi^2 = 25.11$, $p < .001$.

Tabela 1

Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve për kampionin e Fierit dhe Prishtinës

	N	%	% valide	% kulative
Prishtine	270	57.1	57.1	57.1
Fier	203	42.9	42.9	100.0
Total	473	100.0	100.0	

Mosha mesatare e raportuar për kampionin e përgjithshëm ka qenë $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$), ndërsa për kampionin e Fierit $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$) dhe atë të Prishtinës $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$)

Nga të gjithë pjesëmarrësit kemi 26.6% ($N = 126$) që jetonin në fshat, 30.4% ($N = 144$) që jetonin në qytet dhe 42.9% ($n = 203$) që jetonin në qytezë të vogël ($\chi^2 = 20.57, p < .001$).

Mesatarja e viteve të shkollimit për të gjithë kampionin ka qenë $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$), ndërsa për kampionet veç e veç Fieri $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$) dhe Prishtina $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$). Dallimi ka qenë i rëndësishëm $\chi^2 = 9.49, p < .001$

Të ardhurat mesatare për totalin e kampionit ka qenë $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$) dhe për Fieri $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$) ndërsa Prishtine $M = 35.19$ vjeç ($SD = 13.92$)

Në kampionin e përgjithshëm 77.6% e pjesëmarrësve kanë qenë të besimit mysliman, 5.5% të besimit katolik dhe 16.9% të besimit ortodoks ($\chi^2 = 426.14, p < .001$).

Ndërkohë pjesëmarrësit kanë ofruar (dhene)dhe nje te dhene tjeter : se më cilën dorë shkruanin, dhe 96.4%(N = 456) e pjesëmarrësve kanë raportuar të përdorin dorën e djathtë, 2.6% (N = 12) të përdornin dorën e majtë. Pesë pjesëmarrës nuk e kanë paraqitur këtë të dhënë ($\chi^2 = 421.23$, $p < .001$). Nga kampioni i përgjithshëm 3 persona nga Shqipëria shkruanin me dorën e majtë dhe 9 nga Kosova.

3.6. Instrumentet

Pyetëtori demografik është ndërtuar në bashkëpunim me ekipin hulumtues në Shqipëri dhe Kosovë. Në të janë përfshirë mosha, gjinia, vendbanimi, të ardhurat në familje, besimi fetar si dhe me cilën dorë shkruanin pjesëmarrësit.

Pyetëtori i inteligjencës emocionale (Petrides, 2009) është realizuar përmes mesatares aritmetike dhe devijimit standard. Pikët e alfes (Cronbach alpha) janë përmbledhur në tabelën 2.

Të dhënat përshkruese të përbërësve të shkallës totale të inteligjencës emocionale ka qenë në vlera të larta duke na treguar që mund të përdoret me konfidencë për këtë studim

Tabela 2.

Koeficientet e besueshmërisë alfa për 15 nënshkallët dhe 4 faktorët kryesorë të TEIQ, përfshirë edhe totalin.

TEIQ/ shkallët	Kampioni i përgjithshëm	Kampioni Fier	Kampioni Prishtine
Vet besimi	0.58	0.58	0.59
Shprehja emocionale	0.68	0.76	0.69

Motivimi	0.51	0.53	0.52
Rregullimi emocional	0.61	0.65	0.66
Lumturia	0.77	0.79	0.77
Empatia	0.56	0.54	0.59
Vetëdijesimi social	0.68	0.69	0.68
Kontrolli i impulseve	0.44	0.64	0.50
Perceptimi emocional	0.52	0.63	0.53
Menaxhimi i stresit	0.51	0.55	0.52
Menaxhimi i emocioneve	0.48	0.47	0.49
Optimizmi	0.60	0.60	0.59
Marrëdhënia	0.64	0.68	0.63
Përshatshmëria	0.36	0.39	0.37
Vendosmëria	0.54	0.38	0.53
Mirëqenia emocionale	0.79	0.70	0.80
Vet kontrolli	0.61	0.60	0.64
Emocionaliteti	0.73	0.73	0.73
Shoqërizimi	0.74	0.58	0.73
Totali	0.90	0.89	0.90

Dallimi i alfave në mes Prishtines dhe Fierit kanë qenë të parëndësishme në aspektin statistikor ($p = 0.49$)

Në tabelën 3 janë përshkruar nënshkallët dhe faktorët e TEIQ si dhe totalin e inteligjencës emocionale.

Tabela 3.

Përshkrimi i shkallëve të tipareve të inteligjencës emocionale.

Mirëqenia	Tipare të optimizmit	Konfident dhe shikon anën e lumtur të jetës
	Tipare të lumturisë	Të këndshëm dhe të kënaqur me jetën
	Vetëbesimi	E suksesshëm dhe kanë besim në veten e tyre
Shoqërizimi	Menaxhimi i emocioneve	Janë në gjendje të influencojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë.
	Vendosmëria	Të hapur dhe të drejtpërdrejt dhe luftojnë për të drejtat e tyre,
	Vetëdijesimi social	Arrijnë të krijojnë rreth shoqëror përmes aftësive të tyre sociale.
Emocionaliteti	Tipare empatike	Janë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit.
	Perceptimi emocional	Të qartë rreth ndjenjave për veten dhe të tjerët.
	Shprehja emocionale	Janë në gjendje të shprehin ndjenjat e tyre tek të tjerët.
	Marrëdhënia	Të aftë të përmbushin marrëdhëniet e tyre personale.
Vetë kontrolli	Rregullimi emocional	Të aftë të kontrollojnë emocionet e tyre.
	Impulsiviteti (ulët)	Janë reflektivë në vend që të udhëhiqen nga impulset e tyre.
	Menaxhimi i stresit	Janë në gjendje të rezistojnë presionit dhe stresit

Faktorë shtësë	Vet motivimi	Nuk jepen përballë vështirësive, por janë këmbëngulës për të arritur atë që duan.
	Përshtatshmëria	Të aftë ti përshtaten situatave të reja.

Të dhënat psikometrike të pyetësorit mbi tiparet e inteligjencës emocionale janë vërtetuar në disa studime të kryera në vende të ndryshme, në Itali, Gjermani, Serbi, Francë, Gjeorgji dhe në Angli.

3-Pyetëtori mbi autoritetin prindëror (PAQ) është treguar për të matur autoritetin prindëror, ose praktikat disiplinore nga pikëpamja e fëmijës (të çdo moshe) <https://dtreboux.file.wordpress.com/2013/06/parental-authority-questionnaire-2.docxte>. PAQ është pyetësor i standartizuar nga departamenti i Psikologjis në Prishtinë prof. Mytaher Haskuka. Në këtë hulumtim janë pyetur pjesëmarrësit të rritur mbi stilet e prindërimit të prindërve të tyre. Gjatë plotësimit të pyetësorit ata i janë referuar eksperiencave të tyre me prindërit në retrospektivë.

PAQ ka tre nënshkallë:

Prindi tolerant (kompozohet nga pyetjet 1, 6, 10, 13, 14, 17, 19, 21, 24 dhe 28), prindi autoritativ (kërkues dhe i përgjegjshëm, kompozohet nga pyetjet 2, 3, 7, 9, 12, 16, 18, 25, 26 dhe 29), prindi autoritarian (kërkues, por jo përgjegjës, kompozohet nga pyetjet 4, 5, 8, 11, 15, 20, 22, 23, 27, dhe 30).

Ky stil i prindërimit i referohet të dy prindërve. Vlerësimi bëhet nga 1 deri në 5. Pikët maksimale tregojnë më shumë stil prindërimi në atë nënshkallë. Vlerësimi i PAQ bëhet duke mbledhur pikët individuale që ndërtojnë rezultatet e tre nënshkallëve.

Rezultatet në çdo nënshkallë variojnë nga 10 deri në 50. Konsistenca e brendshme e pyetësorëve është përcaktuar përmes koeficientit Cornbach. Koeficienti alfa për pyetësorin versioni për nënën ($\alpha = .71$) ndërsa për versionin e babait ($\alpha = .70$)

3.7. Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar me paketën statistikore për shkencë sociale për windows (SPSS) version 21.

Analiza deskriptive është përdorur për të përshkruar variablat përmes mesatares aritmetike (M) dhe devijimin standard (SD). Koeficienti i besueshmërisë Alfa e Cronbach është përdorur për të vlerësuar konsistencën e brendshme të pyetësorëve. Sa më afër vlerës 1 të jetë ky koeficient aq më e lartë është besueshmëria e pyetësorit.

Mesataret janë nxjerrë duke bërë mbledhjen e shumës së pyetjeve dhe janë pjesëtuar për numrin e pyetjeve.

Për të eksploruar lidhshmëritë e mundshme në mes inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit është përdorur testi i korrelacionit të Pearsonit. Lidhshmëria në mes variablave kategorike është përcaktuar përmes korrelacionit Spearman. Kjo analizë është parë e lidhur ngushtë me hipotezat e këtij studimi.

Vlen të përmendet që ky test vetëm tregon lidhshmërinë, por nuk jep shpjegime nëse variablat shkaktojnë njëra tjetrën apo jo.

Analiza e regresionit është përdorur për fuqinë e parashikimit të stileve të prindërimit mbi tiparet e inteligjencës emocionale.

Sipas Tabachnick-ut dhe Fidell-it (2001) ekzistojnë disa procedura të analizës së regresionit. Analiza e regresionit përmes procedurave të saj është në gjendje të testojë shumën e variancës së variablave të varura të ndikuara nga secila variabël e pavarur.

Në këtë studim stilet e prindërimit janë klasifikuar si variabla të varura për analizën e regresionit. Totali i inteligjencës emocionale si dhe katër faktorët e saj janë konsideruar si të pavarura. Avantazhi i kësaj procedure është se lidhshmëria në mes këtyre variablave ekspozohet, ndërsa në analiza të tjera ajo mund të jetë e maskuar apo e shtrembëruar nga variablat e tjera.

Për dallimet ndërmjet grupeve të kategorizuara është përdorur analiza e testit kur variablat kanë qenë me dy kategori si p.sh. gjinia (mashkull - femra) dhe për variablat me më shumë se një kategori është përdorur analiza e variancës ANOVA. ANOVA dykahëshe është përdorur për të eksploruar interaksionin (ndërveprimin) efekt në mes variablave të ndryshme. Për të bërë vlerësimin e saktë për dallimet në mes grupeve është përdorur analiza post hoc Tukey HSD.

Ky studim ka përdorur si kufi të dallimeve të rëndësishme në nivelin statistikor $p < .05$.

Shpërndarja e të dhënave është vërtetuar përmes skëenes dhe kurtosis. Këto të dhëna ashtu si dhe mesatarja aritmetike tregojnë se sa shumë të dhënat devijojnë nga kurba normale e shpërndarjes. Sipas Balmer-it, M.G” Principles of statistics” nëse skëenes është më e vogël se -1 apo më e madhe se +1 do të thotë që të dhënat janë të skajuara. Nëse të dhënat janë në mes - 1 dhe -1/2 apo në mes +1 dhe +1/2 themi që të dhënat janë të skajuara mesatarisht, Nëse skëenes është në mes - 1/2 dhe + 1/2 të dhënat janë proksimisht simetrike.

Kurtozi i referohet kulmit apo shtrirjes të kurbës të të dhënave. Nëse kurtozi është +2 deri në -2 të dhënat janë të shpërndara normalisht.

3.8. Çështje etike

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë përfshirë në bazë vullnetare dhe nuk ka pasur asnjë konflikt interesi nga pjesëmarrësit në raport me hulumtuesen kryesore. Të dhënat kanë qenë anonime për të respektuar privatësinë e tyre.

Gjatë këtij hulumtimi janë respektuar të gjitha kriteret e një studimi etnikisht korrekt. Pjesëmarrësit janë informuar për qëllimin dhe objektivat e studimit.

Kapitulli IV

REZULTATET

4.1.Përshkrimi i shkallëve të këtij studimi

Vlerat e paraqitura në shkallët e këtij studimi janë sipas percentilit 25, 50, 75 dhe 95. Percentilet janë përdorur për llogaritjen e shkallëve me qëllim që të ishin sa më të sakta për kulturën e të dy vendeve

Në kampionin e përgjithshëm (figura 1.) nga shkalla shumë e ulët e totalit të inteligjencës emocionale kemi 0.4% (N =2) dhe në shkallën e ulët 44.8%(N =212). Në shkallën mesatare kemi 53.5%(N =253), ndërsa në shkallën e lartë 1.3%(N =6).




Figura 1. Shpërndarja e përqindjeve për totalin e inteligjencës emocionale në kampionin e përgjithshëm.

Tabela 19, bën paraqitjen e rezultateve për të dy rajonet veç e veç sipas vlerave në reshta. Në kampionin e Fierit nuk ka pasur asnjë pjesëmarrës në shkallën shumë të ulët dhe të lartë të totalit të inteligjencës emocionale, ndërsa në shkallën e ulët kanë qenë 31.1% (N=66) vlerat e pritura për këtë shkallë kanë qenë 91 pjesëmarrës. Në shkallën e mesatare janë 54.2% (N =137) dhe vlerat e pritura për këtë shkallë janë 108.6 pjesëmarrës.

Tabela 19.

Përshkrimi i përqindjeve, i vlerave të pritura dhe numrave për totalin e TEIQ me shtetin.

		N	Kampioni	
			Prishtine	Fier
Totali I TEIQ	Shumë e ulët		2	0
	Vlerat e pritura		1.1	.9

		Kampioni	
	% brenda grupit	100.0%	.0%
E ulët	N	146	66
	Vlerat e pritura	121.0	91.0
	% brënda grupit	68.9%	31.1%
Mesatare	N	116	137
	Vlerat e pritura	144.4	108.6
	% brenda grupit	45.8%	54.2%
E lartë	N	6	0
	Vlerat e pritura	3.4	2.6
	% brënda grupit	100.0%	.0%

Në shkallën shumë të ulët të inteligjencës emocionale në Prishtinë janë raportuar 7% (N=2), ndërsa vlerat e pritura për këtë shkallë janë 1.1. Në shkallën e ulët janë raportuar 68.9% (N=146) kurse vlerat e pritura të kësaj shkalle kanë qenë (N=121), ndërsa në shkallën mesatare kanë qenë 45.8% (N=116) vlerat e pritura për këtë shkallë kanë qenë (N=144). Në shkallën e lartë janë 3.4% (N=6) dhe vlerat e pritura për këtë shkallë janë 3.4 pjesëmarrës.

Dallimi në mes vlerave të pritura dhe atyre të fituara ka qenë jo i rëndësishëm në aspektin statistikor ($p > .05$), kurse në shkallën e stilit tolerante të nënës, për kampionin e përgjithshëm janë 22.1% (N=87) në shkallën shumë të ulët dhe në shkallën e ulët janë 28% (N=110). Ndërsa në shkallën mesatare 26.7% (N=105) dhe në shkallën e lartë 23.2% (N=91). Rezultatet tregojnë se në këtë kampion një e katërta e pjesëmarrësve të kishin nën shumë tolerante.




Figura 2. Shpërndarja e përqindjeve për stilin tolerant të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Tabela 20 në shtojcë tregon se shkalla mesatare e stilit tolerante të nënës në Fier është raportuar 28.6%(N=58) e ku vlera e gjetur është 54.2. Në shkallën e ulët vlerat e pritura(56.8) janë gjetur më të ulëta se vlerat e fituara 30% (N=61). Në shkallën shumë të ulët 17.2% (N=35) vlera e pritura 44.9, ndërsa në shkallën e lartë 24.1% (N=49) dhe vlera e pritur për këtë shkallë 47. Në shkallën shumë të lartë të stilit tolerante të nënës në Prishtinë janë raportuar 22.1% (N=42) ku vlerat e pritura janë prezantuar 44, ndërsa në shkallën mesatare janë raportuar 24.7% (N=47) si dhe vlerat e pritura janë 50.8. Në shkallën e ulët kemi 25.8 (N=49) dhe vlerat e pritura kanë qenë 53.2. Shkalla shumë e ulët ka 27.4% (N=52), ndërsa vlera e pritur është gjetur 42.1. Nuk ka pasur dallime në raportimin e kësaj shkalle në mes Fierit dhe Prishtinës p > .05.

Stili autoritarian i nënës në kampionin e përgjithshëm është përfaqësuar me më shumë përqindje në shkallën e mesatare 28%(N=110) e ndjekur nga shkalla shumë e ulët 27%(N=106). Stili

autoritarian i nënës në shkallën të lartë është prezantuar 20.1%(N=79) të kampionit. Siç shikohet në figurën 3, 24.9% (N=98) kanë raportuar stil autoritarian të nënës në shkallë të ulët.




Figura 3. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritarian të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Stili autoritarian i nënës në kampionin e Fierit është raportuar në shkallën “e lartë” në 50.6 (N=40), ndërsa vlerat e pritura 40.8. Në shkallën “mesatare” bëjnë pjesë 56.4% (N=62) dhe vlera e pritur është 56.8, ndërsa shkalla “e ulët” ka raportuar pjesëmarrjen prej 42.9% (N=42), kurse vlerat e pritura 50.6. Shkallën “shumë të ulët” e kanë raportuar pjesëmarrjen 55.7% (N=59) dhe vlera e pritur ka qenë 54.8 (tabela 21, shtojcë).

Siç tregohet në tabelën 21(shtojcë) në shkallën “shumë të ulët” të stilit autoritarian të nënës në kampionin e Prishtinës, janë raportuar 44.3% (N=47) ku vlerat e pritura janë gjetur 51.2 ndërkohë që në shkallën “e ulët” bëjnë pjesë 57.1% (N=56) e pjesëmarrësve dhe vlera e pritur 47.4. Vlera e pritur në shkallën “mesatare” ishte 53.2 dhe në këtë shkallë bëjnë pjesë 43.6%

(N=48). Shkalla “e lartë” është raportuar me pjesëmarrjen 49.4% (N=39) ndërsa vlera e pritur për këtë shkallë ishte 38.2.

Në totalin e këtyre dy kampioneve (figura 4) kemi në shkallën e stilit autoritativ fleksibel të nënës në kategorinë “shumë të ulët” 29.3% (N=115), ndërsa në kategorinë “ e ulët” janë raportuar 21.6 % (N = 85) nga kampioni i përgjithshëm. Në shkallën “mesatare” janë paraqitur 24.9% (N =98) të pjesëmarrësve dhe në shkallën “e lartë “ 24.2% (N = 95).




Figura 4. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritativ të nënës në kampionin e përgjithshëm.

Në shkallën “e lartë” të stilit autoitativ (fleksibël) të nënës në Fier janë raportuar 51.6% (N=49), ndërsa vlerat e pritura për këtë shkallë janë 49.1. Në shkallën mesatare janë paraqitur 46.9% (N=46), si dhe vlerat e raportuara 50.6, ndërkaq në shkallën e ulët kanë qenë pjesë e stilit

autoritativin së nënës 36.5% (N=31), ndërsa vlera e pritur është 43.9. Vlerat e pritura janë paraqitur në shkallën shumë të ultë nga 59.4, ku pjesë e kësaj shkalle janë 67.0%. (N=77)

Në shkallën shumë të ulët të stilit autoritativ (fleksibël) së nënës në Prishtinë janë raportuar 33% (N=38), ndërsa vlerat e pritura për këtë shkallë janë 55.6. Vlerat e pritura janë raportuar në stilin autoritativ (fleksibël) të nënës 41.1 ndërkohë që 63.5% (N=54) kanë qenë pjesë e shkallës “të ulët”. Në shkallën “mesatare “ kanë raportuar 53.1% (N=52) dhe në atë “të lartë” 48.4% (N=46).

Në shkallën e stilit autoritativ (fleksibël) të nënës janë gjetur dallime të rëndësishme statistikore në mes Fierit dhe Prishtines. Dallimet sipas Hi katrorit ($\chi^2 = 19.50$, $p < .001$), siç shihet nga shpjegimi i mësipërm, vlerat e gjetura kanë qenë më të larta se vlerat e pritura në kategorinë “shumë e ulët”(77 vs 59.4) për kampionin e Fierit dhe e kundërta për kampionin e Prishtinës (38 vs 55.6).

Rezultatet tregojnë se në Fier ka pasur më shumë nëna me stil autoritativ (fleksibël) në shkallë të ulët nga ajo që është pritur dhe në Prishtinë më pak se sa është pritur.

Në totalin e shkallës të stilit tolerant të babait, për kampionin e përgjithshëm janë 27.0% (N =106) në shkallën shumë të ulët, dhe në shkallën e ulët janë raportuar 23.7% (N =93). Ndërsa në shkallën mesatare, sipas figurës5, tregohet se janë paraqitur 25.2% (N =99) dhe në shkallën e lartë 24.2% (N =95)




Figura 5. Shpërndarja e përqindjeve për stilin tolerante të babait në kampionin e përgjithshëm.

Në kampionin Fier pjesëmarrësit kanë raportuar më shumë prindër në kategorinë “ e ulët” 60.2% (N=56) ndjekur nga kategoria “e lartë” 54.7%(N=52). Në shkallën shumë “të ulët” 47.2% (N=50) kanë qenë pjesë e stilit tolerant të babait, dhe në kategorinë e “mesatare” 45.5% (N = 45). Vlerat e gjetura në këto shkallë nuk kanë ndryshuar në mënyrë të rëndësishme nga vlerat e gjetura.

Në shkallën “e lartë” të stilit tolerant të babait në Prishtine janë raportuar 45.9% (N=43), ndërsa në shkallën mesatare janë raportuar 54.5% (N=54). Në shkallën “e ulët” kemi 39.8%. (N=37) dhe në shkallën “shumë të ulët” të stilit tolerant të babait janë prezantuar 52.8% (N=56). Vlerat e pritura për këto dy kategori kanë qenë të përafërta me vlerat e gjetura. Në shkallën e stilit autoritarian të babait në kategorinë shumë “e ulët” janë 28.5% (N = 112), kurse në kategorinë e “ulët” 25.7% (N = 101). Në shkallën e “mesatare” 23.4% 9 (N = 92) dhe në kategorinë “ e lartë” 22.4% (N = 88)




Figura 6. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritarian të babait në kampionin e përgjithshëm.

Në tabelën 24 (shtojcë) janë raportuar përqindjet në rreshta të kategorive të stilit autoritarian të babait në mes Fierit dhe Prishtines. Në kampionin Fier pjesëmarrësit kanë raportuar më shumë prindër në kategorinë “ e lartë” 59.1% (N=52), e ndjekur nga kategoria “ e mesatare” 55.4% (N=51). Në shkallën shumë “të ulët” 48.2% (N=54) kanë qenë pjesë e stilit autoritarian të babait, dhe në kategorinë e “mesatare” 45.5% (N = 46). Vlerat e gjetura në këto shkallë nuk kanë ndryshuar në mënyrë të rëndësishme nga vlerat e gjetura.

Në shkallën “e lartë” të stilit tolerant të babait në Prishtine janë raportuar 40.9% (N=36), ndërsa në shkallën mesatare janë raportuar 44.6%,(N=41). Në shkallën “e ulët” kemi 54.5%. (N=55) dhe në shkallën “shumë të ulët” të stilit autoritarian të babait janë prezantuar 51.8% (N=56). Vlerat e pritura për këto dy kategori kanë qenë të përafërta me vlerat e gjetura. Nuk ka pasur dallime në shpërndarjen e vlerave midis Fierit dhe Prishtines në këtë shkallë ($p > .05$).

Në totalin e këtyre dy kampioneve (figura 7) kemi në shkallën e stilit autoritativ (fleksibel) të babait në kategorinë “shumë të ulët” 27.5% (N =108), ndërsa në kategorinë “ e ulët” janë

raportuar 22.4 % (N = 88) nga kampioni i përgjithshëm. Në shkallën “mesatare” janë paraqitur 29.2% (N =111) e pjesëmarrësve dhe në shkallën “e lartë “ 21.9% (N = 86).




Figura 7. Shpërndarja e përqindjeve për stilin autoritativ(fleksibël) të babait në kampionin e përgjithshëm.

Nuk janë gjetur dallime në raportimin e stilit autoritativ (fleksibël) të babait (figura 8) në mes kampionit Fier dhe Prishtine ($p > .05$)




Figura 8. Shpërndarja e përqindjeve për stilin fleksibël/autoritativ të babait për kampionin Fier dhe Prishtinë Shenim BP- babai fleksibël

4.2. Lidhshmëria e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit

Koeficienti i korrelacioni t, mesataret dhe devijimi standard për katër faktorëve të TEIQ dhe stileve të prindërimit janë paraqitur në tabelën 4 për totalin e kampionit.

Në përputhshmëri me hipotezën kryesore të këtij studimi, që ekziston një lidhshmëri e rëndësishme në aspektin statistikor në mes inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, siç shihet nga tabela kjo hipotezë, është vërtetuar pjesërisht, pasi lidhshmëri e rëndësishme është gjetur në mes TEIQ ($r = -.156$, $p < .001$) dhe stilit autoritarian të nënës, ku korrelacioni ka qenë negativ dhe fuqia e korrelacionit jo shumë i madh.

Rezultati tregon se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritarian të nënës. Sa më pak autoritariane nëna, aq më e lartë është inteligjenca emocionale.

Korrelacion pozitiv ($r = .265$, $p < .001$) dhe me një fuqi deri diku të moderuar është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ (fleksibël), duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ (fleksibël) të nënës dhe kjo lidhje ka qenë e rëndësishme në aspektin statistikor. Sa më autoritative fleksibël të jetë nëna aq më e lartë është shkalla e inteligjencës.

Lidhshmëri e rëndësishme është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritarian të babait. Korrelacioni ka qenë negativ dhe fuqia e korrelacionit jo shumë e madhe ($r = -.178$, $p < .001$).

Rezultati tregon se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritarian të babait. Sa më pak autoritarian babai aq më e lartë është inteligjenca emocionale.

Korrelacion pozitiv ($r = .349, p < .001$) dhe me një fuqi e moderuar është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ (fleksibël) të babait duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ (fleksibël) të babait. Sa më autoritativ fleksibël të jete babai, aq më e lartë është shkalla e inteligjencës.

Nuk është gjetur korrelacion në mes TEIQ dhe stilit tolerant të babait [$r_N = .02, p = .704; r_B = .007-.178, p = .912$]. Rezultatet tregojnë që stili tolerant i nënës dhe babait nuk kanë lidhshmëri me inteligjencën emocionale (tabela 4)

Tabela 4

Koeficienti i Korrelacionit, mesataret dhe devijimi standard për katër faktorëve të TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e përgjithshëm

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.Nëna tolerante	-									
2.Nëna autoritariane	-.019	-								
3.Nëna autoritative Fleksibël	.250**	-.159**	-							
4.Babai tolerant	.639**	.012	.252**	-						
5.Babai autoritarian	-.047	.664**	-.208**	-.049	-					
6.Babai autoritativ fleksibël	.249**	-.157**	.633**	.417**	-.195**	-				
7.Emocionaliteti	-.012	-.052	.263**	.024	-.105	.354**	-			

8.Vet kontrolli	.004	-.223**	.190**	-.062	-.159**	.233**	.644**	-		
9.Shoqërizimi	.132*	-.082	.160**	.089	-.160**	.251**	.625**	.508**	-	
10.Mirëqënia	-.046	-.200**	.271**	-.037	-.183**	.340**	.688**	.616**	.581**	-
11. Totali(TEIQ)	.023	-.156**	.265**	.007	-.178**	.349**	.890**	.807**	.791**	.857**
Mesatarja	29.24	2.92	4.03	2.95	2.85	3.96	4.91	4.58	4.75	5.18
Devijimi standard	5.39	0.61	0.63	0.66	0.66	0.68	0.66	0.62	0.65	0.75

Në kampionin e Fierit korrelacioni pozitiv dhe i shkallës së moderuar ($r = .429, p < .001$) është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ fleksibel, duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ fleksibel të nënës dhe kjo lidhje ka qenë e rëndësishme në aspektin statistikor. Sa më autoritative fleksibel të jetë nëna aq më e lartë shkalla e inteligjencës për kampionin e Fierit(tabela 5).

Tabela 5.

Koeficienti i Korrelacioni t për katër faktorët e TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e Fierit.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.Nëna tolerante	-									
2.Nëna autoritariane	-.126	-								

3.Nëna										
AutoritativeFleksibël	.451**	-.319	-							
4.Babai tolerant	.757**	-.161	.492**	-						
5.Babai autoritarian	-.323**	.664**	-.591**	-.414**	-					
6.Babai autoritativ fleksibël/	.435**	-.442**	.834**	.498**	-.651**	-				
7.Emocionaliteti	.109	.180	.348**	.061	.101	.320**	-			
8.Vetëkontrolli	.005	-.053	.270*	.007	.080	.319**	.636**	-		
9.Shoqërizimi	.084	.185	.277**	.038	.089	.262**	.607**	.439**	-	
10.Mirëqenia fleksibël	.020	-.144	.526**	.019	-.203	.508**	.667**	.536**	.582**	-
11. Totali(TEIQ)	.063	.037	.429**	.019	.016	.424**	.900**	.789**	.768**	.829**

Korrelacion pozitiv ($r = .424$, $p < .001$) dhe me një fuqi të moderuar është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ fleksibël të babait duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ fleksibël të babait. Sa më autoritativ fleksibël të jetë babai aq më e lartë është shkalla e inteligjencës

Për kampionin e Fierit dy llojet e tjera të stileve të prindërimit si për nënën dhe babain nuk kanë treguar korrelacion me shkallën e inteligjencës emocionale.

Tabela 6

Koeficienti i Korrelacioni t për katër faktorët e TEIQ dhe stileve të prindërimit për kampionin e Prishtines.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.Nëna tolerante	-									
2.Nëna autoritarians	.028	-								
3.Nëna autoritativeFleksibël/	.151*	-.068	-							
4.Babai tolerant	.587**	.086	.137	-						
5.Babai autoritarian	.059	.666**	-.014	.085	-					
6.Babai autoritativ fleksibël/	.162*	-.024	.529*	*	.382**	-.010	-			
7.Emocionaliteti	-.069	-.157*	.269*	*	.006	-.201**	.380**	-		
8.Vetëkontrolli	-.002	-.299**	.193*	*	-.092	-.260**	.206**	.635**	-	
9.Shoqërizimi	.146*	-.177*	.161*	.104	-.250**	.261**	.625**	.513**	-	
10.Mirëqenia	-.078	-.236**	.239*	*	-.061	-.209**	.305**	.687**	.621**	.572**
11. Totali(TEIQ)	.001	-.241**	.258*	*	.002	-.269**	.340**	.886**	.804**	.793**
										.857**

Për kampionin e Prishtinës korrelacionet kanë ndjekur tredin e kampionit të përgjithshëm.

Lidhshmëri e rëndësishme është gjetur në mes TEIQ ($r = -.241$, $p < .001$) dhe stilit autoritarian të nënës, ku korrelacioni ka qenë negativ dhe fuqia e korrelacionit jo shumë i madh. Rezultati

tregon se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritati të nënës. Sa më pak autoritariane nëna aq më e lartë është inteligjenca emocionale.

Korrelacion pozitiv dhe me një fuqi deri diku të moderuar ($r = .258, p < .001$) është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ fleksibel/ duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ fleksibel/ të nënës dhe kjo lidhje ka qënë e rëndësishme në aspektin statistikor. Sa më autoritative fleksibel të jetë nëna aq më e lartë shkalla e inteligjencës.

Lidhshmëri e rëndësishme është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritarian të babait. Korrelacioni ka qënë negative dhe fuqia e korrelacionit jo shumë e madhe ($r = -.269, p < .001$). Rezultati tregon se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritarian të babait. Sa më pak autoritarian babai aq më e lartë është inteligjenca emocionale.

Korrelacion pozitiv ($r = .340, p < .001$) dhe me një fuqi e moderuar është gjetur në mes TEIQ dhe stilit autoritativ fleksibel të babait duke treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale rriten pikët në shkallën e stilit autoritativ fleksibel/ të babait. Sa më autoritativ fleksibel të jetë babai aq më e lartë shkalla e inteligjencës. Rezultatet tregojnë që stili tolerant i nënës dhe babait nuk kanë lidhshmëri me inteligjencën emocionale (tabela 7)

Tabela 7

Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të nënës me faktorët dhe totalin e TEIQ

	Nëna tolerante	Nëna autoritariane	Nëna autoritative Fleksibel
	$F_{(3,275)} = .2.66^{**}, R^2 =$	$F_{(3,275)} = 5.64^{**}, R^2 =$	$F_{(3,275)} = 5.15^{**}, R^2 = .086$

	.047		.094			
	Beta	T	Beta	t	beta	T
Emocionaliteti	-.243	-1.02	.300	1.30	.095	.409
Vet kontrolli	-.117	-.644	-.263	-1.48	-.069	-.387
Shoqërizimi	.158	.874	.046	.263	-.121	-.686
Mirëqënia	-.284	-1.44	-.240	-1.25	.124	.466
Totali I TEIQ	.453	.741	-.042	-.071	.227	.380

Nga analiza e regresionit është gjetur që stili tolerant i nënës nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale ($R^2 = .001$, $p = .704$), ndërsa stili autoritarian ($R^2 = .024$, $p = .009$) të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor por fuqia e këtij parashikimi është shumë e vogël 0.2%. Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël/ i nënës është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale ($R^2 = .070$, $p < .001$). Por edhe për këtë stil të prindërimit të nënës fuqia e parashikimit ka qënë e dobët. 0.7%.

Tabela 8.

Regresion i shumfishtë për stilet e prindërimit të babait me faktorët dhe totalin e TEIQ

	Babai tolerant	Babai autoritarian	Babai autoritativ Fleksibël/

	$F_{(3,275)} = .1.82, R^2 = .032$		$F_{(3,275)} = 2.77.64^{**}, R^2 = .048$		$F_{(3,275)} = 9.11, R^2 = .143$	
	Beta	T	Beta	t	Beta	T
Emocionaliteti	.010	.010	.306	1.292	.272	1.214
Vet kontrolli	-.202	-.202	.033	.180	-.039	-.226
Shoqërizimi	.129	.129	.029	.161	.018	.105
Mirëqenia	-.177	-.177	-.023	-.116	.213	1.143
Totali I TEIQ	..209	.209	-.484	-.792	-.061	-.104

Analiza e regresionit ka treguar se stili tolerant i babait nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale ($R^2 = .001, p = .912$), ndërsa stili autoritarian i babait ($R^2 = .032, p = .003$) të jete parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor, por fuqia e këtij parashikimi është shumë e vogël 0.3% . Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël i babait është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale ($R^2 = .122, p < .001$). Stili i babait autoritativ fleksibël është gjetur të parashikojë 12.2 % të variancës së totalit të inteligjencës emocionale .

Babai autoritarian është gjetur i rëndësishëm edhe për shkallën e mirëqenies ($R^2 = .034, p = .001$); për shkallën e shoqërizimit ($R^2 = .026, p = .007$); shkallën e vetëkontrollit ($R^2 = .025, p = .008$) si dhe nuk është gjetur të jete parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit ($R^2 = .011, p < .079$).

Babai autoritativ fleksibël është gjetur parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit ($R^2 = .126$, $p < .001$) dhe shoqërizimit ($R^2 = .063$, $p < .001$). Është gjetur parashikues për shkallën e mirëqenies ($R^2 = .116$, $p < .001$) dhe për shkallën e vetëkontrollit ($R^2 = .054$, $p < .001$).

Rezultatet e kësaj analize kanë treguar që stili autoritativ fleksibël i babait dhe i nënës të jetë parashikues i rëndësishëm për inteligjencën emocionale (tabela 8)

Në kampionin e Prishtinës rezultatet kanë ndjekur trendin e kampionit të përgjithshëm. Nëna tolerante nuk është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencës emocionale si në kampionin e Fierit ($\beta (-.015, .009) = -.169$, $p = .114$) ashtu edhe në atë të Prishtinës ($\beta (-.003, .008) = -.03$, $p = .666$).

Rezultatet tregojnë se, si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtinës nëna autoritariane dhe ajo autoritative fleksible, janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$)

Tabela 9

Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të nënës me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç

Kampioni	Koeficienti		i	Koeficienti	i	t	p.
	pastandardizuar	standardizuar					
	B	SE		Beta			
Prishtina 1	4.466	.390			11.43	.000	
	(Konstant)				7		
	Nëna tolerante	-.003	.008	-.030	-.433	.666	

		Nëna autoritariane	-.021	.007	-.223	-3.228	.001
		Nëna	.025	.007	.247	3.539	.001
		autoritative Fleksibël/ (Konstant)	3.524	.418		8.437	.000
		Nëna tolerante	-.015	.009	-.169	-1.595	.114
Fier	1	Nëna autoritariane	.015	.008	.197	1.976	.051
		Nëna	.037	.007	.568	5.127	.000
		Fleksibël/autoritative					

Rezultatet tregojnë se si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtines, babai autoritarian dhe autoritative fleksible/ janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$), ndërkohë që dhe babai tolerant duket të jete i rëndësishëm, pasi vlerat e p janë shumë pranë sinjifikancës(tabela 10)

Tabela 10

Regresion i shumëfishtë për stilet e prindërimit të babait me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç

Kampioni	Model	Koeficienti		i Koeficienti	i T	Sig.	
		pastandardizuar	standardizuar				
		B	SE	Beta			
	(Konstant)	4.440	.296		15.017	.000	
Prishtine	1	Babai tolerant	-.013	.007	-.128	-1.791	.075
		Babai autoritarian	-.022	.006	-.254	-3.859	.000

		Babai	.033	.006	.386	5.441	.000
		autoritativfleksibël/ (Konstant)	2.193	.550		3.985	.000
		Babai tolerant	-.017	.009	-.199	-1.963	.053
Fier	1	Babai autoritarian	.038	.009	.477	4.128	.000
		Babai autoritativfleksibël	.056	.008	.834	6.874	.000

Nëpërmjet regresionit është analizuar gjithashtu nëse mosha, gjinia dhe dora, që pjesëmarrësit përdorin për të shkruar, janë parashikues të inteligjencës emocionale. Mosha shpjegon vetëm 0.2% të variancës së inteligjencës emocionale, 0.2% të emocionalitetit, 0.1% të vetëkontrollit, por nuk është parashikues i rëndësishëm për shkallën e shoqërizimit ($p = .223$) dhe mirëqenies ($p = .152$). Gjinia dhe dora me të cilën shkruanin pjesëmarrësit nuk ishte e rëndësishme.

Tabela 11. tregon se kur këto variabla hyjnë në model së bashku, mosha është parashikues i rëndësishëm ($\beta (.006, .002) = .143$, $p = .017$), ndërsa gjinia dhe me cilën dorë shkruajnë pjesëmarrësit vazhdojnë të jenë parashikues të rëndësishëm. .

Tabela 11

Regresion i shumëfishtë për moshën, gjininë dhe me cilën dorë shkruanin pjesëmarrësit me totalin e TEIQ për kampionin e përgjithshëm

	Koeficienti i pastandardizuar	Koeficienti i standardizuar	t	p.
--	----------------------------------	--------------------------------	---	----

	B	SE	Beta		
(Konstant)	4.741	.241		19.657	.000
Mosha	.006	.002	.143	2.409	.017
Gjinia	-.080	.066	-.072	-1.218	.224
Me cilën dorë shkruani?	.016	.179	.005	.087	.931

a. Variabla e varur: Totali i inteligjencës emocionale.

Kur ky model është testuar për shoqërinë e Fierit dhe të Prishtinës siç shihet në tabelën 12, asnjëra nga këto variable nuk ka qenë parashikues i rëndësishëm për inteligjencën emocionale ($p > .05$).

Tabela 12.

Regresion i shumëfishtë për moshën, gjininë dhe me cilën dorë shkruanin pjesëmarrësit me totalin e TEIQ për kampionet veç e veç

Kampioni	Model	Koeficienti i pa standardizuar		Koeficienti i standardizuar		t	p.
		B	SE	Beta			
Prishtina	1	(Konstant)	4.836	.277		17.437	.000
		Mosha	.001	.004	.013	.181	.857
		Gjinia	-.082	.083	-.071	-.987	.325
		Me cilën dorë shkruani?	.025	.198	.009	.127	.899

Fier	1	(Konstant)	4.696	.588		7.990	.000
		Mosha	.005	.004	.150	1.356	.179
		Gjinia	-.051	.103	-.055	-.495	.622
		Me cilën dorë shkruani?	.133	.482	.030	.276	.783

a. Variabla e varur: Totali i inteligjencës emocionale

4.3. Rezultatet krahasimore.

Mesataret për nënshkallët dhe faktorët e inteligjencës emocionale për gjininë mashkullore dhe femërore janë paraqitur në tabelën 13. Nuk janë gjetur dallime të rëndësishme në raportimin e totalit të inteligjencës emocionale në raport me gjininë ($M_M = 4.85$, $SD_M = .52$; $M_F = 4.79$, $SD_F = .56$; $t(375) = .92$, $p > .05$)

Tabela 13

Mesataret dhe devijimi standard për Tiparet e inteligjencës emocionale të ndara sipas gjinisë dhe totalit të kampionit.

TIPARET E INTELIGJENCËS EMOCIONALE	Gjinia			
	Mashkull		Femër	
	M	SD	M	SD
Përshtatshmëria	4.35	.63	4.19	.71
Vendosmëria	4.92	.81	4.81	.75
Shprehja emocionale	4.72	.90	4.58	1.10
Menaxhimi i emocioneve	4.53	.80	4.39	.81
Perceptimi emocional	4.80	.72	4.82	.84
Rregullimi emocional	4.68	.78	4.53	.80
Kontrolli i impulseve	4.68	.89	4.57	.87
Marrëdhënia	5.47	.98	5.55	.94
Menaxhimi i stresit	4.69	.69	4.64	.79
Vet besimi	5.07	.69	5.01	.71
Motivimi	4.84	.72	4.86	.73
Vetëdijesimi social	5.13	.85	5.01	.80

Rezultatet e treguara në tabelën 14, sipas analizës së testit, tregojnë se dallimi i rëndësishëm është gjetur në shkallën e përshtatshmërisë [$t(471)=2.45$, $p = .014$, $CI(.03, .28)$]. Meshkujt ($M = 4.35$, $SD = .63$) kanë raportuar mesatare më të lartë se sa femrat ($M = 4.19$, $SD = .71$). Gjithashtu dallim është gjetur në shkallën e menaxhimit të emocioneve [$t(471)=1.83$, $p = .068$, $CI(-.01, .29)$].

Meshkujt në shkallën e menaxhimit të emocioneve kanë raportuar mesatare më të lartë ($M = 4.53$, $SD = .80$) se sa femrat ($M = 4.39$, $SD = .81$). Dallime të rëndësishme statistikore janë gjetur në shkallën e Shoqërizimit ($t(471) = 2.09$, $p = .03$ $CI (.01, .23)$). Meshkujt kanë raportuar

mesatare më të lartë ($M = 4.86$, $SD = .63$) sesa femrat ($M = 4.58$, $SD = .63$) në shkallën e shoqërizimit.

Dallime janë gjetur në shkallën e vetëkontrollit $t(471) = 1.79$, $p = .07$ CI (.01, .21), por nuk ka mbërritur sinjifikancën.

Rezultatet tregojnë se meshkujt kanë treguar të kenë mesatare statistikisht më të lartë në raportimin e aftësisë për të influencuar ndjenjat e njerëzve të tjerë (shkalla e menaxhimit të emocioneve) si dhe në aftësinë për t'u përshtatur situatave të reja (shkalla e përshtatshmërisë).

Tabela 14

Rezultatet e T testit për shkallët e inteligjencës emocionale sipas gjinisë së pjesëmarrësve për kampionin e përgjithshëm.

	t	df	P	Interval konfidenca 95%	
				kufiri i poshtëm	kufiri i sipërm
Përshtatshmëria	2.455	471	.014	.03164	.28555
Vendosmëria	1.540	471	.124	-.03099	.25546
Shprehja emocionale	1.388	471	.166	-.05601	.32527
Menaxhimi i emocionave	1.831	471	.068	-.01026	.29025

Perceptimi emocional	-.277	471	.782	-.16923	.12744
Rregullimi emocional	1.962	471	.050	-.00025	.29577
Kontrolli i impulseve	1.416	471	.158	-.04571	.28119
Marrëdhënia	-.819	471	.413	-.25131	.10343
Menaxhimi i stresit	.676	471	.500	-.09156	.18752
Vet besimi	.929	471	.354	-.06885	.19222
Motivimi	-.330	471	.742	-.15758	.11231
Vetëdijesimi social	1.541	471	.124	-.03275	.27099
Empatia	-1.134	471	.257	-.22082	.05923
Lumturia	-.953	471	.341	-.28541	.09895
Optimizmi	-.850	471	.396	-.22699	.08995
Emocionaliteti	-.163	471	.871	-.13416	.11366
Vet kontrolli	1.794	471	.074	-.00998	.21897
Shoqërizimi	2.095	471	.037	.00768	.23989

Mirëqenia	-.484	471	.629	-.16890	.10219
Totali	.887	471	.375	-.05502	.14565

Mesataret për nënshkallët dhe faktorët e inteligjencës emocionale për kampionin nga Fieri dhe për kampionin nga Prishtina janë paraqitur në tabelën 15, ku janë gjetur dallime të rëndësishme në raportimin e totalit të inteligjencës emocionale në raport me shoqërinë ku jetonin pjesëmarrësit ($M_{SH} = 5.01$, $SD_M = .47$; $M_K = 4.76$, $SD_K = .56$; $t(471) = -3.65$, $p = .001$ CI(-.05, .14). Pjesëmarrësit nga Fieri kanë treguar mesatare më të lartë se ata nga Prishtina.

Edhe pse ky studim nuk ka për qëllim krahasimin me shtete të tjera, gjithsesi, është e rëndësishme t'i krahasojmë ato me të dhënat e ofruara nga autori i këtij pyetësoi.

Petrides & Furnham, (2008), në studimin e tyre origjinal kanë gjetur një mesatare 5.38 në shkallën e totalit të inteligjencës emocionale. Siç shihet, mesatarja e fituar në kampionin e përgjithshëm ka qenë më e ulët në shoqërinë e Fierit dhe të Prishtinës, duke sugjeruar që anglezët kanë raportuar shkallë të inteligjencës më të lartë se në Fier Shqipëri e Prishtinë Kosovë.

Tabela 15

Mesataret dhe devijimi standard për tiparet e inteligjencës emocionale të ndara sipas shtetit dhe totalit të kampionit.

	Prishtinë	Fier	Total
TIPARET E INTELIGJENCËS EMOCIONALE	M/SD	M/SD	M/SD

Përshtatshmëria	4.24(.74)	4.27(.62)	4.25(.71)
Vendosmëria	4.70(.86)	5.07(.60)	4.79(.82)
Shprehja emocionale	4.51(1.00)	4.85(1.01)	4.59(1.01)
Menaxhimi i emocioneve	4.45(.86)	4.44(.72)	4.45(.83)
Perceptimi emocional	4.73(.82)	4.92(.74)	4.77(.81)
Rregullimi emocional	4.54(.85)	4.66(.72)	4.57(.82)
Kontrolli i impulseve	4.40(.84)	4.90(.84)	4.52(.87)
Marrëdhënia	5.35(.95)	5.77(.90)	5.45(.95)
Menaxhimi i stresit	4.63(.80)	4.70(.66)	4.65(.77)
Vetëbesimi	4.91(.78)	5.20(.56)	4.99(.74)
Motivimi	4.65(.69)	5.15(.68)	4.77(.72)
Vetëdijesimi social	5.00(.86)	5.17(.74)	5.04(.84)
Empatia	4.86(.78)	4.80(.70)	4.84(.76)
Lumturia	5.29(1.12)	5.65(.85)	5.38(1.07)
Optimizmi	5.09(.89)	5.42(.74)	5.17(.87)
Emocionaliteti	4.86(.67)	5.09(.63)	4.92(.66)
Vet kontrolli	4.52(.63)	4.75(.56)	4.58(.62)
Shoqërizimi	4.72(.69)	4.89(.51)	4.76(.65)
Mirëqenia	5.10(.79)	5.42(.58)	5.18(.76)
Totali	4.76(.56)	5.00(.47)	4.82(.55)

Rezultatet e treguara në tabelën 16, sipas analizës së testit, tregojnë që dallimi i rëndësishëm është gjetur në shkallën e vendosmërisë $[t(471) = -5.09, p < .001, CI(-.16, .09)]$.

Pjesëmarrësit nga Fieri ($M = 5.07$, $SD = .60$) kanë raportuar mesatare më të lartë se sa pjesëmarrësit nga Prishtina ($M = 4.70$, $SD = .86$) në shkallën e vendosmërisë, në shkallën e shprehjes emocionale ($M_F = 4.85$, $SD_F = 1$; $M_P = 4.51$, $SD_P = 1$, $t(471) = -.307$, $p = .002$, $CI(-.47, .10)$); në shkallën e perceptimeve emocionale ($M_F = 4.92$, $SD_F = .74$; $M_P = 4.73$, $SD_P = .82$; $t(471) = -.201$, $p = .04$, $CI(-.39, .00)$); në shkallën e kontrollit të impulsivitetit ($M_F = 4.90$, $SD_F = .80$; $M_P = 4.40$, $SD_P = .84$; $t(471) = -.269$, $p = .007$, $CI(-.31, .07)$); në shkallën e marrëdhënieve ($M_F = 5.77$, $SD_F = .90$; $M_P = 5.35$, $SD_P = .95$; $t(471) = -.626$, $p = .001$, $CI(-.57, -.23)$); në shkallën e vetëbesimit ($M_F = 5.20$, $SD_F = .56$; $M_P = 4.91$, $SD_P = .78$; $t(471) = -.427$, $p = .001$, $CI(-.40, -.14)$); në shkallën e motivimit ($M_F = 5.15$, $SD_F = .68$; $M_P = 4.65$, $SD_P = .69$; $t(471) = -.746$, $p = .001$, $CI(-.66, -.35)$); në shkallën e lumturisë ($M_F = 5.65$, $SD_F = .85$; $M_P = 5.29$, $SD_P = 1.156$; $t(471) = -.39$, $p = .00$, $CI(-.55, -.18)$); në shkallën e optimizmit ($M_F = 5.45$, $SD_F = .74$; $M_P = 5.09$, $SD_P = .89$; $t(471) = -.432$, $p = .001$, $CI(-.55, -.18)$) dhe në katër faktorët e tipareve të inteligjencës emocionale; emocionalitet ($M_F = 5.09$, $SD_F = .63$; $M_P = 4.86$, $SD_P = .67$; $t(471) = -.339$, $p = .001$, $CI(-.32, -.08)$); vetëkontroll ($M_F = 4.75$, $SD_F = .56$; $M_P = 4.52$, $SD_P = .63$; $t(471) = -.391$, $p = .00$, $CI(-.33, .11)$); shoqërizim ($M_F = 4.89$, $SD_F = .51$; $M_P = 4.72$, $SD_P = .69$; $t(471) = -.275$, $p = .02$, $CI(-.27, .04)$) si dhe në mirëqenie ($M_F = 5.42$, $SD_F = .58$; $M_P = 5.10$, $SD_P = .79$; $t(471) = -.493$, $p = .00$, $CI(-.45, .13)$).

Rezultatet tregojnë se kampioni i Fierit dhe i Prishtinës nuk kanë treguar dallime në mënyrë se si individët e këtyre dy shoqërive i përshtaten situatave të reja (Përshtatshmëria $t(471) = -.53$, $p = .59$, $CI(-.16, .09)$); se si janë në gjendje të influencojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë (Menaxhimi i emocioneve $t(471) = -.305$, $p = .76$, $CI(-.12, .17)$); se si janë të aftë të kontrollojnë emocionet e tyre (Rregullimi emocional $t(471) = -.132$, $p = .18$, $CI(-.24, .04)$); se si janë në gjendje të rezistojnë presionit dhe stresit (Menaxhimi i stresit, $t(471) = -1.04$, $p = .29$, $CI(-.21, .06)$).

); se si janë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit (tiparet empatike $t(471) = -.83, p = .40$ $CI(-.07, .19)$ dhe se si arrijnë të krijojnë rreth shoqëror përmes aftësive të tyre sociale. Vetëdijesimi social, $t(471) = -1.89, p = .06$ $CI(-.29, .01)$).

Tabela 16

Rezultatet e testit për shkallët e inteligjencës emocionale sipas shtetit veç e veç.

	t	df	P	Interval konfidenca 95%	
				kufiri i poshtëm	kufiri i sipërm
Përshtatshmëria	-.539	471	.590	-.16000	.09111
Vendosmëria	-5.098	471	.000	-.49392	-.21911
Shprehja emocionale	-3.077	471	.002	-.47703	-.10518
Menaxhimi i emocionave	.305	471	.761	-.12521	.17121
Perceptimi emocional	-2.698	471	.007	-.34341	-.05399
Rregullimi emocional	-1.329	471	.184	-.24444	.04720
Kontrolli i impulseve	-6.260	471	.000	-.64756	-.33815
Marrëdhënia	-4.618	471	.000	-.57169	-.23037

Menaxhimi i stresit	-1.046	471	.296	-.21003	.06412
Vet besimi	-4.275	471	.000	-.40018	-.14816
Motivimi	-7.467	471	.000	-.60217	-.35128
Vetëdijesimi social	-1.898	471	.058	-.29309	.00511
Empatia	.833	471	.406	-.07938	.19608
Lumturia	-3.900	471	.000	-.55546	-.18323
Optimizmi	-4.324	471	.000	-.48933	-.18355
Emocionaliteti	-3.398	471	.001	-.32846	-.08778
Vet kontrolli	-3.917	471	.000	-.33260	-.11036
Shoqërizimi	-2.750	471	.006	-.27292	-.04542
Mirëqënia	-4.939	471	.000	-.45660	-.19670
Totali	-4.706	471	.000	-.32751	-.13456

Nuk janë gjetur lidhje mes nënshkallëve të inteligjencës emocionale si dhe faktorëve të TEIQ se me cilën dorë shkruajnë pjesëmarrësit. Për totalin e TEIQ ($t(471) = 2.45, p > .05$) gjithashtu nuk janë gjetur dallime.

Vendbanimi është gjetur të ketë ndikim në variancën e inteligjencës emocionale $F(2, 472) = 11.49, p < .01$). pjesëmarrësit nga qyteti kanë raportuar mesatare më të lartë se ata nga fshati.

Rezultatet tregojnë se moshë është gjetur në korrelacion pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm me totalin e TEIQ ($r = .150, p < .01$) me shkallën e emocionalitetit ($r = .181, p < .01$) dhe të vetëkontrollit ($r = .119, p < .05$). Me rritjen e moshës rritet edhe pjekuria e inteligjencës emocionale.

Të gjithë faktorët e TEIQ janë gjetur në korrelacion pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm me arsimimin e pjesëmarrësve. Me rritjen e viteve të arsimimit rritet edhe raportimi i shkallës së inteligjencës emocionale.

Të ardhurat mujore janë gjetur në korrelacion negativ vetëm me faktorin e emocionalitet (r = -.107, p < .05). Ky korrelacion tregon se me rritjen e të ardhurave ulet aftësia e pjesëmarrësve për të qenë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit.

Tabela 17

Rezultatet e korrelacionit të personit për variablat moshë, vitet e shkollimit dhe të ardhurat në familje me nënshkallët e TEIQ dhe totalit të saj.

	Moshë	Sa vite shkolle keni kryer?	Të ardhurat mujore të familjes tuaj janë:
Emocionaliteti	.181**	.211**	-.007
Vet kontrolli	.119*	.217**	-.054
Shoqërizimi	.071	.223**	-.044
Mirëqenia	.085	.276**	-.107*
Totali	.150**	.273**	-.077

KAPITULLI V.

Diskutimi

Ky studim ka pasur për qëllim të eksplorojë mardhenien (lidhjen) e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit mes Rajoneve të Fierit Shqipëri e Prishtine Kosovës.

Ky studim është unik dhe njëkohësisht mbart vlera shkencore dhe morale, duke marrë përsipër të studiojë dy shoqëri, të cilat i përkasin një origjine dhe një gjuhe.

Asnjë studim në Kosovë dhe në Shqipëri nuk ka parë marrëdhënien e inteligjencës emocionale me stilin e prindërimit. Argumenti, i cili mund të hapet që në fillim të këtij diskutimi, është në se Fieri Shqipëri dhe Prishtina Kosove janë dy kultura të ndryshme.

Gjithsesi konteksti historik ka qenë i ndryshëm për këto dy vende dhe nuk mund të anashkalojmë mundësinë e ndryshimeve, e cila ka shërbyer edhe për ndërtimin e hipotezave të studimit.

5.1. Lidhja e inteligjencës emocionale me stilet e prindërimit.

H1- Stili prindëror është i përcaktuar nga shkallët e inteligjencës emocionale.

Për të vertetuar këtë hipotezë është përdorur analiza e regresionit është përdorur për fuqinë e parashikimit të stileve të prindërimit mbi tiparet e inteligjencës emocionale. Të dhënat tregojnë se kjo hipotezë është vertetuar për shumicën e stileve të prindësimit.

Nga analiza e regresionit është gjetur që stili tolerant i nënës nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale, ndërsa stili autoritarian të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor por fuqia e këtij parashikimi ka qenë shumë e vogël. Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël i nënës është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale. Por edhe për këtë stil të prindërimit të nënës fuqia e parashikimit ka qenë e dobët. 0.7%.

Analiza e regresionit ka treguar se stili tolerant i babait nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale, ndërsa stili autoritarian i babait të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor, por fuqia e këtij parashikimi është shumë e vogël 0.3% . Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël i babait është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale. Stili i babait autoritativ fleksibël është gjetur të parashikojë 12.2 % të variancës së totalit të inteligjencës emocionale .

Babai autoritarian është gjetur i rëndësishëm edhe për shkallën e mirëqenies, për shkallën e shoqërizimit, shkallën e vetëkontrollit si dhe nuk është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit.

Babai autoritativ fleksibël është gjetur parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit dhe shoqërizimit, shkallën e mirëqenies dhe për shkallën e vetëkontrollit.

Rezultatet e këtij studimi kanë treguar që stili autoritativ fleksibël i babait dhe i nënës të jetë parashikues i rëndësishëm për inteligjencën emocionale

Hulumtimet e shumta janë përqendruar në identifikimin e lidhjes mes të IE dhe stileve të prindërimit (Delale, Taksic, dhe Ivcevic, 2007; Fonte, 2009), apo në matjen e niveleve në e kjo lidhje ekziston (Saarni, 1997).

Në bazë të rëndësisë së gjetjeve nga Baumrind, Mayer dhe Cobb (2000) u realizuan hulumtime duke analizuar lidhjen mes stileve prindërore me zhvillimin emocional të fëmijëve. Kështu ata erdhën në përfundim se stili prindëror ndikon fuqishëm në nivelin e intensitetit emocional dhe në aftësitë e fushave si perceptimi, mirëkuptimi, integrimi dhe menaxhimi i emocioneve.

Nga ana tjetër, aftësitë në këto fusha kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e përgjithshëm dhe vazhdimësinë e inteligjencës emocionale te një fëmijë (Goleman, 1998; Mayer & Salovey, 1997; Schutte et al., 2001).

5.1.1. Stili tolerant i prindit dhe inteligjenca emocionale

Nga ky studim janë përfituar të dhëna që kanë treguar se inteligjenca emocionale nuk ka pasur lidhje me stilin tolerant të nënës dhe të babait si për kampionin e Fierit Shqipëri dhe atë të Prishtines Kosovë. Lidhja e këtij stili prindërimi me inteligjencën e te rinjve ka qenë mjaft e studiuar dhe është parë se te rinjte, që rriten në familje me stil tolerant prindëror, kanë tendencë të shfaqin vështirësi në fusha të ndryshme të zhvillimit emocional. Betejat e tyre në jetë shpesh shkojnë nga pasiguria në vështirësinë e menaxhimit të sjelljeve të tyre (Olowodunoye dhe Titit, 2011; Williams, 2013). Këta te rinj nuk kanë inkurajim për të mësuar se si të përballen me emocionet e tyre në mënyrë të pavarur apo me emocionet e të tjerëve rreth tyre (Williams, 2013).

Fëmijët e te rinjte e prindërve tolerantë gjithmonë luftojnë me aspektet ndërpersonale të tyre emocionale. Paaftësia e tyre për të rregulluar emocionet e tyre u shkakton atyre miqësi të

papjekura dhe pa kompromis, gjë që ndikon negativisht në marrëdhënien me të tjerët (Olowodunoye & Titus, 2011).

Në bazë të këtyre studimeve shohim qartë se ka një lidhje të fortë mes stilit prindëror tolerant dhe IE.

5.1.2. Stili autoritativ fleksibël dhe inteligjenca emocionale

Stili prindëror autoritativ/fleksibël është i njohur si një stil prindëror që vendos kufijtë dhe kontrollet mbi sjelljet e fëmijëve, por, në të njëjtën kohë edhe lejon që ata të krijojnë komunikim me prindërit e tyre (Williams, 2013).

Ky stil prindëror është i njohur si stil balancues i cili në situata të caktuara vepron në mënyrë të balancuar.

Studimi ka gjetur relazion mes inteligjencës emocionale dhe stilit autoritativ fleksibël të nënës, duke treguar se sa më autoritative fleksibël të ishte nëna, aq më e lartë ndihej shkalla e inteligjencës. Ajo që duhet të themi është se kjo lidhje më shumë është studiuar te fëmijët dhe vlerësimi i tyre është i freskët pasi lidhet me marrëdhëniet prezent të prindit me fëmijën

Në studimin tonë duhet të kemi parasysh se pjesëmarrësit e këtij studimi janë të rritur dhe subjektiviteti mbi marrëdhënien e tyre me prindin nuk mund të mos anashkalohej.

Rishikimi i literaturës aktuale për të verifikuar lidhjen mes stileve prindërore dhe inteligjencës emocionale tek fëmijët në vende të ndryshme të botës, rezultoi me të dhëna pozitive. Stilet prindërore dhe IE te fëmijët, tregojnë se atashimi i sigurt me nënën dhe stili prindëror autoritativ është pozitivisht i lidhur me nivelet më të larta të inteligjencës emocionale te fëmijët, në krahasim me dy stilet e tjera prindërore (Kafetsios, 2004).

Sipas Kafetsios (2004), fëmijët që rriten në familje me prindër autoritativ fleksibël janë më të aftë për të kuptuar dhe për të menaxhuar emocionet e tyre, si dhe të tregojnë nivele të larta të vetëbesimit. Si adoleshentët, ashtu edhe fëmijët e rritur me nëna autoritative janë gjithashtu në gjendje të mirë emocionale dhe nga ana tjetër fitojnë aftësi për të treguar dhe shprehur emocionet e tyre.

Gjithashtu fëmijët e rritur nga nënat autoritative kanë ngrohtësi dhe respekt në shoqëri si pasojë e nivelit të tyre më të lartë të inteligjencës emocionale (Baumrind, 1971; Akinsola, 2010).

Nënat autoritative shpesh nxisin fëmijët e tyre që të angazhohen në arsyttime verbale në maksimum gjatë kontaktit me fëmijët e tyre, kështu mbetet e hapur për ndryshimin e rregullave të caktuara në bazë të vlefshmërisë së tyre.

Megjithatë vlen të thuhet se hulumtimet e kryera në nivel të përgjithshëm, kanë raportuar rezultate të përziera në lidhje me marrëdhëniet e inteligjencës emocionale me stilin prindëror fleksibil autoritativ

Në një hulumtim të kryer, rezultatet tregojnë se inteligjenca emocionale nuk është e lidhur në mënyrë të konsiderueshme as me nënën e as me stilin prindëror të babait (Amirabadi & Fatemeh, 2011). Nëse ne shikojmë nga perspektiva gjinore e prindit, stili autoritativ i babait lidhet pozitivisht me motivimin e fëmijëve (Sriram, Karnik & Ali, 2002). Kjo është në harmoni me modelin teorik, i cili tregon se stili autoritativ kontribuon në motivimin e fëmijëve (Erden & Uredi, 2000; Shalini & Balakrishna, 2013). Po ashtu, ky hulumtim ka rezultuar në lidhjen negative të IE me stilin prindëror autoritativ /fleksibël tek vajzat.

Nga ana tjetër, Kafetsios (2004) thekson se në stilet prindërore dhe IE, stili prindëror autoritativ është pozitivisht i lidhur me nivelet më të larta të inteligjencës emocionale te fëmijët, në krahasim me dy stilet prindërore tjera (Kafetsios, 2004).

Në një familje autoritative, rregullat e drejta dhe kohët e duhura janë deklaruar qartë për fëmijët (Williams, 2013). Shpesh, dialogu mes fëmijëve adoleshenteve dhe prindërve të tyre autoritative rezulton në një promovim të përgjegjësisë prindërore, nxitjes së pavarësisë, kompetencës sociale dhe njohëse dhe, po ashtu, një ndjenjë më të madhe të përgjegjësisë sociale.

Prindërit autoritativë, thotë Akinsola (2010), janë të njohur si dëgjues të mirë dhe të hapur për të dëgjuar pikëpamjet e fëmijëve të tyre. Kjo krijon terren shumë të mirë për zhvillimin e IE të tyre. Prindërit autoritative shpesh nxisin fëmijët e tyre të angazhohen në arsyetimin gojor, të shkëmbejnë ide të ndryshme me ta dhe të mbeten të hapur për ndryshimin e rregullave të caktuara në bazë të vlefshmërisë së tyre (Baumrind , 1971; Akinsola 2010) .

Dallimi mes të rezultateve të studimeve të ndryshme ku disa mbështesin lidhjen mes stilit prindëror autoritativ dhe IE, kurse disa jo, është pasojë e ndikimit kulturor, e moshës dhe e kushteve se si janë realizuar studimet në vende të ndryshme të botës.

5.1.3. Stili autoritarian i prindit dhe inteligjenca emocionale

Nga studimi ka dalë (rezultoi) se stili autoritarian ishte në marrëdhënie të rëndësishme me inteligjencën emocionale ku sa më autoritarian prindi, aq më e ulët ishte inteligjenca emocionale. Këto të dhëna janë në konsistencë me shumë hulumtime të bëra në vende të tjera të botës.

Prindërit me stil prindëror autoritarian karakterizohen si prindër me aftësi të ulëta njohëse dhe norma të larta të impulsivitetit (Baumrind, 1991).

Prindërit autoritarian janë shumë kërkues ndaj fëmijëve të tyre, por shumë pak kontribuojnë në nevojat e tyre emocionale (Williams, 2013).

Studimet tregojnë se fëmijët e prindërve autoritarian në përgjithësi kanë tendencë për të shfaqur një sasi të kufizuar të emocioneve, ose të bëhen emocionalisht të topitur për shkak se atyre u është dhënë shumë pak mundësi për të shprehur mendimet e tyre dhe ndjenjat në familje. Këtu duket qarte se lidhja mes të stilit autoritarian të prindërve dhe IE të fëmijëve, ekziston duke e çuar fëmijën drejt niveleve më të ulëta të inteligjencës emocionale (Kafetsios, 2004; Goleman, 1998; Mayer & Salovey, 1997; Schutte et al., 2001).

Interesante është se Baumrind (1991) ka gjetur se stili autoritarian në disiplinat lidhur me sjelljen emocionale të fëmijët, ka lidhje të vajzat, por jo tek djemtë (Baumrind, 1968; 1971; 1991).

Disa kërkime të tjera që kanë adresuar marrëdhëniet ndërmjet prindit dhe sjelljes emocionale të fëmijës janë kryer në viset e Kaukazit, të familjet e shtresës së mesme, ku të gjitha kanë korresponduar me lidhje pozitive mes të stilit autoritarian të prindit me IE e fëmijës (Seymour, 1999, 1987; Steinberg, Lamborn, Dornbusch dhe Darling, 1994) Por, këto studime sugjerojnë se nuk mund të përgjithësohen këto rezultate për një pakicë popullore, sepse ato mund të ndryshojnë nga vendi në vend. Ata kanë gjetur gjithashtu se prindërit autoritativ, veçanërisht babai, janë i lidhur pozitivisht me vetëdijesimin emocional të vajzave.

Në rastin e nënës rezultatet tregojnë se për vajzat nënat autoritative kanë lidhje pozitive me motivimin dhe trajtimin e marrëdhënieve emocionale, ndërsa kjo lidhje është negative me menaxhimin e emocioneve dhe vetëdijesimin emocional tek ato.

Si përfundim, prindërit autoritarian ndikojnë në vetëdijesimin emocional tek vajzat (Kakkar, 1987; Seymour, 1999)

Djemtë nuk kanë treguar asnjë lloj lidhjeje me ndonjë nga dimensionet e inteligjencës emocionale me prindërit autoritarian (Chao, 1994).

Babai, si një figurë mbrojtëse familjare, gjithmonë luan rol kyç në marrëdhëniet brenda familjes. Stili i tij i prindërimit, po ashtu, luan një rol shumë të rëndësishëm lidhur me IE tek fëmijët.

Megjithatë në bazë të studimeve është vërejtur dallimi se nëna ka më shumë efekt në lidhjen e stilit prindëror me IE te fëmija e saj, në dallim nga babai (Caspi, 2000).

Një studim tregon se stili i prindërimit të babait nuk ka lidhje sinjifikante me IE, kurse stili i prindërimit të nënës ka lidhje të tillë me IE (Johnson, Cohen, Chen, Kasen, & Brook, 2006).

Nga një studim i radhës rezulton e kundërta: duke pasur parasysh tre stilet prindërore më të njohura (autoritativ, autoritarian dhe tolerant), faktet tregojnë se fëmijët e rritur nga baba autoritativ janë më të përshtatshëm në fusha të ndryshme të jetës (Olowodunoye & Titi, 2011; Williams, 2013). Ata posedojnë aftësinë për të zgjidhur probleme, për të marrë vendime të shëndosha dhe funksionojnë me sukses në mjedise të strukturuar.

Nga ana tjetër babai që posedon stilin autoritativ apo tolerant ndikon dukshëm në dekurajimin e eksplorimit të pavarur të fëmijëve të tyre. Për t'u theksuar është se kreativiteti dhe aftësia intelektuale të këta fëmijë, edhe pse në përqindje të ulëta, rezulton më e pakët se te fëmijët tjerë (De Lisi & De Lisi, 2007).

Anët negative të këtyre dy stileve prindërore kanë një efekt të madh edhe te socializimi i fëmijëve.

Si përfundim nuk mund të gjeneralizohet se ka lidhje mes IE dhe prindërimit autoritativ, ngaqë kemi dallime nga stili prindëror autoritativ i nënës se si ndikon te fëmijët, me stilin prindëror të babait se si ndikon tek IE e fëmijëve.

Përveç kësaj, në bazë të studimeve të trajtuara më lart mund të konkludojmë se stili prindëror nuk afekton njolloi vajzat dhe djemtë.

5.2. Inteligjenca emocionale stili i prindërimit dhe kultura.

H2. Ekziston lidhje e rëndësishme mes inteligjencës emocionale dhe stileve prindërore në kampionin e Fier dhe atë të Prishinës.

Rezultatet e arritura për kampionin në përgjithësi kanë treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritarian të nënës dhe babait. Sa më pak autoritarian nëna dhe babai, aq më e lartë ka qenë vlerësimi i shkallës së inteligjencës tek pjesmarrësit e këtij hulumtimi. Ndërkohë që sa me autoritative fleksibël të ketë qenë nëna dhe babai nëna aq më e lartë është raportuar shkalla e shkalla e totalit të inteligjencës emocionale. Por rezultatet e këtij studimi nuk kanë gjetur që stili tolerant i nënës dhe babait të kenë parur lidhshmëri të rëndësishme statistikore me inteligjencën emocionale të pjesmarrësve të këtij studimi.

Në kampionin e Prishtinës rezultatet kanë ndjekur trendin e kampionit të përgjithshëm. Nëna tolerante nuk është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencës emocionale si në kampionin e Fierit po ashtu edhe në atë të Prishtinës. Rezultatet tregojnë se si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtinës nëna autoritariane dhe ajo autoritative fleksible, janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$)

Rezultatet tregojnë se si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtinës, babai autoritarian dhe autoritative fleksible janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$),

ndërkohë që dhe babai tolerant duket të jete i rëndësishëm, pasi vlerat e p kanë qenë shumë pranë sinjifikancës

Rezultatet tregojnë që pjesëmarrësit nga Fieri kanë raportuar mesatare më të lartë se sa pjesëmarrësit nga Prishtina në shkallën e vendosmërisë, në shkallën e shprehjes emocionale, në shkallën e perceptimeve emocionale, në shkallën e kontrollit të impulsivitetit, në shkallën e marrëdhënieve , në shkallën e vetëbesimit, në shkallën e motivimit, në shkallën e lumturisë, në shkallën e optimizmit dhe në katër faktorët e tipareve të inteligjencës emocionale; emocionalitet vetëkontroll, shoqërizim si dhe në mirëqenie. Kampioni i Fierit dhe i Prishtinës nuk kanë treguar dallime në mënyrë se si individët e këtyre dy shoqërive i përshtaten situatave të reja; se si janë në gjendje të influencojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë; se si janë të aftë të kontrollojnë emocionet e tyre; se si janë në gjendje të rezistojnë presionit dhe stresit; se si janë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit dhe se si arrijnë të krijojnë rreth shoqëror përmes aftësive të tyre sociale.

Konstrukti i inteligjencës emocionale, për shkak të gjerësisë së spektrit që e ndërton, është e lidhur edhe me kulturën dhe orientimin e saj ndaj individit. Ky studim ka gjetur dallime të rëndësishme në raportimin e totalit të inteligjencës emocionale në raport me shoqërinë ku jetonin pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit nga Fieri Shqiperi kanë raportuar mesatare më të lartë se ata nga Prishtina Kosove. Një spekulim në lidhje me këtë rezultat mund të lidhet me një orientim më të madh të shoqërisë në Shqipëri ndaj individit, ndërsa Kosova për shkak të kontekstit politik, ekonomik dhe social vazhdon të jetë më e drejtuar drejt grupit, aktualisht, familjes së gjerë.

Një e dhënë interesante lidhet me gjetjet se këto dy shoqëri nuk kanë dallime në raport me inteligjencën emocionale. Rezultatet tregojnë se kampioni i Fierit dhe i Prishtinës nuk kanë

treguar dallime në mënyrë se si individët e këtyre dy shoqërive i përshtaten situatave të reja (përshtatshmëria), se si janë në gjendje të influencojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë (menaxhimi i emocioneve), se si janë të aftë të kontrollojnë emocionet e tyre (rregullimi emocional), se si janë në gjendje të rezistojnë presionit dhe stresit (menaxhimi i stresit), se si janë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit (tiparet empatike) dhe se si arrijnë të krijojnë rreth shoqëror përmes aftësive të tyre sociale (vetëdijesimi social).

Këto rezultatet janë të justifikueshme për faktin se të dy këto shoqëri kanë rrënjë të njëjta, të cilat më së shumti, mbahen përmes ndarjes emocionale. Kultura kap shumë aspekte, të cilat e orientojnë individin drejt synimeve jetësore.

Emocionet ,të cilat janë pjesë e kulturës, na shtyjnë që të arrijmë qëllimet tona, por janë dhe një inkurajim i jashtëzakonshëm për lidhjet tona sociale dhe emocionale të cilat përcaktojnë edhe mirëqenien fizike dhe shpirtërore. Disa hulumtime tregojnë dallimet në kultura individualistike dhe ato kolektivistike edhe pse ky koncept duket tashmë jo shumë i përdorshëm, ku janë gjetur që shoqëritë me orientim individualist janë më efektive në njohjen dhe të kuptuarit e emocioneve të tyre, ata raportojnë reagime emocionale verbale dhe jo verbale, kanë më pak gjasa të shtypin emocionet e tyre, janë më të sigurt , janë më pak impulsivë, kanë tendencë për të parë dhe për të paraqitur veten pozitivisht (vetërespekt të lartë) janë më të lumtur , kanë tendencë të jenë më optimistë, shfaqin aftësi më të lartë për të përballuar stresin, kanë aftësi më të mëdha sociale dhe janë më të motivuar.(Jandt, 2010).

Përmbledhja e këtyre hulumtimeve tregon qartë se kultura ndikon në Inteligjencën emocionale dukshëm.

Duke pasur parasysh këto dallime, më shumë hulumtime duhet të bëhen në mënyrë që ne të mund të kuptojmë më mirë vetitë psikometrike të instrumenteve të IE nëpër kultura të ndryshme. Pyetësi i inteligjencës emocionale si për Fierin Shqipëri dhe Prishtinë Kosovë ka treguar cilësi psikometrike shumë të mira. Kështu, një tregues ndërkulturor është një përgjigje e kërkesës së bërë nga studiues të ndryshëm (Ekermans 2009; Gangopadhyay & Mandal, 2008).

Deri më sot, është një numër i konsiderueshëm i hulumtimeve ndërkulturore të IE nëpër kultura kolektivistike dhe kultura individualiste. Ndonëse inteligjenca emocionale është hulumtuar në shoqëri të ndryshme, i njëjti rezultat është edhe për stilin e prindërimit.

Trashëgimia kulturore, jo vetëm brenda një vëndi por edhe brënda grupeve apo familjeve, ka ndikim në stilin e prindërimit.

Sipas studiuesve, dallimi kulturor kryesor në vija të trasha në mes të stileve prindërore është te koncepti i pavarësisë dhe ndërvarësisë. Kulturat që përfaqësojnë pavarësinë theksojnë më shumë në stilet e tyre prindërore të shprehurit e lirshëm, unitetin personal dhe vetë-mjaftueshmërinë, kurse kulturat që përfaqësojnë ndërvarësinë theksojnë më shumë në stilet e tyre prindërore solidaritetin e grupit, hierarkinë sociale dhe përlësinë personale (Collins & Russell, 1991; Eëang & Leichtman, 2000).

Për sa i përket autonomisë personale, prindërit që kanë në kulturën e tyre konceptin e pavarësisë në trashëgiminë e tyre, janë të shqetësuar me aftësinë e fëmijës së tyre për të ndërtuar tek ai ndjenjën ndaj "vetes".

Aftësia për të fituar pavarësinë, këmbëngulësinë dhe të shprehurit e lirshëm në moshë të re është e theksuar te kjo kulturë prindërore. Nga ana tjetër prindërit që në kulturat e tyre kanë konceptin e ndërvarësisë, duket qartë se kanë vendosur në stilet e tyre të prindërimit një theks të rëndësishëm në njësinë familjare (Rothbaum, Morelli, Pott, & Liu, 2000).

Sipas mendimit të tyre respektimi i autoritetit brenda familjes, siguron vendin dhe respektin ndaj njëri-tjetrit. Prej tyre pritet që fëmijët adoleshentet të binden ndaj autoritetit dhe në jetë të mësojnë e të kenë karakter të mirë moral.

Koncepti i pavarësisë të ky stil prindëror është lidhur ngushtë me të qenit anëtarë dhe kontribuues të familjes, larg zhvillimit të “Ndjenjës ndaj vetes” (Rothbaum et al, 2000).

Stilet prindërore varen shumë nga konteksti kulturor ku ata janë rritur dhe zhvilluar. Duke qene se prindërimi shihet si një element i rëndësishëm i kulturës pasi është i lidhur ngusht me trashëgimin në familje, pasi prindërit përmes angazhimit të tyre në mirërritjen e fëmijëve krijojnë mundësi të trashigimisë kulturore gjithashtu dhe atë biologjike.

5.3.Gjinia dhe inteligjenca emocionale

Ky studim ka vertetur pjesërisht hipotezën (H4) që ka dallime gjinore në raportimin e inteligjencës emocinale. Studimi ka gjetur në përgjithësi dallime gjinore vetëm në dy nënshkallë të TEIQ, ndërsa nuk ka gjetur dallime në raportimin e totalit të inteligjencës emocionale. Rezultatet treguan se meshkujt kanë treguar të kenë mesatare statistikisht më të larta në raportimin e aftësisë për të influencuar ndjenjat e njerëzve të tjerë (shkalla e menaxhimit të emocioneve) si dhe në aftësinë për t’iu përshtatur situatave të reja (shkalla e përshtatshmërisë).

Mayer, Salovey & Caruso, (2001) në studimin e tyre theksojnë se djemtë dhe vajzat nuk mësojnë njëllor nga prindërit e tyre për të kontrolluar emocionet e tyre. Me vajzat flasin rreth shprehjes së emocioneve në përgjithësi, duke kërkuar prej tyre që të mos e përdorin zemërimin. Krahasuar me vajzat, me djemte e tyre prindërit flasin më tepër për mos shprehjen e pikëllimit të tyre nga që ata janë të fortë (Scharfe, 2000).

Prirjet e shoqërisë dhe njerëzve për rreth ndryshojnë nga dita e parë që lind fëmija. Atë ditë kjo duket qartë te ngjyra e teshave të vajzës që dallojnë nga ato të djalit, apo edhe tek ndryshimi i lodrave të para për ta.

Në aspektin kulturor, vajzat dallojnë nga djemtë ngaqë pritet të jenë kryesisht më ekspresive në shprehjen e ndjenjave. Ndërsa te meshkujt forcohet ndjenja e modelit burrëror.

Williams dhe Barry (2003), në studimin e tyre të IE në bazë gjinore, treguan se femrat morën dukshëm më shumë pikë në inteligjencën emocionale, në të kuptuarit e kapaciteteve, në rregullimin emocional dhe në përdorimin e emocioneve në situata të ndryshme.

Nga studimet e mëhershme duket qartë se IE dallon në bazë gjinore. Si kusht kryesor ajo ka stilin prindëror gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijës. Kështu vajzat, në dallim nga meshkujt, kanë tendencë për më tepër inteligjencë të lartë emocionale.

Të dhënat e arritura në këtë studim nuk janë në konsistencë me studime, të cilat kanë gjetur dallime gjinore dhe femrat kanë raportuar shkallë më të lartë se meshkujt (Cabello, Sorrel, Fernandez-Pinto, Extremera, & Fernandez-Berrocal, 2016; Siegling, Furnham, & Petrides, 2015). Në bazë të rëndësisë së gjetjeve nga Baumrind, Mayer dhe Cobb (2000) u realizuan hulumtime duke analizuar lidhjen mes stileve prindërore me zhvillimin emocional të fëmijëve. Kështu ata arritën në përfundimin se stili prindëror ndikon fuqishëm në nivelin dhe intensitetin emocional dhe aftësitë në katër fusha: në perceptim, në mirëkuptim, në integrim dhe në menaxhim të emocioneve.

Nga ana tjetër aftësitë në këto fusha kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e përgjithshëm dhe vazhdimësinë e inteligjencës emocionale te një fëmijë (Goleman, 1998; Mayer & Salovey, 1997; Schutte et al., 2001).

Fëmijët, që rriten në familje me stil tolerant prindëror, kanë tendencë të shfaqin vështirësi në fusha të ndryshme të zhvillimit emocional. Betejat e tyre në jetë shpesh shkojnë nga pasiguria në vështirësinë e menaxhimit të sjelljeve të tyre.

Këta fëmijë nuk inkurajohen për të mësuar se si të përballen me emocionet e tyre në mënyrë të pavarur apo me emocionet e të tjerëve rreth tyre. Fëmijët e prindërve tolerantë gjithmonë luftojnë me aspektet ndërpersonale të emocioneve të tyre. Paaftësia e tyre për të rregulluar emocionet e tyre u shkakton atyre miqësi të papjekura dhe pa kompromis, dhe kjo ndikon negativisht në marrëdhënien me të tjerët (Olowodunoye & Titus, 2011).

Në bazë të këtyre studimeve shohim qartë se ka lidhje të fortë mes stilit prindëror tolerant dhe IE.

5.4. Lidhja e inteligjencën emocionale me variabla të tjera

Të gjithë faktorët e TEIQ janë gjetur në korrelacion pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm me arsimimin e pjesëmarrësve. Me rritjen e viteve të arsimimit rritet edhe raportimi i shkallës së inteligjencës emocionale. Ky rezultat ka vërtetuar hipotezën që nuk ka dallime të rëndësishme në raportimin e inteligjencës emocionale midis Fierit dhe Prishtinës në lidhje me nivelin e arsimimit të prindërve (H3)

Pjesë e kësaj hipoteze ka qenë edhe lidhmëria e moshës me inteligjencën emocionale (H3). Studimi e ka vërtetuar këtë hipotezë duke gjetur që me rritjen e moshës është rritur raportimi i shkallës së inteligjencës.

Ka shumë supozime rreth lidhjes së moshës dhe IE, duke filluar që nga letërsia popullore, ku pohohet se njerëzit e moshuar janë më të vetëdijshëm, të urtë dhe të përmbajtur emocionalisht.

Atëherë a janë njerëzit më të moshuar domosdoshmërisht më të mirë në inteligjencën emocionale se sa më të rinjtë? Apo mund të ndodh edhe e kundërta në ditët e sotme pasi që mundësia e rrjeteve sociale po shton cdo ditë e më tepër mundësinë për të zgjeruar të rinjtë diapazonin e tyre të dijes, e rrjedhimisht, po mësojnë edhe mënyra të reja të menaxhimit emocional.

Anitei (2008) ka kryer një studim mbi 405 amerikanë në mes të moshës 22 dhe 70 vjet. Ai gjeti një signifkancë pozitive në moshën e thyer dhe IE, por një lidhshmëri të dobët në mes të inteligjencës emocionale dhe moshës në përgjithësi, $r = .13$ ($P < .01$). Autori i këtij studimi sugjeron se njerëzit e moshuar kanë pak më shumë mundësi të jenë me IE më të lartë se të rinjtë. Sipas studiuesit thuhet se është e mundshme që akumulimi i eksperiencave jetësore të kontribuojë në rritjen më të lartë të IE.

Një studim tjetër nuk mbështet gjetjet e Anitei (2008). Ky studim me analizimin e të dhënave të inteligjencës emocionale, në bazë të moshës treguan se ka pasur dallime të IE në grupmosha të ndryshme dhe jo vetëm tek të moshuarit dhe se është e mundur që dallimet jo të rëndësishme të vërejtura prej studiuesve Sinthy (2007) dhe Anitei (2008) mund të pasqyrojnë rezultatin e përgjithshëm IE. Kjo mund të jetë e mundur nëse dimensionet e veçanta janë konsideruar të parëndësishme për grup moshash të ndryshme. Gjithsesi, ato mund të kenë disa dallime që vihen re mes të moshës së meshkujve dhe moshës së femrave. Në të njëjtën kohë, mostrat e vogla në secilin prej nëngrup moshave mund të ndikojnë në mosvlerësimin e diferencës së fituar (Hopkins & Bilimoria, 2008).

Në një studim të kryer nga Day dhe Carroll (2004), rezulton se mosha ka korrelacion pozitiv me tre nga katër matësit e inteligjencës emocionale, bazuar në matësit e Mayer-it, Salovey-t dhe Caruso-s (2002).

Van Rooy, Alonso, dhe Viséesvaran (2005) në studimin e tyre shqyrtuan se marrëdhënia mes inteligjencës emocionale dhe moshës nuk kishte lidhje të rëndësishme pozitive mes tyre .

Lidhja midis inteligjencës emocionale dhe moshës është temë që ka pak variacione të hulumtimeve kushtuar një pjese të vogël për shqyrtimin e kësaj lidhjeje.

Të dhënat nga ky studim e të gjitha të dhënat e ofruara tregojnë se duhen më shumë studime për të hetuar rolin e moshës në lidhje me inteligjencën emocionale në shumë aspekte, duke mos e lënë këtë temë të përgjithësuar vetëm në një matje të një lidhjeje të thjeshtë.

Per sa i perket nje te dhene tjeter te paraqitur nga pjesmarresit(kampioni)se me cilen dore shkruajne te djathten o te majten nuk është gjetur ndonjë dallim i rëndësishëm në raportimin e inteligjencës emocionale në raport me cilën dorë shkruante pjesmarrësit. Gjithashtu nuk janë gjetur lidhje mes nënshkallëve të inteligjencës emocionale si dhe faktorëve të TEIQ se me cilën dorë shkruajnë pjesëmarrësit

5.5. Ndërlidhja e religjionit me inteligjencën emocionale.

Nga studimet e shumta është vërejtur se në dekadat e fundit është raportuar për marrëdhënie pozitive midis stabilitetit emocional dhe religjionit.

Ky studim nga te dhenat e marra nga kampioni i pergjithshtme ka dale ne rezultatin se pjesmarresit e besimit katolik të kishin raportuar mesatare më të lartë se sa pjesmarrësit e besimit mysliman në mesataren e totalit të inteligjencës emocionale.

Në një studim të kryer nga anëtarët e kishës e krishterë, u raportua se përveç inteligjencës më të lartë emocionale të klerikëve, në krahasim me njerëzit e zakonshëm të kësaj feje, ka edhe

marrëdhënie pozitive midis religjionit dhe inteligjencës emocionale. Herbert dhe Forman (2011), besonin se roli i fesë është i pamohueshëm në formimin e identiteteve individuale dhe kolektive, duke krijuar transferimin e vlerave dhe fuqizimin e kuptimit moral. Disa shkencëtarë kanë zbuluar aspekte të reja personale dhe sociale të fesë. Sipas tyre, shumë nga intelektualët e kanë konsideruar orientimin fetar si një qasje ndaj parandalimit të të këqijave të ndryshme sociale. Ata kanë treguar se njerëzit fetarë, duke e ulur tensionin e tyre në pikën më të ulët, kanë shmangur rreziqet (Faramarzi, Homae & Hosseini, 2009). Prandaj, ndikimi i fesë në formimin e një personaliteti të shëndetshëm është vërejtur edhe në ndërtimin inteligjencës emocionale.

Lidhur me përcaktimin e fesë, Robert Hume vë në dukje se ajo nënkupton një grup përvojash ku përfshihen mendimet, ndjenjat dhe aktivitetet që personi është duke u përpjekur për ta kontrolluar botën nëpërmjet asaj që ai mendon se është hyjnore apo një fuqi shumë e lartë dhe e vlefshme (Faramarzi, Homae & Hosseini, 2009).

Njerëzit, të cilët kanë një vetëdije fetare më të lartë se të tjerët, shpesh konsiderohen si persona me orientim fetar të lindur. Këta njerëz zakonisht kritikojnë çështjet fetare dhe i pranojnë ato me më shumë njohuri. Pra, orientimet janë të lindura dhe konsiderohen si pjesë të personalitetit të tyre të vazhdueshëm dhe karakteristike të sjelljes dhe inteligjencës emocionale (Kimiaee, Raftar & Soltanifar, 2011).

Gjithashtu nga një studim tjetër mësohet për gjetje të kundërta, sipas të cilave, te njerëzit e lindur me orientime fetare, besimi i tyre fetar ka më pak lidhje me inteligjencën emocionale, ngaqë ata kanë lindur dhe janë rritur në një ambient ku kanë pranuar shumicën e riteve si të domosdoshme.

Te ky studim, orientimi fetar i fituar pas një kohe rezulton se ka lidhje më të lartë me inteligjencën emocionale të tyre, ku në bazë të analizave dhe pëlqimit të personit është zgjedhur orientimi fetar (Ghasemzade et al, 2010).

Në një studim tjetër, i cili është zhvilluar për të përcaktuar marrëdhënien fetare dhe IE të studentëve të universitetit, rezultatet treguan se ekziston marrëdhënie e rëndësishme pozitive mes IE dhe besimit fetar. Gjithashtu u vu dukje se ekziston lidhje pozitive midis komponentëve fetarë dhe praktikave fetare me inteligjencën emocionale (Janati, 2012).

Auguste Comte e përshkruan fenë si rrjedhojë e një nevoje të lindur dhe natyrore të njerëzimit. Ata përshkruan ekzistencën e çdo personi, si të barabartë me ekzistencën e fesë së tij (Ghasemzade et al, 2010).

Nga ana tjetër thuhet se praktikat fetare janë efektive në rritjen e nivelit të shëndetit mendor dhe të inteligjencës emocionale, si dhe në uljen e depresionit (Hosseini, Sede & Fathi Ashtiani, 2009). Në përputhje me këtë studim Janati (2012) zbuloi se pelegrinazhi fetar ka një efekt shumë të mirë në rritjen e IE. Efekti i simptomave të tyre është i vazhdueshëm, të paktën dhjetë muaj pas kthimit nga pelegrinazhi fetar.

5.6. Përdorimi pyetsorëve vetëraportues në studimet cross seksionale.

Pyetsori i inteligjencës emocionale si për Fierin dhe Prishtinen ka treguar cilësi psikometrike shumë të mira.

Pavarësisht nga përparimet e jashtëzakonshme në fushën e hulumtimeve të inteligjencës emocionale, është interesante se ka ngecur deri diku pas dore studimi i Inteligjences emocionale në kultura të ndryshme. Në mënyrë të veçantë kërkesa e mbartjes së mjeteve matëse të IE në kultura të ndryshme ka diktuar nevojën që hulumtuesit të vlerësojnë cilësinë dhe më e rëndësishmja të matin besueshmërinë e instrumenteve në kultura të ndryshme (Ekermans 2009; Gangopadhyay & Mandal, 2008, Palmer, Gignac, Ekermans, dhe Stough, 2008).

Këto instrumente nuk mund thjesht të transportohen në kontekste të tjera kulturore, pa analizuar dhe identifikuar vetitë dhe karakteristikat psikometrike në kultura të ndryshme.

Në këtë aspekt ky studim nuk ka gjetur dallime në raportimin e koeficientit të brendshëm. Sigurisht që konstrukti i brendshëm i pyetësorit të inteligjencës emocionale ka gjetur dallime mes Fierit dhe Prishtines në raportimin e mesatareve të nënshkallëve.

Pyetësori i Tipareve të Inteligjencës Emocionale (Trait Emotional Intelligence Questionnaire TEIQue), në dallim nga shumë matës të tjerë vetëraportues për Inteligjencen emocionale (Siegling, Nielsen, & Petrides, 2014), të cilat lënë më shumë për të kërkuar teorikisht në dallim nga mënyra psikometrike (Conte, 2005; Mattheüs, Zeidner & Roberts, 2004), TEIQ karakterizohet me një bazë të fortë teorike dhe psikometrike

Baza solide psikometrike e instrumenteve të TEIQ është reflektuar në stabilitetin ndër-kulturor të strukturës së saj katër- faktorësh, i cili është përshtatur në disa gjuhë ku p.sh. , Andrei, Smith, Surcinelli, Baldaro, dhe Saklofske, 2015 e realizuan përshtatjen Italiane; Freudenthaler, Neubauer, Gabler, Scherl dhe Rindermann 2008, e realizuan përshtatjen Gjermane; Jolic Marjanovic & Altaras-Dimitrijevic 2014, e realizuan përshtatjen në gjuhën Serbe; Martskvishvili, Arutinov dhe Mestvirishvili 2013, e realizuan përshtatjen në gjeorgjisht; Mikolajczak, Luminet, Leroy, dhe Roy 2007, në frëngjisht).

Një literaturë e gjerë dëshmon për kriterin e vlefshmërisë së instrumenteve të TEIQ me një gamë të gjerë të rezultateve pozitive në këtë aspekt.

Nga ana tjetër studimet meta-analitike kanë treguar vazhdimisht se, në krahasim me matësit e tjerë të IE, TEIQ ka veti superiore psikometrike dhe një besueshmëri të madhe ndër-kulturore, duke përfshirë edhe vlefshmërinë në rritje. Freudenthaler et al 2008; Gardner & Qualter, 2010; Martins et al., 2010).

Instrumentet e IE janë të lidhura ngushtë me kontekstet kulturore ku ato janë zhvilluar (Ekermans, 2009). Pjesa më e madhe e instrumenteve të IE janë zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Mbretërinë e Bashkuar, në Australi, apo në Evropë (Van de Vijver & Leung, 2001).

Një përpjekje për të vlerësuar dhe përcaktuar modelin e stileve prindërore të Baumrindit (1971), Buri (1991) zhvilloi Parental Authority Questionnaire (PAQ). Buri (1991) raportoi koeficientë të mirë të brëndshëm qëndrueshmërie dhe koeficiente të mirë besueshmërie, ku paraqiti prova për ndërtimin dhe vlefshmërinë e kriterëve. Buri (1991), që nga fillimi i punës së tij, tregoi interes në shfrytëzimin e PAQ për të kuptuar stilet prindërore dhe marrdhëniet e tyre në shoqëri me kultura të ndryshme, të tilla si vendet arabe (p.sh., Dwairy et al., 2006), vendet e Azisë Lindore (Chao & Tseng, 2002), Iran (Assadi et al., 2007), SHBA (Collins & Steinberg, 2006), dhe Vietnam (Nguyen, 2008).

Përkundër hulumtimeve të gjëra në mbarë botën ku është shfrytëzuar PAQ, ky pyetësor pak është i njohur për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve të tij, kur aplikohet në kultura të ndryshme.

Stilet prindërore ndryshojnë bazuar në kulturat e ndryshme në të cilat prindërit janë rritur, andaj dhe PAQ po paraqet probleme në përcaktimin e saktë të stilit prindëror (Collins & Steinberg, 2006). Si e tillë, PAQ kërkon vlerësim të mëtejshëm, sepse krijimi i dëshmive të rezultateve të kuptimita në kultura të ndryshme, është një proces i vazhdueshëm dhe në zhvillim (Messick, 1995).

Si problematikë kryesore është paraqitur gjatësia e pyetësorëve që posedon PAQ, e cila ka paraqitur një kërkesë që ajo të shkurtohet dhe në këtë mënyrë të bëhet vlefshmëria e saj në kultura të ndryshme.

5.7. Konkluzione dhe rekomandime

Përdorimi i metodës kuantitative përmes përdorimit të dy pyetësorëve ka mundësuar për të hulumtuar mardhenien (lidhjen) mes tipareve të inteligjencës emocionale dhe stileve të prindërimit, në një kampion të përzierë nga Fieri në Shqipëria dhe Prishtinë në Kosovë.

Bazuar në lidhjen e gjetur mes këtyre dy variablave mund të argumentojmë që identifikimi i tipareve të inteligjencës emocionale dhe i stilit të prindërimit është i një rëndësie të veçantë për mirëqenien e individit brenda një shoqërie të caktuar. Ato janë të rëndësishme edhe për njohjen e dinamikave personale dhe shoqërore. Kjo ndërlidhje sigurisht që është shumë komplekse.

Studime të tjera do të jenë të nevojshme për të hedhur më shumë dritë në shpjegimin e faktit se si inteligjenca emocionale dhe stili i prindërimit ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e individit dhe, në mënyrë të veçantë, të fëmijëve.

Duke qenë se stilet e prindërimit ishin parashikues të rëndësishëm të inteligjencës emocionale, merr rëndësi të veçantë investimi për edukimin e prindërve, përmes shumë strategjive, të cilat do të krijojnë mundësi të gjithëpërfshirjes së tyre, pavarësisht nga gjinia, mosha, vendbanimi, etniciteti apo besimi.

Studimi ka treguar qartë se inteligjenca emocionale në spektrin e saj influencohet nga shumë faktorë dhe sa më shumë prej tyre të përfshihen në edukim aq më i madh ka për të qënë impakti në shoqëri.

Investimi në inteligjencën emocionale për të dy vëndet është shumë i rëndësishëm pasi lidhet edhe me transformimet e mëdha që po ndodhin tek çdo individ të këtyre dy shoqërive në vitet e fundit. Duke qenë se spektri i inteligjencës emocionale lidhet me shprehjen dhe kontrollin

emocional, kjo e ndihmon individin të respektojë veten dhe të tjerët dhe të lehtësojë proceset e përshtatjes, ku mjedisi në të cilin ai apo ajo jeton ballafaqohet me sfida.

Një komponent i rëndësishëm i inteligjencës emocionale është edhe aftësia e individit për t'u ballafaquar me stresin. Të dy vendet, Shqipëria edhe Kosova ku bëjnë pjese rajonet e kapionimit në dekadat e fundit janë ballafaquar me sfida dhe ndryshime të mëdha, të cilat kanë tronditur stabilitetin e shoqërisë duke sjellë stresse shumë të mëdha tek individët dhe familjet e tyre.

Ngjarjet që kanë ndodhur në Shqipëri, si eksodi i njerëzve përmes detit dhe rrugëve të tjera të mundshme, destabiliteti gjatë vitit 1997 e të tjera, dukshëm kanë nxjerrë në pah aspektet emocionale dhe menaxhuese të shqiptarëve. Sfidat vënë gjithnjë e më shumë në pah inteligjencën emocionale të një kulture.

Inteligjenca emocionale si nocion është e nevojshme të vendoset në programet shkollore në mënyrë që të promovohet sa më herët në jetën e individit. Sipas studimeve shkencore, tërësia e reaksioneve dhe emocioneve që përjeton fëmija në vitet e para të tija, hedhin bazat e një sërë mësimave dhe përvojave emocionale, të cilat mbeten në referencë konstante gjatë gjithë jetës për komunikimin me mjedisin dhe njerëzit përreth. Argumenti për vlerën e inteligjencës emocionale varet nga lidhshmëria midis ndjenjave, karakterit dhe instinktit moral.

Ekzistojnë një mori argumentesh dhe komponentë, që dëshmojnë se pikërisht qëndrimet themelore etike varen nga shkathtësitë emocionale dhe aftësitë e vetëndërgjegjësimit. Vetëndërgjegjësimi ka të bëjë me njohjen e emocioneve dhe mënyrën se si ato ndikojnë në mendimet dhe në sjelljet tona.

Inteligjenca emocionale nuk është e lindur, por e zhvilluar përmes edukimit prindëror dhe shkollor. Kështu, përmes edukimit mund të përmisojmë aftësitë emocionale, sociale por dhe mund të influencohet arritja akademike e fëmijëve.

Më poshtë, shqyrtohen përfundimet e studimit në përputhje me pyetjet kërkimore dhe me rezultatet e arritura për vërtetimin e hipotezave të secilës hipotezë.

H1- Stili prindëror është i përcaktuar nga shkallët e inteligjencës emocionale.

Nga rezultatet e fituara është gjetur që stili tolerant i nënës nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale, ndërsa stili autoritarian të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor por fuqia e këtij parashikimi ka qenë shumë e vogël. Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël/ i nënës është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale. Por edhe për këtë stil të prindërimit të nënës fuqia e parashikimit ka qenë e dobët. 0.7%.

Analiza e regresionit ka treguar se stili tolerant i babait nuk ishte parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencën emocionale, ndërsa stili autoritarian i babait të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor, por fuqia e këtij parashikimi është shumë e vogël 0.3% . Ndërkohë edhe stili autoritativ fleksibël i babait është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm në aspektin statistikor për inteligjencën emocionale. Stili i babait autoritativ fleksibël është gjetur të parashikojë 12.2 % të variancës së totalit të inteligjencës emocionale .

Babai autoritarian është gjetur i rëndësishëm edhe për shkallën e mirëqenies, për shkallën e shoqërizimit, shkallën e vetëkontrollit si dhe nuk është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit.

Babai autoritativ fleksibël është gjetur parashikues i rëndësishëm për variancën e shkallës së emocionalitetit dhe shoqërizimit, shkallën e mirëqenies dhe për shkallën e vetëkontrollit.

Rezultatet e këtij studimi kanë treguar që stili autoritativ fleksibël i babait dhe i nënës të jetë parashikues i rëndësishëm për inteligjencën emocionale

H2. Ekziston lidhje e rëndësishme mes inteligjencës emocionale dhe stileve prindërore në kampionin e Fierit Shqipërisë dhe atë të Prishtinës Kosovës

Rezultatet e arritura për kampionin në përgjithësi kanë treguar se me rritjen e pikëve në shkallën e inteligjencës emocionale ulen pikët në stili autoritarian të nënës dhe babait. Sa më pak autoritariane nëna dhe babai, aq më e lartë ka qenë vlerësimi i shkallës së inteligjencës tek pjesëmarrësit e këtij hulumtimi. Ndërkohë që sa me autoritative fleksibël të ketë qenë nëna dhe babai nëna aq më e lartë është raportuar shkalla e shkalla e totalit të inteligjencës emocionale. Por rezultatet e këtij studimi nuk kanë gjetur që stili tolerant i nënës dhe babait të kenë parur lidhshmëri të rëndësishme statistikore me inteligjencën emocionale të pjesëmarrësve të këtij studimi.

Në kampionin e Prishtinës rezultatet kanë ndjekur trendin e kampionit të përgjithshëm. Nëna tolerante nuk është gjetur të jetë parashikues i rëndësishëm për totalin e inteligjencës emocionale si në kampionin e Fierit po ashtu edhe në atë të Prishtinës. Rezultatet tregojnë se, si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtinës, nëna autoritariane dhe ajo autoritative fleksible, janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$)

Rezultatet tregojnë se si në kampionin e Fierit dhe në atë të Prishtinës, babai autoritarian dhe autoritative fleksible janë parashikues të rëndësishëm në inteligjencën emocionale ($p < .05$), ndërkohë që dhe babai tolerant duket të jete i rëndësishëm, pasi vlerat e p kanë qenë shumë pranë sinjifikancës

Rezultatet tregojnë që pjesëmarrësit nga Fieri Shqipëria kanë **raportuar** mesatare më të lartë se sa pjesëmarrësit nga Prishtina Kosova në shkallën e vendosmërisë, në shkallën e shprehjes emocionale, në shkallën e perceptimeve emocionale, në shkallën e kontrollit të impulsivitetit, në shkallën e marrëdhënieve , në shkallën e vetëbesimit, në shkallën e motivimit, në shkallën e lumturisë, në shkallën e optimizmit dhe në katër faktorët e tipareve të inteligjencës emocionale; emocionalitet vetëkontroll, shoqërizim si dhe në mirëqenie. Kampioni i te dy vendeve (Shqipërisë dhe i Kosovës) nuk kanë treguar dallime në mënyrë se si individët e këtyre dy shoqërive i përshtaten situatave të reja; se si janë në gjendje të influencojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë; se si janë të aftë të kontrollojnë emocionet e tyre; se si janë në gjendje ti rezistojnë presionit dhe stresit; se si janë në gjendje të kuptojnë perspektivën e tjetrit dhe se si arrijnë të krijojnë rreth shoqëror përmes aftësive të tyre sociale.

H3- Nuk ka dallime të rëndësishme në raportimin e inteligjencës emocionale midis Fierit(Shqiperi) dhe Prishtines (Kosove) në lidhje me nivelin e arsimimit të prindërve.

Të gjithë faktorët e TEIQ janë gjetur në korrelacion pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm me arsimimin e pjesëmarrësve. Me rritjen e viteve të arsimimit rritet edhe raportimi i shkallës së inteligjencës emocionale. Ky rezultat ka vertetur hipotezën që nuk ka dallime të rëndësishme në raportimin e inteligjencës emocionale midis Shqipërisë dhe Kosovës në lidhje me nivelin e arsimimit të prindërve.

H 4- Ekzistojnë dallime gjinore dhe moshore në raportimin e lidhshmërisë mes inteligjencës emocionale.

Kjo hipotezë është vertetuar pjesërisht pasi nuk janë gjetur dallime të rëndësishme në raportimin e totalit të inteligjencës emocionale në raport me gjininë, ndërsa janë gjetur dallime në raportimin e shkallëve të inteligjencës emocionale.

Rezultatet kanë treguar se dallimi i rëndësishëm është gjetur në shkallën e përshtatshmërisë, menaxhimit të emocioneve, shoqërizimit ku meshkujt kanë raportuar mesatare më të lartë se sa femrat. Por nuk janë gjetur dallime gjinore në shkallën e vetëkontrollit

Ndërkohë mosha ka rezultuar të jetë në korrelacion pozitiv me inteligjencën emocionale.

Rekomandime

- 1- Rekomandohet pasurimi i kurrikulës parashkollore dhe shkollore me komponente të Inteligjencës emocionale. Ky hap do të përmirësonte cilësinë akademike të programeve shkollore. Fëmijët e këtij shekulli janë të orietuar në krijimin e një individi të pavarur, kështu që kurrikulat duhet të kenë orientim zhvëllimor dhe respektojnë individualitetin e fëmijëve. Përfshirja e komponentëve të inteligjencës emocionale kultivon në çdo individ një ndjenjë kreativiteti dhe iniciative, një imagjinatë të pasur, dhe një moral të lartë, një kapacitet për reflektime kritike, një ndjenjë pavarësie dhe liri mendimi dhe veprimi. Strategji të ndryshme duhet të përdoren për këtë qëllim si diskutimi në grup, ligjërata, luajtja e roleve si dhe përdorimi i një literature domethënëse për fëmijët dhe studentët.

- 2- Pjesë e edukimit të vazhdueshëm profesional për mësime të jenë trajnime që i përgatisin më shumë ata për të kuptuar më shumë benefitet e inteligjencës emocionale.
- 3- Vendosen objektiva të qarta të rolit të psikologut shkollor si në vlerësimin e inteligjencës emocionale por dhe të zhvillimit të strategjive për përmirësimin e saj.
- 4- Të rriten investimet në shkolla por edhe në komunitet për mbështetjen e prindërve në përmirësimin e kualiteteve si prindër, duke përfshirë programet e disiplinimit pozitiv, fuqizimit të prindërve dhe komunitetit.
- 5- Të planifikohen programe parandaluese për grupet me rrezik të lartë, si ata të cilët kanë prindër autoritarian, mund të ndihmojë për pasurimin e inteligjencës emocionale.

REFERENCAT

1. **Akerjordet, K., & Serverinsson, E. (2007).** Emotional Intelligence: a review of the literature with specific focus on empirical and epistemological perspectives. *Journal of Clinical Nursing*, vol. 16, pp. 1405- 1416.
2. **Akinsola, F. (2010).** Correlation between parenting styles and sexual attitudes of young people in Nigeria: Comparison of two ethnic groups. *Gender and Behavior*, 8(1), 2771 - 2788.
3. **Alegre, A. (2011).** Parenting Style and children's Emotional Intelligence: What do we know?. *The Family Journal: Counselling and Therapy for Couples and Families*, vol. 19(1), pp.56- 62.
4. **Amirabadi, Fatemeh (2011)** "Investigating the relationships between parenting styles and the EI in children", *International Journal of Academic Research*; Vol. 3 Issue 3, p795,
5. **Aminabadi, N. A., Pourkazemi, M., Babapour, J., & Oskouei, S. G. (2012).** The Impact of Maternal Emotional Intelligence and Parental Style on child anxiety and Behavior in the dental setting. *Med Oral Patol Oral Cir Bucal.*, vol. 1(17), pp. 1089- 1095.
6. **Andrei, F., Smith, M. M., Surcinelli, P., Baldaro, B., & Saklofske, D. H. (2015).** The Trait Emotional Intelligence Questionnaire: Internal structure, criterion and incremental validity in an Italian sample. *Measurement and Evaluation in Counseling and Development*. Advance online publication. doi:10.1177/0748175615596786
7. **Anitei, S. (2008).** *Wiser When Older? Emotional Intelligence Proven Not Linked to the Age - Many young people can be wiser than their older counterparts.* An internal report prepared for the Skanska Management Institute.
8. **Aunola, K., Stattin, H., & Nurmi, J. K. (2000).** Parenting Styles and Adolescents' achievement strategies. *Journal of Adolescence*, vol. 23, pp. 205- 222.
9. **Aunola, K., & Nurmi, J. E. (2005).** The role of Parenting Styles in Children's Problems Behavior. *Child Development*, vol. 76(6), pp. 1144- 1159.
10. **Barber, B. K. (1996).** Parental Psychological Control: Revisiting a Neglected Construct. *Child Development*, vol. 67, pp. 3296- 3319.
11. **Baumrind, D. (1967).** Child care practice anteceding three patterns of preschool behavior. *Genetic Psychology Monographs*, 75(1), 43- 88.

12. **Baumrind, D (1968).** Effects of authoritarian parental control on child behavior. *Child Development*, vol. 37, pp. 887- 907.
13. **Baumrind, D. (1971).** Current Patterns of parental authority. *Developmental psychology Monographs*, vol, 4, (1, Pt, 2).
14. **Baumrind, D. (1978).** Parental disciplinary paterns and social competence in children. *Youth and Society*, vol. 9, pp. 239- 276.
15. **Baumrind, D. (1991).** The influence of parenting style on adolescent competence and substance use. *Journal of Early Adolescence*, vol. 11, pp. 56- 95.
16. **BarOn, R. (2000).** Emotional and social intelligence: Insights from the Emotional Quotient Inventory (EQ-i). In R. Bar-On and J. D. A. Parker (Eds.), *Handbook of emotional intelligence*. San Francisco: Jossey-Bass.
17. **Bar-On, R. (2003).** Hoë important is it to educate people to be emotionally and socially intelligent, and can it be done? *Perspectives in Education*, 21 (4), 3- 13
18. **Bar-On, R., Tranel, D., Denburg, N. L., & Bechara, A. (2004).** Emotional and social intelligence. *Social neuroscience: key readings*, 223.
19. **BarOn, R. (2006).** The BarOn model of emotional- social intelligence (ESI). *Psicothema*, 18, supl., pp. 13- 25.
20. **BarOn, R. (2010).** Emotional intelligence: an integral part of positive psychology. *South African Journal of Psychology*, vol. 40(1), pp. 54- 62.
21. **Belsky, J. (1984).** The Determinants of Parenting: A Process Model. *Child Development*, vol. 55(1), pp. 83- 96.
22. **Bibi, F., Chaudhry, A. G., Aëan, E. A., & Tariq, B. (2013).** Contribution of Parenting Style in Life domain of Children. *Journal of Humanities and Social Science*, vol. 12(2), pp. 91- 95.
23. **Bornstein , L. , & Bornstein , M. H. (2007).** *Parenting styles and child social development*. Marrur me 05/ nentor/ 2015 nga linku <http://www.child-encyclopedia.com/Pages/PDF/BornsteinANGxp.pdf> .
24. **Borawski, E. A., Ievers-Landis, C. E., Lovegreen, L. D., & Trapl, E. S. (2003).** Parental Monitoring, Negotiated Unsupervised Time, and Parental Trust: The Role of Percieved Parenting Prakteice in Adolescent Health Risk Behaviors. *Journal of Adolescent Health*, vol. 33(2), pp. 60- 70.
25. **Brackett, M. A., Mayer, J. D., & Warner, R. M. (2004).** Emotional Intelligence and its relations to everyday behaviour. *Personality and Individual Differences*, vol. 36, pp. 1387- 1403.

26. **Brackett, M. A., Rivers, S. E., Shiffman, S., Lerner, N., & Salovey, P. (2006).** Relating Emotional Abilities to Social Functioning: A Comparison of Self- Report and Performance Measures of Emotional Intelligence. *Journal of Personality and Social Psychology*, vol. 91(4), pp. 780- 795.
27. **Brackett, M. A., Rivers, S. E., & Salovey, P. (2011).** Emotional intelligence: implications for personal, social, academic, and workplace Success. *Social and Personality Psychology Compass*, vol. 5(1), pp. 88- 103.
28. **Brand, S., Hatzinger, M., Beck, J., Holsboer-Trachsler, E. H. (2009).** Perceived Parenting styles, personality traits and sleep patterns in adolescents. *Journal of Adolescence*, vol. 32, pp. 1189- 1207.
29. **Brown, L., & Iyengar, S. (2008).** Parenting styles: The impact on student achievement. *Marriage & Family Review*, vol. 43(1-2), pp. 14- 38. M. Hetherington (Eds.), *Family Transitions* Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, pp. 111-163.
30. **Buri, J. R. (1991).** Parental authority questionnaire. *Journal of Personality Assessment*, 57(1), 110-119.
31. **Cabello, R., Sorrel, M. A., Fernandez-Pinto, I., Extremera, N., & Fernandez-Berrocal, P. (2016).** Age and gender differences in ability emotional intelligence in adults: A cross-sectional study. *Dev.Psychol.*, 52, 1486-1492.
32. **Carmeli, A. (2003).** The relationship between emotional intelligence and work attitudes, behavior and outcomes. *Journal of Managerial Psychology*, vol. 18, pp. 788– 813.
33. **Carmeli, C., Yitzhak-Halevy, M., & Weisberg, J. (2009).** The relationship between emotional intelligence and psychological well-being. *Journal of Managerial Psychology*, Vol. 24(1), pp. 66 – 78.
34. **Cavallo, K. & Brienza, D. (2002).** Emotional competence and leadership excellence at Johnson and Johnson: the emotional intelligence leadership study. [Online] Available: <http://www.eiconsortium.org>
35. **Chamorro-Premuzic, T., Bennett, E., & Furnham, A., (2007).** The Happy personality: Meditational role of trait emotional intelligence. *Personality and Individual Differences*, vol. 42, pp. 1633- 1639.
36. **Chao, R. (1994)** “Beyond parental control; authoritarian parenting style; understanding Chinese parenting through the cultural notion of training”, *Child Development*, 45, 111-119

37. **Cherniss, C. (2010).** Emotional intelligence: New insights and further clarifications. *Industrial and Organizational Psychology*, vol. 3(2), pp. 183 - 191.
38. **Ciarrochi, J. V., Chan, A. Y., & Bajgar, J. (2001).** Measuring emotional intelligence in adolescent. *Personalit and individual differences*, vol. 31, pp. 1105- 1119.
39. **Conte, J. M. (2005).** A review and critique of emotional intelligence measures. *Journal of Organizational Behavior*, vol. 26, pp. 433- 440.
40. **Coplan, R. J., Hastings, P. D., Legace- Seguin, D. G., & Moulton, C. E. (2002).** Authoritative and Authoritarian Mothers' Parenting Goals, Attribution, and Emotions Across Different Childrearing Contexts. *Laërence Erlbaum Associates, Inc.*, vol. 2(1), pp. 1- 26.
41. **Cuzzocrea, F., Barberis, N., Costa, S., & Larcen, R. (2015).** Relationship Between Alexithymia, Parenting Style, and Parental Control. *Psychology Rep.*, vol. 117(2), pp. 580- 596.
42. **Darling, N., & Steinberg, L. (1993).** Parental Style as Context: An Integrative Model. *Psychological Bulletin*, vol. 113(3), pp. 487- 496.
43. **Darling, N. (1999).** *Parenting Style and Its Correalates*. ERIC Digest.
44. **Davies, M., Stankov, L., & Roberts, R. (1998).** Emotional intelligence: in search of an elusive construct. *Journal of Personality and Social Psychology*, 75, 989- 1015.
45. **Day, A. L., & Carroll, S. A. (2004).** Using an Ability- Based measure of emotional intelligence to predict individual performance, group performance, and group citizenship behaviours. *Personalit and individual differences*, vol. 36, pp. 1443- 1458.
46. **Delale, E. A., Taksic, V., & Ivcevic, Z. (2007).** Gender differences of parenting style in predicting self-perceived emotional intelligence. In M.
47. **Denham, S. A., Workman, E., Cole, P. M., Èeissbrod, C., Kendizora, K. T., Zahn- Waxler, C. (2000).** Prediction of Externalizing Behavior Problems from Early to Middle Childhood: the role
48. **Driscoll, A., Russell, S., & Crockett, L. (2008).** Parenting Styles and Youth Èell- Being Across Immigrant Generations. *Faculty Publications, Department of Psychology*. Paper 352.
49. **Ehnavall, A., Parker, G., Hadzi-Pavlovic, D., & Malhi, G. (2008).** Perception of rejecting and neglectful parenting in childhood relates to lifetime suicide attempts for females–but not for males. *Acta Psychiatrica Scandinavica*, 117(1), 50- 56.

50. **Eisenberg, N., Cumberland, A., & Spinard, T. L. (1998).** Parental Socialization of Emotion. *Psychology Inquiry*, vol. 9(4), pp. 241- 273.
51. **Ekermans, G. (2009).** Emotional intelligence across cultures: Theoretical and methodological considerations. In, C. Stough, D. H. Saklofske, & J. D. A. Parker (Eds), *Assessing emotional intelligence: Theory, research, and applications* (pp. 259-290). New York: Springer.
52. **Erden, M., & Uredi, I (2000)** "The effect of perceived parenting styles on self regulated learning strategies and motivational beliefs", *International Journal about Parents in Education*, 2, (1), 25-34.
53. **Eslami, A. A., Hasanzadeh, A., & Jamshidi, F. (2014).** The Relationship between emotional intelligence health and marital satisfaction: A comparative study. *Journal of Education and Health Promotion*, vol. 3(24).
54. **Faramarzi S, Homae R, Hosseini M S. 2009.** Relation of emotional intelligence and spiritual intelligence in students. *J Stud Islam & Psychol.* 3(5): 7-23.
55. **Fernandez- Berrocal, P., & Extremera, N. (2006).** Emotional Intelligence: A theoretical and empirical review of its first 15 years of history. *Psicothema*, vol. 18, pp. 7-12.
56. **Finegan, J. A. (1998).** Study of behavioral phenotypes: goals and methodological considerations. *Am J Med Genet*, vol. 81, pp. 148 – 155.
57. **Fonte, B. A. (2009).** *Relationship between parenting style, emotional intelligence and self-esteem*. Retrieved October 6, 2009, from <http://hdl.handle.net/10090/7271>.
58. **Frijda, N. (2008).** The psychologists' point of view. In M. Leëis, J. M. Haviland-Jones, & L. F. Barrett (Eds.), *Handbook of emotions* (3rd ed.). New York: Guilford Press
59. **Furnham, A., (2012).** *Emotional Intelligence*, (eds), Di Fabio, A. Emotional Intelligence- New Perspective and Applications ISBN: 978-953-307-838-0, InTech, Available from:
60. <http://www.intechopen.com/books/> .
61. **Garcia, F., & Garcia, E. (2009).** Is Always Authoritative the Optimum Parenting Styles: Evidence From Spanish Families. *Adolescence*, vol. 44(173), pp. 101- 131.
- 62.
63. **Gardner, K. J., & Qualter, P. (2010).** Concurrent and incremental validity of three trait emotional intelligence measures. *Australian Journal of Psychology*, 62,5_13. doi:10.1080/00049530903312857

64. **Ghasemzade N, Peyvastegar M, Hosseinian S, Mutabi F, Banihashemi S. 2010.** Effectiveness of cognitive-behavioral intervention on coping responses and cognitive emotion regulation strategies. *Journal of Behavior Science*. 4 (1): 35-43. [Persian]
65. **Goleman, D. (1998).** *Working with emotional intelligence*. Bantam Books. New York.
66. **Goleman, D (2001).** Emotional intelligence: Issues in paradigm building. In C.
67. **Gonzalez, A. R., Doan Holbein, M. F., & Quilter, Sh. (2002).** High School Students' Goal Orientations and their relationship To Perceived Parenting Styles. *Contemporary Educational Psychological*, vol. 27(3), pp. 450- 470.
68. **Gordon, S. L. (1989).** The socialization of children's emotion: Emotional culture, competence, and exposure. In C. Saarni & P. Harris (Eds.), *Children's understanding of emotion* (pp. 319–349). Cambridge, UK: Cambridge University Press.
69. **Gota, A. A. (2012).** *Effects of parenting styles, academic self-efficacy, and achievement motivation on the academic achievement of university students in Ethiopia*. Retrieved from <http://ro.ecu.edu.au/theses/461> .
70. **Gupta, M., & Mehtani, D. (2015).** Parenting Style and Psychological Well-being among Adolescent: A Theoretical Perspective. *Internacional journal of Multidisciplinary Research*, vol. 5(2), pp. 74- 84.
71. **Halpenny, A. M., Nixon, E., & Eatson, D. (2010).** *Parents' Perspective on Parenting Styles and Disciplining Children*. The Stationery Office. Dublin.
72. **Harrington, D., Dubowitz, H., Black, M. M., & Binder, A. (1995).** Maternal substance use and neglectful parenting: Relations with children development. *Journal of Clinical Child Psychology*, vol. 24(3), pp. 258- 263.
73. **Herbert J D, Forman E M. 2011.** Acceptance and mindfulness in cognitive behavior therapy: Understanding and applying the new therapies: Wiley.
74. **Hoerger, M., Chapman, B. P., Epstein, R. M., & Duberstein, P. R. (2012).** Emotional Intelligence: A Theoretical Framework for individual differences in affective forecasting. *Emotion*, vol. 12(4), pp. 716- 725.
75. **Hopkins, M. M. & Bilimoria, D. (2008).** Social and emotional competencies predicting success for male and female executives. *Journal of Management Development*, 27(1), 13- 35.

76. **Jandt, F. E. (2010).** *An introduction to intercultural communication: Identities in a global community.* Neë Dehli, India: Sage Publications.
77. **Jolic-Marjanovic, Z., & Altaras-Dimitrijevi c, A. (2014).** Reliability, construct and criterion-related validity of the Serbian adaptation of the Trait Emotional Intelligence Questionnaire (TEIQue). *Psihologija*, 47, 249_262. doi:10.2298/PSI1402249J
78. **Kafetsios, K. (2004).** Attachment and emotional intelligence abilities across the life course. *Personality and Individual Differences*, 37, 129-145.
79. **Kafetsios, K., & Zampetakis, L. A. (2008).** Emocional intelligence and job performance and job satisfaction: testin the mediatory role of pozitiv and negative affect at öork. *Personalit and individual differences*, vol. 44, 712- 722.
80. **Kakkar, S. (1978).** The inner öorld: A psycho-analytical study of childhood and society in India. *Oxford Pres: New Delhi.*
81. **Karavasilis, L., Doyle, A., & Markieëicz, D. (2003).** Associations betëeen parenting style and attachment to mother in middle childhood and adolescence. *International Journal of Behavioral Development*, vol. 27, pp. 153–164.
82. **Kerr, R., Garvin, J., Heaton, N., & Boyle, E. (2006).** Emocional intelligence and leadership effectiveness. *Leadership & Organizational Development Journal*, vol. 27(4), pp. 265- 279.
83. **Kimiaee S A, Raftar M R, Soltanifar A. 2011.** Emotional intelligence training and its effectiveness on modification of aggressive adolescents. *Res Clin Psychol Couns1 (1):* 153-66
84. **Kopko, K., (2007).** Parenting style and Adolescents. *Cornell Coperative Extension.*
85. **Koman, E. S., & Eöloff, S. B. (2008).** Emotional intelligence competencies in the team and team leader. *Journal of Management Development*, vol. 27, pp. 55 –75.
86. **Kordi, A., & Baharudin, R. (2010).** Parenting attitude and style and its effect on children’s school achievements. *International Journal of Psychological Studies*,2(2), p. 217.
87. **Laible, D. J., & Carlo, G. (2004).** The differential relations of maternal and paternal support and control to adolescent social competence, self-öorth, and sympathy. *Journal of Adolescent Research*, vol. 19, pp. 759– 782.

